

RENA ROSSI-ZAIRI

OLIVIA

ROMAN

BOTIMET TOENA

RENA ROSSI-ZAIRI

OLIVIA

roman

Përktheu nga origjinali greqisht
Vita Zera

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Autori: Rena Rossi-Zairi
Titulli në origjinal: OΛIBIA
Botoi në greqisht: Psychogios Publications S.A.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Besa Vila
Korrektore letrare: Edona Marku
Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN: 978-9928-348-84-5

© 2021, Psychogios Publications S.A.

© në shqip Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

*Për Anën, nënën e zemrës sime, që “u largua”
prej meje për të notuar në blunë e thellë të qiellit...*

*[...] dhe ndahen e bashkohen njerëzit,
dhe nuk marrin asgjë nga njëri-tjetri.
Sepse dashuria është rruga më e vështirë për t'u
njohur.*

*[...] Më fal, e dashura ime, që jetoja para se të të
njihja.*

*[...] Sepse njerëzit ekzistojnë nga momenti që gjejnë
një vend në jetën e të tjerëve. Ose një vdekje për jetën
e të tjerëve...*

Tasos Leivaditis

T'i japësh jetë Olivias

Ishte një vajzë trupvogël, e dobët, me ca sy të kaltër e të mëdhenj shprehës dhe flokë të zinj, të prerë shkurt si djalë. Vështrimi i saj ishte i zgjuar, vetëtitës, shkruaja në “Tirkuazh” (Tirkuazh-botime “Psychogios” 2020) për Olivian, rreshteren.

Ishte një nga karakteret dytësore, ato që shfaqen pak, sa për të ndikuar fabulën, që të më ndihmojnë të zbuloj sekrete që të lënë pa frymë.

Menjëherë, më rrëmbyen elementet kontradiktore të personalitetit të saj, roli i saj shoqëror. Rrezatonte dinamikizëm ajo vajzë, dhe nuk ishte e pashme vetëm fizikisht; bukuria e shpirtit të saj ishte më se e dukshme. Dhe sa më shumë “e përdorja”, aq më shumë fitonte admirimin tim. Dukej mendjemprehtë, aktive dhe në të njëjtën kohë e ndjeshme. E përgjegjshme, mbushur me vetëbesim, me aftësi të përkryera komunikuese kishte mësuar t’i caktonte që në krye të herës caqet e veta. Profesionit që kishte zgjedhur ishte i vështirë,

kërkues. Por e kishte zgjedhur me vetëdije të plotë, sepse u rrit me të, mësoi ta dashuronte. Përballej përditë me errësirën, ruante ekuilibrin në një vijë të hollë, e detyronte mendjen të merrte kthesa të shpejta. Vinte në rrezik vetveten, duke luftuar për të parë dritën. Ishte police e gjinisë femërore, dhe, ashtu si gjithë koleget e saj, herët a vonë, do t'i duhej ta ndërthurte rolin e saj me atë të nënës e të bashkëshortes.

Të kombinonte shishen e bebes me armën.

Papritur kuptova se nuk ndaloja dot së shkruari për të, sepse do të ishte protagonistja kryesore e romanit tim të ardhshëm.

Disi kështu, lindi Olivia.

U zhyta në të shkuarën e saj, ndava me të gjithë pengesat, që i dolën rrugës, u ndjeva krenare për të, luftova për të zbuluar sekretet e fshehura të jetës së saj.

A ekzistojnë vallë të vërteta, të vërteta të pamëshirshme, që nuk duhet të thuhet? Të vërteta që tmerrojnë, që shkruhen në zemër me germa që nuk fshihen, duke e bërë atë të pikojë gjak?

Po fëmijëve tanë? A duhet t'u themi të vërtetën, t'i përballim me këtë realitet të vështirë? Mos ndoshta gënjeshttrat janë më të parapëlqyera apo minojnë marrëdhënien tonë me ta? Favorizojnë apo dëmtojnë shëndetin e tyre mendor?

Një moment, heroina ime detyrohet të lërë pas copëtimin dhe të gjejë kuptimin e ekzistencës së saj. Shndërrohet në një engjëll drejtësie, si ai engjëlli i vogël tatuazh që ka gdhendur në krahun e saj. Derisa

papritur ngjyrat në kanavacën e jetës së saj ngatërrohen. Dhe atëherë përballet me unin tjetër të saj.

Është emocionuese të shkruash për të bardhën dhe të zezën, për marrëdhëniet bardhezi. Por asgjë nuk është absolute. Asnjë karakter nuk është i parashikueshëm. Në qoshe të rrugës do ta presin gjithmonë të papriturat.

Olivia është një grua që përballet sy më sy me frikërat e veta. Ashtu si të gjithë ne, e di se plagët shpirtërore nuk mbyllen nëse i injorojmë. Thjesht zmadhohen gjithnjë e më shumë.

Besoj se të gjitha gratë fshehin një Olivia brenda tyre. Njësoj si ajo, kërkojmë dikë të rrëmbejë nga shikimi ynë dhimbjen, ta bëjë të tijën dhe pastaj ta largojë. Dikë që të na shikojë dhe pa thënë asnjë fjalë, të na thotë të gjitha ato që duam të dëgjojmë. Dhe heroina ime është e bekuar, sepse njih dashurinë, atë të fortën dhe gjithëpërfshirësen. Nuk e tremb fuqia e saj, jeton çmendurinë dhe pasionin e saj. Ndien, jep dhe merr, gjakoset, rilind. Pasioni i jep mësimë shekullorë; i njih dashurinë, që është dëshira e thellë e ekzistencës së saj.

E shijova vërtet këtë roman, nuk u pendova që ndoqa hapat e polices sime, hapa që më çuan në ngjarje tronditëse.

Më çuan tek Andoni, por edhe tek Eleana. Te Fedhona, tek Adrianoja, te Manoja. Në shumë heronj, kaq të ngjashëm, por dhe kaq të ndryshëm në kompleksitetin e tyre. Disa magjepsin menjëherë,

spontanisht, pa shumë mund, ndërsa të tjerë duhet të luftojnë që të fitojnë simpatinë tonë.

Hapat e saj më çuan edhe në dashuri, që na falin shumë, por na kushtojnë akoma më shumë. Hapin plagë brenda nesh, na detyrojnë të ngatërrojmë gëzimin me trishtimin, të qeshurën me të qarën. Përjetojmë ç' do të thotë shoqëri pranë tyre, por edhe tradhti, ashtu si nxjerrim nga goja fjalën “të dua” për njerëz që nuk e meritojnë, ashtu si hipim në një makinë pa frena.

Një moment pyes veten se cili është detyrimi më i madh për një nënë. Kundrejt fëmijës, apo kundrejt vetvetes. Luftoj për të gjetur faljen dhe forcën e saj, atë rrugë personale të pastrimit që të çon në çlirim. Atëherë kur mbërrin momenti për të vazhduar më tej, duke falur të gjithë ata që na lënduan, por madje edhe veten tonë.

Çfarë ndodh vallë kur nuk arrijmë të mbisundojmë ndaj përbindëshit, që është strukur brenda nesh, përbindëshit të xhelozisë? Frika se mos humbasim dikë që duam arrin në kufijtë e fiksimit. Dhe atëherë, mjalti i dashurisë shndërrohet në helm. Bëhemi posesivë, kërkues.

Pse fiksohemi me njerëz që na refuzojnë? Pse jemi mësuar të duam atë që nuk mund ta kemi? U dhurojmë veten tonë dhe ata na ofrojnë thërrime. Diçka e tillë duket si varësi, droga jonë është njeriu që përpiqet të na largojë nga vetja. Mos vallë e ka fajin vetëvlerësimi ynë i ulët?

Secili prej nesh është i veçantë dhe asnjëri prej nesh nuk është i përsosur. Por, si është e mundur të ekzistojnë njerëz që shpërndajnë lirshëm ligësinë e tyre, që besojnë se janë zota dhe luajnë me jetët e të tjerëve? Dhe sa keq kur ka marrëdhënie pa pasion, martesë pa dashuri. Ngjajnë me qiej që nuk kanë përditshme vezulluese, me lule false, udhëtime pa destinacion, thyerje zemre...

Shkruaj dhe ju falënderoj, shkruaj dhe mendoj të gjitha ato që më komentoni në lidhje me romanet e mia. Është emocionuese të krijoj, t'ju rrëmbej larg përditshmërisë, t'ju bind se ëndrrat tuaja mund të realizohen. Dhe jeni ju fryma e shkrimit tim. Fjalët tuaja janë të çmuara për mua, më inkurajojnë, më japin fuqi të pabesueshme.

Shkruaj për jetën e përditshme dhe problemet e saj. Falë jush dhe së bashku me ju, luftoj për zgjidhjen, nëpërmjet fabulës së pandërprerë, ankthit, përmbysejeve, luftoj për të mbështetur ndjesi të ndryshme në mendimet dhe shpirtin tuaj. Dhe nëse gjeni një pjesë të vetvetes në rrethanat apo faktet që përshkruaj përmes librave të mi, ta dini se është çmimi më i madh shpirtëror për mua.

Çdo udhëtim, cilido udhëtim, është dashuri, dashuri e së resë, e së ndryshmes. Një ndjesi e lirisë së vërtetë, një mënyrë për të mësuar pak më mirë vetveten. Olivia udhëton në Amorgo, në Agjistri, në Aponiso dhe në Shën Akilio, në Prespën e Vogël, në Kostur, në Parga, në Nakso. Por edhe në Milano, Venecia,

Ibiza, Dubai, Abu Dabi, Tuluz, Albi, Sri Lanka dhe në zemër të botës arabe, në Kajro. Falënderoj edhe njëherë Botimet “Psychogios”, që më gjenden pranë, falënderoj veçanërisht përgjegjësen e botimit, të dashurën time Aggela Sotiriou, shpirtin e shtëpisë botuese. Për kujdesin, fuqinë, sigurinë, butësinë që më dhuron gjithmonë. Për pasionin e saj, që gjithmonë bëhet njësh me timin.

Duke i dhënë jetë Olivias, mendja më rendi shumë herë edhe në një tjetër të dashur të Botimeve “Psychogios”, te Kleio Zachariadi, drejtoresha e marketingut. Trupvogël, delikate, e patundur, nga pamja e jashtme ngjan me Olivian, rrezaton dinamizëm, pasionohet me punën e saj, adhuron drejtësinë dhe ndiej se ka të njëjtën forcë, të njëjtën bukuri shpirtërore me protagonisten time.

Falënderoj nga thellësia e zemrës edhe njëherë Dhimitri Kocandonin, ish-drejtor policie i Komisarariatit të Përgjithshëm të Athinës, për ndihmën e tij mbi çështjet që kanë lidhje me policinë. Në këtë roman e lodha vërtet me pyetjet e mia për një vit të tërë, dhe ai, i palodhur, iu përgjigj të gjithave me hollësi. Nëse nuk do të ishte pranë meje në gjithë “krimet” e mia, nuk do të mund t’i përshkruaja ato me kaq saktësi dhe realizëm.

Përfshihuni në magjinë e këtij romani. Ndoshta asgjë nuk është rastësore në jetë, ndoshta gjithmonë ka një arsye. Ndoshta gjithçka ndodh për një arsye dhe i shërben një qëllimi. Ndoshta gjithçka që ndodh është pararendëse e atyre që do të vijnë, e atyre që kanë vërtet kuptim dhe ia vlen të ndodhin. E vetmja që

duhet të bëni është ta administroni saktë, pa humbur durimin, kurajën, shpresën tuaj.

Dashuria është dielli ynë. Jetojmë vërtet kur fitojmë mbi frikërat tona. Sepse të dashurosh do të thotë se nuk ke frikë.

Dashuria është përkëdhelja e Zotit, prekje e shpirtit.

Udhëtimi ynë i vetëm i vërtetë.

Jetojmë vërtet qëkur gjejmë një vend në jetën e të tjerëve, siç thotë dhe autori im i preferuar, Tasos Leivaditis.

Dhe bota jonë ekziston vetëm kur e ndajmë...

Rena Rossi-Zairi

Piva gllënjken e fundit të pijes sime dhe kërceva në këmbë menjëherë. Atëherë gjithçka para syve m'u fshi. Ai burri, banaku, madje edhe fotografia e Skarlet Johansonit në mur.

Veshët nuk më dëgjonin më muzikën e dixhejit, por veçse një gumëzhimë, një gumëzhimë të çuditshme që sa vinte e bëhej më e fortë.

Dhe atëherë nisi të më rrotullohej gjithçka.

“Por çfarë... çfarë...”, murmurita.

Më shumë e ndjeva sesa e pushë; nuk ndodhesha më në lokalin tim të preferuar. Isha shtrirë përmbys në një dysheme të drunjtë.

Në sallonin e shtëpisë sime.

Jo, jo, nuk ishte i drunjtë, ishte i bërë prej laminati, një produkt sintetik, që përbëhet nga shtresa të shumëfishta materialesh të ndryshme. Kisha zgjedhur atë në vend të drurit natyror. Ishte më i lirë dhe një zgjidhje e mirë alternative.

Por çfarë mendoja?

Më duket se qesha, por nuk isha dhe aq i sigurt. Mund edhe të kisha humbur ndjenjat për pak kohë, për shumë pak. Nuk bëj be.

Një moment psherëtiva dhe u përpoqa të ngrihesha në këmbë. Një aromë e çuditshme metalike notonte

në ajër. Pëllëmba ime e djathtë prekte diçka viskoze.
Mos ishte mjaltë?

Mjaltë i hedhur përtokë?

Çfarë dreqin po ndodhte?

U përpoqa të shikoja gishtat. I shikoja turbullt.
Më merreshin mendtë. M'u duk sikur ngjisnin ama.
U përpoqa edhe nja dy herë të tjera të ngrihesha
në këmbë. Dyshemeja rrëshqiste në mënyrë të
pabesueshme. Si përfundim, arrita të mbështetesh
në një mur që të mos rrëzohesha.

Kur bëra një hap për t'u larguar, ende turbullt,
pashë i frikësuar se një pëllëmbë ishte stampuar sipër
murit, pëllëmba ime. Ishte plot me gjak.

Isha vrarë? Por nuk më dhembte askund.

Tunda kokën që të më ikte marramendja. Mundim
i kotë! U ktheva dhe pashë vendin ku isha shtrirë para
pak, vendin ku...

Bërtita! E bërtitura ime dukej e papërshtueshme.

Sepse pashë atë grua. Të shtrirë përtokë. Të
mbuluar me gjak. Sytë i kishte të hapur. Shikonte
tavanin e habitur. Veshur mbante një këmishë nate të
shkurtër mëndafshi në ngjyrë rozë.

Ishte e mbytur në gjak.

“Jo, jo!”, bërtita. Bërtita sërish më saktë, dhe u ula
në gjunjë pranë saj.

Pranë një pellgu me gjak.

E tunda. Asgjë. Ia vura dorën time në qafë. Nuk
pulsonte asnjë damar. Ishte e vdekur? E vdekur?
E mbështeta edhe veshin te zemra e saj, por asnjë
shenjë jete.

Në krah të saj ishte hedhur një thikë e madhe. Edhe ajo e mbuluar me gjak. E njihja mirë. Tehu i saj ishte prej çeliku inoks. Dhe doreza e zezë ishte imitim i bririt. Ma kishin bërë dhuratë në vigjilje të Vitit të Ri. A thua se më pëlqente gjuetia!

“Do të të ndihmojë në punë të vogla të ndryshme, madje edhe gjatë shëtitjeve në natyrë. Tehu i saj është prej çeliku inoks”, më patën thënë.

Nuk mund ta imagjinonin se vetë ai teh do t'i merrte jetën dikujt.

Me atë thikë e kisha vrarë gruan e gjorë? Isha vrasës? A është e mundur? A mund ta bëja diçka të tillë? Të vrisja një njeri? Cilindo njeri?

U ngrita sërish në këmbë, duke u penguar. Gjithë dritat e sallorit ishin të ndezura, llambadari i madh, abazhurët në tavolinat e vogla pranë kolltukut. Madje dhe shandanët e murit. Grilat e derës së ballkonit ishin të mbyllura. Eca drejt banjës. Sapo hyra volla.

Pastaj e zhyta kokën nën çezmë. Pashë veten në pasqyrë. Isha si mos më keq. Sytë i kisha të kuq dhe nën to ishin krijuar rrathë të zinj. Nuk shikoja më aq turbullt.

U hodha një sy rrobave të mia. Ishin të gjakosura. Edhe kostumi im bezhë, edhe këmisha ime e bardhë si bora.

E... e kisha vrarë?

O Zot!

U gëlltita. Dhe u zhvesha. Rrobat e mia, një lëmsh i gjakosur në dysheme. U futa në dush. Pastaj dola jashtë i zhveshur. Kalova në sallon pa i hedhur asnjë sy... kufomës. Hyra në dhomën time. Rrezet e diellit futeshin nga grilat gjysmë të hapura.

Ishte ditë?

Sytë më shkuan tek ora e vogël mbi komodinën time. Ishte ora gjashtë e mëngjesit. Dhe unë kaq i ngatërruar. Tmerrësisht i ngatërruar. Kisha humbur shumë orë nga jeta ime, kisha...

Ndalova së menduari.

Hapa dollapin. Mora të brendshme të reja, pantallona xhins, një bluzë të bardhë. U veshja. Veshja çorape të bardha dhe atlete. Nxora jashtë edhe një çantë shpine.

U ula në krevat. E zhyta kokën mes duarve. Isha i dënuar. Jeta ime kishte marrë fund.

Të gjithë do të besonin se isha vrasësi.

Nuk e dija nëse e kisha bërë. Nuk mund ta kisha bërë. Por instinkti i mbijetesës më thoshte që t'ia mbathja me të katra.

Po ku të shkoja?

Gjithçka në këtë shtëpi kishte shenjat e mia të gishtave. Ishte çështje kohe dhe do të më arrestonin.

Ende më merreshin mendtë. E kisha të pamundur të mendoja me mendje të kthjellët. Çfarë mund të bëja? Çfarë doja të bëja para se të më mbyllnin prapa hekurave të burgut?

U ngrita nga krevati. Dëshira ime e fundit para se të më dënonin, si mësim për të tjerët, ishte të shikoja ishullin tim. Të thithja ajrin e pastër të detit, të shikoja atë portë të adhureshme teksa inkuadronte edhe njëherë diellin tim.

Futa me nxitim në çantën e shpinës një xhakëtë kundër erës që e gjeta në dollap. Këtu, shumë shpejt

do të përgojnin emrin tim, do të më mbyllnin në burg përgjithmonë, dhe unë vrisja mendjen se mos ftohesha? Një buzëqeshje frikacake ironike u përvijua në buzët e mia. Doja të zhytesha në ujërat e ishullit tim, të zhdukesh.

Para se të lija dhomën, hapa sirtarin e parë të komodinës. Aty kisha ruajtur parfumin që më kishin dhuruar. Pjesë e jetës sime ishte edhe ai. E mora me vete pa e ditur arsyen.

Futa edhe dy shishe uji në çantë, dhe disa para që i kisha ruajtur në një sirtar.

Hyra në banjë, mora portofolin, syzet e diellit dhe çelësat, që i kisha lënë në lavaman kur hoqa pantallonat e gjakosura, dhe pastaj dola në sallon.

Por çfarë kisha bërë? Kisha hyrë në shtëpi, kisha ndezur gjithë dritat dhe pastaj vrava këtë grua?

Nuk mbaj mend as gjënë më të vogël.

Jo, jo! Nuk isha vrasës. Por kush e kishte vrarë? Ndonjë hajdut? Brava e derës nuk ishte e thyer. Nuk isha në gjendje t'i vija në radhë mendimet e mia.

Para se të ikja, i hodha një sy të fundit trupit.

“Më fal”, murmurita.

Sytë m'u mbushën me lot.

Eca me hapa të vendosur, duke u kujdesur që të mos shkelja gjakun. Hapa derën e jashtme dhe e tërhoqa ngadalë pas meje. Nuk e mbylla me çelës.

Mora taksinë e parë që më doli.

- Shkojmë në Pire! - i thashë shoferit.

Tragetit për në ishullin tim nisej në orën 7:25.

Preva biletën, hipa në kuvertë me një kafe në dorë.

Në momentin e nisjes, trageti fërshëlleu tri herë, ndërkohë që unë shikoja portin e Pireut që largohet.

“Edhe sa ditë akoma do ta shijoj lirinë time?”, mendova.

Dhe në atë moment i lashë lotët e mi të lirë...

1

Atë natë të nxehtë qershori Olimbia e vogël flinte e qetë në krevatin e saj. Herë pas here buzëqeshte e lumtur, a thua se shikonte ndonjë ëndërr të këndshme. Një abazhur nate, në formën e fluturës, ishte i ndezur në një prizë dhe ndriçonte disi dhomën.

Në murin gri mbi krevat ishin ngulitur flutura shumëngjyrëshe tredimensionale prej letre me krahët e tyre të mëdhenj të hapur. Dukej sikur fluturonin lart në qiell. Krevati ishte i bardhë. I bardhë ishte edhe abazhuri mbi komodinë. Ngjitur me të ishte një karrocë kukullash flakë e kuqe, e mbushur me kafshë prej pelushi dhe sipër saj, varur nga litarët, figuronin ca këpucë baleti ngjyrë rozë. Një moket i bardhë mbulonte dyshtemenë.

Dhoma e gjumit të Olivias ishte e bukur. E bukur, e qetë, e qeshur ishte edhe jeta e saj. Babai i saj, Orfea, e adhuronte. Dhe e dinte sa shumë i donte fluturat vajza e tij. I pëlqente ta thërriste “micka”, sepse dukej e gjallë dhe adhuronte baletin. Ngrinte me hir duart e saj të holla, qëndronte në majë të gishtave dhe kërcente lehtë.

- Je njësoj si flutura e dashurisë, micka ime, - i thoshte dhe i përsëriste, dhe ajo gëzonte, edhe pse nuk kishte parë kurrë flutur të tillë.

Olimbia kishte lëkurë të bardhë si dëbora dhe ca sy të mëdhenj të kaltër, si një copëz e marrë nga qielli.

- Dua të bëhem balerinë, - iu lut të atit dy vite më parë, sapo kishte mbushur tetë vjeçe.

Që e vogël ëndërronte se do të bëhej një balerinë e famshme.

Dhe ai i bleu tuta sportive dhe funde prej tyli, streçe rozë dhe e regjistroi në një shkollë baleti pranë shtëpisë së tyre. Nuk ngopej duke e parë të ndizte magnetofonin dhe të kërcente natë e ditë. Lëvizjet dilnin spontanisht nga trupi i saj. Ishte një fëmijë kaq i qeshur, kaq i lumtur. Dhe gjithçka që ndiente e shprehte përmes kërcimit.

Sa shumë e adhuronte babanë e saj! Ai gjente gjithmonë kohë për të. Lexonin libra, formonin pazëll, luanin lojën “Ndjekja e thesarit”, krijonin kështjella të larta me jastëkë, shtronin një batanije prej pelushi në dyshemenë e sallonit dhe bënë piknik; argëtoheshin me shpirt. Dhe qeshnin për gjënë më të vogël, qeshnin aq fort derisa zërat arrinin në kupë të qiellit. Sytë e kaltër shprehës të vogëlushes mbusheshin me lot nga të qeshurat e shumta.

Atë natë, Olivia buzëqeshi edhe njëherë në gjumë dhe ndërroi krah.

Dhe atëherë, krejt papritur e papandehur, jeta e saj u rrokullis.

E zgjuan ca zëra të fortë, të ashpër.

- Policia! Policia! Hapeni derën!

U ul në krevatin e saj, ndërsa zemra i rrihte si e çmendur.

Drita në dhomën e saj u fik dhe u ndez. Ose kështu iu duk nga frika. Nuk guxonte të ngrihej të hapte derën e dhomës, të kuptonte çfarë po ndodhte.

- Baba, babush! - pëshpëriti e trembur.

U dëgjuan këmbë që vraponin. U dëgjuan të shara.

- Duart lart! Jeni i arrestuar! - bërtiti dikush.

Filloi të dridhej e gjitha. U mbulua me çarçaf deri te koka. Që të mbante larg të gjitha ato që dëgjonte. Mund të shikonte ndonjë makth, mund të zgjohej shumë shpejt.

- Baba! Kam frikë, baba! - bërtiti me sa fuqi kishte.

Dhe atëherë dera u hap papritur.

Në prag pa babanë e saj. I kishte duart të lidhura pas kurrizit. E mbanin dy burra të veshur me uniformë. Një i gjatë dhe një i shkurtër.

Zbriti nga krevati, ashtu zbathur siç ishte, dhe vrapoi pranë tij. E përqafoi. Por ai nuk u përkul, si bënte gjithmonë. Mbeti pa lëvizur.

- Gjithçka do të shkojë mirë, bija ime, gjithçka do të shkojë mirë, - e siguroi me një zë të çuditshëm e të trembur.

Ngriti kokën dhe e pa. Nga sytë e tij rridhnin lot. Shtangu. E kuptoi se po ndodhte diçka e keqe. Babai i saj, babai i saj i adhurueshëm nuk qante kurrë. Dhe atëherë, për herë të parë në jetë, nuk u besoi fjalëve të tij.

Nuk po i thoshte të vërtetën. Asgjë nuk do të shkonte mirë. E dinte, e ndiente. Dhe kishte filluar të dridhej brenda këmishës së hollë me lule e pa mëngë. Jo nga i ftohti, bënte ngrohtë, por nga disa ndjenja të panjohura që e kishin përfshirë plotësisht. Ishte tmerr dhe frikë, të ngatërruara së bashku.

- Ç' do të bëhet me fëmijën? - pyeti burrin, atë më të gjatën, babai i saj.

Ai i bëri shenjë tjetrit.

- Si të urdhëroni, zoti komisar! - pëshpëriti ai duke tundur kokën.

Rrëmbeu të atin e saj dhe iu zhdukën nga sytë.

- Jo, jo, babai im! - gërthiti Olimbia dhe bëri të vraponte pas tyre.

Por burri i gjatë e ndaloi.

U gjunjëzua pranë saj.

- Si të quajnë, vogëlushe? - e pyeti.

- Olimbia, - mërmëriti vajza.

Sytë e saj të kaltër, të magjishëm ishin të mbushur me lot.

- S'mund të shkosh bashkë me babanë tënd, por mund të vish me mua.

- Jo, jo, nuk do të vij me ty! Dua babanë tim! - bërtiti vogëlushja.

Por burri i gjatë e rrëmbeu në gjoksin e tij dhe u ngrit në këmbë.

- Mos ki frikë! Unë jam polic. I dua shumë fëmijët. Më quajnë Filipino, do të të marr me vete në rajon, - i tha me një ton të qetë.

Olimbia u kthye dhe pa krevatin e saj. Shikimi i vajti tek arushi i saj i dashur. Te Fufi. Me të flinte, edhe pse kishte mbushur dhjetë vjeç. Ishte miku i saj më i mirë. Shtriu dorën drejt tij.

Polici e kuptoi. U afrua te krevati, kapi arushin dhe ia dha. Olimbia e përqafoi fort, mbylli sytë dhe e lëshoi veten të lirë në fatin e vet.

As që e kuptoi se burri i çuditshëm hapi disa sirtarë dhe mori me vete disa rroba të sajat.

Më pas u gjend në një zyrë me hije të rëndë. Z. Filipo e mbështeti në një karrige të fortë e të parehatshme dhe e nxiti të vishte një palë pantallona, një bluzë e këpucë. Pastaj filloi të bënte disa telefonata njëra pas tjetrës.

- S'mendoj se kam nevojë për miratim, znj. Kapetani! Nuk keni besim tek unë? Jam drejtor komisarati, e marrtë djalli! I telefonova edhe prokurorit. Po, ramë dakord. Çfarë po ju shpjegoj kaq orë? Ju tani duhet të... Bukur, dërgojeni! Do ta pres. Kërkoj të vij në rajon tani! Më kuptoni? Për pak do të agojë, - bërtiti një moment dhe uli i tërbuar receptorin.

Olimbia shqeu sytë. Nuk kishte parë kurrë një njeri kaq të inatosur.

- Burokraci, vogëlushe! Burokraci! A nuk jetojmë në Greqi? Por nga t'i dish ti këto gjëra? - u përpoq t'i shpjegonte dhe i buzëqeshi fort.

Vogëlushja e analizoi. Ishte i gjatë, trupgjerë. Nuk dinte ta llogariste moshën, por dukej pak më i madh se babai i saj. Kishte një fytyrë të sjellshme, sy kafe

të butë dhe mjekër të rritur prej pak ditësh. E dëgjonin të gjithë te rajoni policor. I kujtonte Zeusin. I pëlqente shumë mitologjia greke. Dhe kishte imagjinuar si do të ishin edhe dymbëdhjetë zotat e Olimpmit.

- Kur do të vijë babi im? - pyeti me frikë.

Drejtori e pa. Vështrimi i tij ishte i mbushur me ngrohtësi.

- Babai yt do të vonojë të kthehet në shtëpinë tuaj. Por ti do të vish me mua, te shtëpia ime. Kam dhe unë një fëmijë. Një djalë. Është tre vjet më i madh se ti, e quajnë Theodhori, - iu përgjigj.

- Ku është babai im? - vazhdoi vogëlushja.

Por burri që ngjasonte me Zeusin nuk iu përgjigj.

- Jeni polic?

Drejtori pohoi duke lëvizur kokën.

- E çuat në burg?

- Ndonjëherë njerëzit gabojnë dhe...

- Babi im është më i miri në botë. Nuk gabon kurrë!
- protestoi Olivia.

Në atë çast hyri brenda një zonjë e shkurtër rrumbullake dhe drejtori psherëtiu i çliruar. I dha dorën.

- Jam punonjësja sociale që prisnit dhe...

Drejtori ia bëri me shenjë që të mos vazhdonte të fliste. U kthye nga ana e vogëlushes.

- Të lutem, mund të na lësh pak vetëm? Më prit jashtë! Do të të thërras shpejt, - iu lut.

Një lot i shpëtoi nga sytë e mbushur me lot të Olimbisë dhe i rrodhi në faqe. Por bëri siç i tha. U ngrit nga karrigia dhe me hapa të rëndë e të ngadaltë

doli jashtë zyrës së tij. U gjend në një sallë të rajonit policor, vrapoi të shtrihej në një divan metalik me lëkurë të zezë të grisur. Ishte kaq e lodhur. Kishte dhimbje kudo. Dhe jo vetëm në trupin e saj të vogël. E zhyti kokën në barkun e butë të arushit të saj, mbylli sytë dhe fjeti menjëherë.

Mendonte se kishin kaluar vetëm pak minuta, por gabonte. Kur i hapi sërish sytë, ishte sërish e shtrirë në një divan, por në një divan me jastëkë të butë. Gjithçka përreth saj dëshmonte se ndodhej në një sallon. Në një shtëpi që nuk e njihte. Zemra filloi t'i rrihte si e çoroditur. Dikush e kishte mbuluar me një batanije bojëqielli.

Shtrëngoi në gjoks Fufin, largoi batanijen dhe u ngrit në këmbë. Drita hynte mes grilave të një dërrë të madhe ballkoni. Bëri disa hapa dhe ndaloi papritur. Një djalë i dobët, më i gjatë se ajo, iu shfaq para syve. Mbante veshur një palë pizhame verore me vija, të mbërthyera shtrembër. Ndaloi edhe ai.

- Ej. Nga dole ti këtu? Dhe pse mban të përqafuar një arush? Foshnjë je? - i bërtiti i habitur.

- Unë... unë... - pëshpëriti Olimbia dhe uli kokën.

- Theodhori, u zgjove? Të lumtë, i miri im! - u dëgjua një zë i hollë femëror.

Olimbia u kthye andej nga vinte zëri dhe dallooi gruan më të bukur që kishte parë ndonjëherë në jetë.

Hapi gojën nga habia.

Për pak besoi se kishte mbirë nga përrallat që i lexonte çdo mbrëmje babai i saj kur ishte më e vogël. Ishte e gjatë dhe e dobët ajo gruaja, me të njëjtët flokë

të verdhë që kishte edhe djali pranë saj. Vetëm se të sajtë ishin të gjatë dhe i binin të shkujdesur mbi supe duke krijuar onde lozonjare. Sytë e saj kishin një ngjyrë smeraldi. Mbante veshur një robdëshambër të shkurtër femëror, që ia linte të lira këmbët e hijshme. Dhe fytyra e saj? Ah, fytyra e saj ishte si e kukullave.

Nuk e kishte njohur kurrë nënën e saj. Babai i kishte shpjeguar se kishte vdekur në lindje. Por e imagjinonte. Dhe kishte pamjen, hirin, elegancën dhe bukurinë e kësaj gruaje.

- Mama! - e ndërpreu djali. - Kush është kjo vajzë? Gruaja vrapoi pranë tij dhe e përqafoi.

- Nuk ka ç'të duhet, i dashur, - i tha dhe e pa vogëlushen me përçmim. - Kjo vajzë është lodra e re e babait tënd.

Olimbia ndjeu vështrimin e saj të rreptë. Dhe ngriu në vend kur kuptoi se sytë e gruas, që ishin ngulur mbi të sajtë, e kishin humbur atë ngjyrë magjepsëse smeraldi. Dukeshin të zinj, sterrë të zinj.

Ai ishte momenti kur e mori inat.

Me gjithë zemër.

- Vaso, zemra ime, ç'janë këto që thua? Ky fëmijë nuk është lodra e askujt, - tha polici që hyri me furi në sallon.

- Domethënë, është ndëshkimi im? - e pyeti dhe e pa me një vështrim të çuditshëm.

Polici nuk ua vuri veshin fjalëve të saj.

- Është vajza jonë. Motra jote e re, Theodhori. Do të kujdesesh për të, apo jo, biri im?

Gruaja e bukur i buzëqeshi me ngut. Me një të rrahur qepallash sytë e saj u qartësuan, gjetën sërish ngjyrën e tyre të vërtetë.

Theodhori vështroi i habitur babanë.

- Nuk qenkemi në terezi! Dhe nga mbiu kjo? - u ankua.

- Fol më mirë, të lutem! Do të ta shpjegoj kur të vijë momenti i duhur, - iu përgjigj i ati.

- Vërtet? Si të thuash ti! Po shkoj të luaj me top me shokët, - murmuriti dhe u zhduk që aty.

- Dhe si e kishe emrin, vajzë? - pyeti bukuroshja.

- Më quajnë Olimbi, - iu përgjigj vogëlushja dhe e pa me përbuzje.

- Olimbi. Jo, jo! Shumë i zakonshëm. Nuk shkon me stilin tonë. Mmm... Do të të thërrasim Olivia, - tha thuajse si me urdhër.

- Olivia Vagjena. Së shpejti do të marrësh mbiemrin tonë, vogëlushe, - plotësoi polici.

- Por... domethënë, mua... - mermëriti vogëlushja. Pushoi së foluri.

- Po? - tha burri me shikimin e ngrohtë.

“Mua më quajnë Argjiraki. Olimbi Argjiraki”, donte t’u bërtiste. Por u pendua. Uli kokën dhe nuk tha asgjë.

I pëlqente ose jo, nga ajo ditë fitoi një familje të re. Një mbiemër të ri, një emër të ri. Në fillim habitej kur e thërrisnin Olivia. Por kjo ishte një nga gjërat e pakta që e mërzisnin. Nga një çast në tjetrin ishte detyruar të mohonte jetën e saj të mëparshme. Duhej të harronte

babanë e saj, lidhjet emocionale me të, të luftonte të bëhej dikush tjetër. Ngatërrohej, ngatërrohej shumë.

Madje që ditën që njohu familjen Vagjena, e çuan në dhomën e saj. Ishte e mbushur me gjërat e zonjës Vaso, gruas që iu lutën ta thërriste “mama”. Dhe ishin kaq të bukura. Dhjetëra këpucë, çanta, fustane tejet luksoze, roba, bizhuteri.

E shikonte që i varroste nëpër kuti me një shprehi të vrazhdë në fytyrë. Vështrimi i saj ishte i mbushur me helm.

“Nuk është faji im, nuk është faji im!”, donte t’i bërtiste, por parapëlqeu ta mbante sërish gojën mbyllur.

Dhoma e saj e re nuk ishte ndonjë gjë e madhe. Kishte një krevat të drunjtë me një dyshek të fortë, një komodinë dhe një dollap të madh. Por ishte e saja. Kur mbyllte derën, mund të bëhej sërish Olimbi Argjiraki pa e marrë vesh askush. Mblidhej kruspull në krevatin e saj dhe mendja i rendte tek Orfea, babai i saj i adhuruar. Ku e kishte fshehur policia? Pas hekurave të burgut? Çfarë kishte bërë? Pse? Kur do ta shihte sërish?

Zonja e bukur nuk dinte të gatuante si babai i saj. Ushqimet që gatuante ishin pa shije. I hante me pahir.

- Mos më thuaj që nuk të pëlqejnë gatimet e mia! - i bërtiti një drekë duke e parë që shtrembëronte turinjtë teksa kapërdinte ushqimin.

- Më fal, zonjë! - pëshpëriti Olivia me pahir.

- Thamë që do më thërrasësh “mama”! Sa herë duhet të ta kujtoj? - i bërtiti ajo e inatosur.

Vogëlushja ndaloi së ngrëni. U ngrit nga karrigia e saj.

- Unë nuk kam mama. Nuk jeni mamaja ime! - tha dhe doli me vrap nga kuzhina.

Të njëjtën mbrëmje iu afrua polici. E kishte për zakon t'i hapte bisedën. E linte të fliste, e dëgjonte me vëmendje, me mirëkuptim, me interes. Ishte inkurajues me të.

- Përpiqu ta kuptosh time shoqe! Papritur i solla një fëmijë. Prandaj ankohet. Do t'i kalojë. Thellë-thellë, është njeri i mirë. Do të ma plotësosh dëshirën e ta thërrasësh “mama”? - e pyeti.

Zonja Vaso nuk ankohej.

Sillej sikur Olivia të mos ekzistonte në shtëpi. Si ishte e mundur ta quante “mama”? Nuk ishte nëna e saj dhe nuk do të bëhej kurrë. Por nuk donte t'ia thoshte. Nuk donte ta mërziste. Shenjë se kishte filluar ta simpatizonte.

- Jo! - i tha me inat dhe uli sytë.

- Atëherë do të përpiqesh ta thërrasësh Vaso dhe jo zonjë? - i propozoi duke buzëqeshur.

Vogëlushja tundi kokën.

- Kur do ta shoh babanë tim? - e pyeti papritur.

- Do të kalojë shumë kohë dhe...

- Është ende i burgosur?

Tani ishte radha e Filipos të tundte kokën.

- Olivia, u lëndove me gjithçka që ndodhi. Dhe tani në fillim do ta kesh pak të vështirë pranë nesh. Por të jap fjalën se do të bëj të pamundurën që të jesh

e lumtur. Ti nuk ke asnjë faj për shkeljet ligjore të babait tënd. Nuk është e drejtë të të shënjojë veprimi i tij.

- Çfarë do të thotë shkelje ligjore, zoti polic?

Burri qeshi me të madhe.

- Shkeli ligjet, vogëlushja ime. Dhe të lutem, të paktën mua përpiqu të më thërrasësh baba. Do të jetë një nga dhuratat më të mëdha të jetës sime. Gjithmonë e kam dashur një vajzë dhe Zoti i dëgjoji lutjet e mia.

Sytë e saj të kaltër u ngulën te sytë e tij. Pa e menduar aspak, u zhyt në krahët e tij të gjerë, në gjoksin e tij të madh, dhe për herë të parë që kur e humbi të atin nga sytë, nisi të qante.

Polici e shtrëngoi pranë vetes.

- Mërzitjen, dhimbjen, ankthin tënd, gjithçka që të mërzit do të përpiqem ta shëroj. Me dashurinë time! Më beson?

U largua nga krahët e tij dhe bëri një hap larg. Thithi hundët dhe e mati me sy. Sytë e tij i thoshin të vërtetën. Të njëjtën gjë dhe buzëqeshja e tij. Iu afrua dhe i dhuroi një puthje hezituese në faqe.

- Po, zoti polic, - i pëshpëriti.

Ai i përkëdheli hundën me gisht.

- Po, ba... ba, - tha atëherë me hezitim vajza. - E gjeta. Ty do të të thërras kështu, ndërsa babanë tim do ta thërras Orfea, - vazhdoi pastaj duke mbledhur buzët.

Kur burri me fytyrën e ëmbël filloi ta guduliste, ia plasi së qeshurës.

Jeta e saj e re sapo kishte filluar. Ndonjëherë me ditë të lara me diell, herë të tjera me ditë me re. Gjendej me një këmbë në realitet dhe me tjetrën në botën e saj imagjinare. Një herë qeshte me të madhe, një herë bëhej melankolike. Nuk ia tha askujt, por çdo ditë priste të kthehej Orfea. T'i thoshte se ishte bërë një gabim, se nuk e meritonte burgun; ta merrte dhe të ktheheshin në shtëpinë e tyre.

- Jam i sigurt se gjykata do ta dënojë. Bëri grabitje pas vrasjes. Besoj se do të dënohet që në shkallë të parë me burgim të përjetshëm, se do të kalojë në burg nja 20 vjet, - tha polici.

Ishte një mesditë korriku dhe po rrinte në kuzhinë me të shoqen. Olivia e dëgjoji pa dashje. Ndodhej në korridor. Qëndroi dhe mbajti vesh.

- Ama më bën përshtypje lehtësia me të cilën firmosi për të marrë fëmijën e tij, - vërejti zonja Vaso.

Dhe atëherë, Olivia e kuptoi se po flisnin për Orfean. U zbardh e gjitha, për pak ulëriti nga llahtaria. E mbylli gojën me duart e saj.

Zot, kishte vrarë vërtet dikë njeriu që adhuronte? A ishte e mundur? Ishte kaq i mirë, kaq i ëmbël.

Mori frymë thellë dhe vazhdoi të dëgjonte bisedën e tyre.

- E pret një jetë e tërë në burg. E firmosi menjëherë, pa e menduar aspak. Ç'mund të bënte tjetër? Nuk kundërshtoi aspak për birësimin. Përkundrazi, më falënderoi. Nuk mund ta di si u ngatërrua kaq keq, por kam Zotin dëshmitar se më duket njeri i mirë, - komentoi babai i saj i ri.

- Domethënë, vogëlushja do të hedhë rrënjë këtu, - tha gruaja e tij me sarkazëm.

- Kur do të bindesh më në fund? Në fund të fundit, ma ke borxh. Vogëlushja është fëmija ynë tashmë. Do apo nuk do! E vetmja gjë që presim që ta festojmë janë letrat e gjykatës, - bërtiti i egërsuar Filipo dhe përplasi fort dorën në tavolinë.

Olivia nuk duroi dot më. U kthye me vrap në dhomën e saj dhe mbylli derën.

Ah, sa shumë do të donte të mbyllej dhe ajo bashkë me Orfean në një qeli të burgut! Të rritej në krahët e tij, edhe sikur të mos dilte më kurrë jashtë. Polici ishte i mirë, e simpatizonte, e kishte marrë pranë vetes. I jepte ushqim, i blinte lodra, por... Por nuk ishte babai i saj i vërtetë.

Orfea kishte firmosur dokumentet e nevojshme për ta hequr qafe? E kishte braktisur? E kishte dorëzuar te të tjerë? E kishte tradhtuar?

Nuk mund ta besonte!

Gjithçka që i përkiste në të shkuarën nuk ekzistonte më - kujtime, të qeshura, të qara, gjithë jeta e saj e vogël me të ishte zhdukur. Ndjenja trishtimi dhe mungese e përfshinë.

Ndjenja që, me dëshirë ose jo, duhej t'i ndrydhte.

U ul në krevat dhe e mbështeti kokën te gjunjët e saj. Gjëja e vetme që kishte dhe që i përkiste ishte Fufi i saj.

Fjalët e Orfeas i kumbuan në vesh.

- Je njësoj si flutura e dashurisë, micka ime.

Gjithë fjalët e tij ishin gënjeshtër. Nuk e donte. Ai që të do nuk të largon nga vetja. Kishte vrarë një njeri? Jo, jo! Mendja e saj fëmijërore nuk mund ta pranonte.

Ishte e çuditshme, kaq e çuditshme, por sa më shumë kalonin ditët, pamja e tij zbehej brenda saj. I shtrëngoi sytë me forcë. U përpoq ta kujtonte, ta sillte në mendje, ta harronte tradhtinë e tij. Por i shpëtoi. U bë hije.

Përqafoi kafshën prej pelushi dhe e lau me lotët e saj. Arushi i saj i kishte të nevojshme. E freskuan. Ajo ditë vere ishte e nxehtë. Digjte e gjitha. Ishte dita kur Olivia mësoi se babai i saj e kishte mohuar. Se ishte vajza e një vrasësi.

Ndenji me orë të tëra e mbyllur në dhomën e saj derisa nuk duroi dot më. U hodh nga krevati dhe nisi të kërcente. Me muzikën që luhej në mendjen e saj. Vallëzonte, vallëzonte zbathur mbi parketin e drunjte dhe përpiqej të harronte cila ishte, cila duhej të bëhej.

- Je e mrekullueshme! E mrekullueshme! Ke talent, vogëlushja ime, - bërtiti i lumtur polici.

Ndaloi së vallëzuar dhe e pa në sy. Nuk e kishte vënë re se kaq kohë ai e shikonte nga e hapura e derës. Iu afrua, u përpoq t'i fshinte djersën nga fytyra me dorën e vet.

- Si thua të bëjmë një shëtitje bashkë? - i propozoi.

Nuk hezitoi t'i jepte dorën. Ia kishte fituar besimin. Gjendej pranë saj edhe netëve kur shikonte makthe dhe zgjohej e mbushur në djersë duke u dridhur dhe duke u ngashëryer.

Në ëndrrat e saj ishte e vetme, krejt e vetme. Ishte errësirë, dëgjonte zëra të fortë, të ashpër, zëra që i afroreshin gjithnjë e më shumë.

- Tani je pranë meje! Nuk do të të lëndojë askush, - e qetësonte dhe e shtrëngonte te vetja derisa të qetësohej.

E meritonte ta thërriste “baba”.

Babë e bijë dolën jashtë së bashku. Filipo mbante veshur uniformën e tij. Ndjeu krenari kur po ecte pranë tij. Rrinin në “Pagrati”, në rrugën “Konstantino Manu”, në një shtëpi të vogël njëkatëshe që mbytej mes pallateve. Kishte tri dhoma gjumi, sallon, kuzhinë, një banjë dhe ishte pranë shkollës ku do të shkonte në shtator. Kishin një oborr të vogël dhe shumë lule shumëngjyrëshe.

Babai i saj i ri i adhuronte lulet, kujdesej vetë për to. Adhuronte dhe kafshët e rrugës. Jashtë shtëpisë së tij qëndronin një tufë prej tyre, në çdo qoshe, duke pritur vëmendjen dhe kujdesin e tij.

I pëlqente oborri i vogël, por edhe ulliri i madh e i fryrë, që kishte mbirë në trotuarin jashtë shtëpisë, ku shpesh ngrinin fole zogjtë. Atë korrik, mes gjetheve të tij kishte gjetur strehë edhe një gjinkallë e gjorë.

Një gjinkallë në “Pagrati”. Tingulli i saj karakteristik kishte tradhtuar praninë e saj dhe Olivia ishte çmendur pas saj, edhe pse i vinte keq. Kishte lexuar se i kishin mbetur vetëm gjashtë javë jetë. Kënga e saj e fortë i dukej e dëshpëruar. Kërkonte partnerin e saj, diçka që ishte e pamundur të ndodhte në një

lagje të Athinës. Kishte luftuar për ta gjetur atë gjinkallë. Ngjyra e saj ishte e njëjtë me ngjyrën e trungut të ullirit. Kur ia doli ta gjente, u ndje njësh me të. Kërkonte dëshpërimisht partnerin e saj, një gjinkallë femër që nuk do t'i afrohej kurrë, si ajo që kishte aq mall për babanë e saj që nuk do të dilte kurrë nga burgu.

I pëlqente edhe “Pagrati”. Me Orfean jetonin në “Kipseli”, në një pallat gri mbi rrugën “Patisation”, në një apartament në katin e parë. Me pamje nga ndriçuesit e trishtë, por edhe te tendat e grisura, pyllin e antenave, rrobat e varura në tela, të lidhura në kangjella të ndryshkura në ballkonet e vogla, dollapë plastikë.

Shumë shpejt u gjendën në rrugën “Vasilii Lasku”, jashtë një shkolle baleti.

- Si thua? Do të të regjistroj? - e pyeti Filipo.

Olivia nuk u përgjigj. Filloi të kërcente nga gëzimi.

- Vetëm të ma thoshe, - tha ai i lumtur.

- Ç’do të bëjmë më shumë për ty? Mos të duket vetja mbretëreshë? Mos do të mësosh edhe ndonjë gjuhë të huaj? Piano? Si thua? - i bërtiti e tërbuar zonja Vaso të njëjtën mbrëmje në kuzhinë, në momentin që po u shërbente ushqimin fëmijëve.

Sytë e Olivias u mbushën me lot. Gruaja e policit nuk e pëlqente. Rrallë i drejtonte fjalën, ndërkohë që e shikonte me gjysmë syri. Dhe kishte kaq shumë nevojë për një përqafim femëror, dhe donte kaq shumë ta fitonte edhe ajo, më në fund, një nënë.

Nuk foli. Por nuk mundi të kapërdinte asnjë kafshatë sado që u përpoq. U ngrit nga tavolina dhe u mbyll në dhomën e saj.

Tani kishte shkollën e re për të menduar dhe dhoma e saj që u mbush sërish me këpucë baleti, streçe, trupore dhe funde prej tyli. Por edhe mësuesen e baletit, që shumë shpejt thoshte vetëm fjalë të mira për nxënësen e saj të re.

Ndryshe nga nëna e tij, Theodhori u bë miku i saj më i mirë. Nuk u bë kurrë xheloz për praninë e saj dhe ishte gjithmonë miqësor me të. Filloi ta adhuronte. E bënte vazhdimisht për të qeshur, luante lojëra djalërore me të, e kishte për zakon t'i tregonte të rejtat e tij, i kuptonte ndjenjat e saj dhe e qetësonte.

- Të kërkoj ndjesë për mamanë time. Të sillet keq, - i tha një natë.

- Nuk është faji yt.

- Duhet të mësosh t'i lexosh njerëzit, Olimbi.

Kur ishin vetëm, e thërriste gjithmonë me emrin e vjetër. Nuk pajtohej me vendimin e së ëmës për t'i ndryshuar emrin.

- Por çfarë janë njerëzit? Libra? Domethënë, si t'i lexoj? - u habit ajo.

- Të gjithë ne jemi libra që shkruhen dalëngadalë. Të gjitha ato që bëjmë dhe themi kanë një arsye. Duhet të kërkojsh të gjesh se çfarë fsheh kushdo prapa fjalëve që thotë.

Olivia nuk e kuptoi ç'donte të thoshte.

- Domethënë?

- Të akuzoi se je lodra e babait, sepse ndien xheloz. Ndien xheloz për çfarëdo që dashuron ai.

- Flet si të mëdhenjtë, e di? Çfarë do të bëhesh kur të rritesh? - e pyeti e entuziazmuar.

- Psikolog. Që të shëroj sëmundjet e shpirtit.

- Dhe unë jam pacientja jote e parë? - pyeti Olivia duke qeshur dhe i dhuroi një puthje në faqe.

Theodhori u skuq i tëri dhe nisi ta shikonte i habitur. Ndryshoi shpejt temë dhe filloi të fliste për nënën e tij. I shpjegoi se punonte si modele për katalogë reklamash dhe spote televizive, derisa u ngatërrua keq. Filipo e takoi për herë të parë në një aksion policor. I qëndroi pranë, e ndihmoi të mos kishte telashe. Shpejt e dashuroi dhe i kërkoi të martoheshin. Dhe ajo nuk hezitoi ta pranonte propozimin e tij, edhe pse e kalonte katërmëdhjetë vite. Tanimë polici po mbyllte të pesëdhjetat dhe mamaja e tij ishte tridhjetë e gjashtë vjeçe.

Olivia i thithte fjalët e tij.

- Ç' do të thuash që u ngatërrua? Çfarë bëri? - e pyeti.

- Je ende e vogël që të të shpjegoj të tilla gjëra, - i tha.

Kur ajo këmbënguli, filloi ta ndiqte në gjithë shtëpinë, ta bënte të shkrihej së qeshuri.

- Nuk të mjafton që sjell vërdallë tim shoq? Vdes të më vjedhësh edhe tim bir? - i bërtiti të njëjtën ditë zonja Vaso.

Olivia e pa.

- Kur ju pashë për herë të parë u magjepsa. Jeni kaq e bukur, kaq elegante. Mamaja që doja gjithmonë. Por...

Pushoi së foluri.

- Pse ndieni xhelozri për mua? Mendoni se dua t'ju bëj keq? - i tha pa iu dridhur qerpiku.

Zonja Vaso e pa me një vështrim që nxirrte flakë. Pastaj e qëllloi me shpullë.

Ishte njeriu i parë që ngriti dorë ndaj saj, njeriu i parë që e lëndoi kaq shumë. Përveç babait të saj. Që e braktisi si i pashpirt.

Nuk foli me askënd për atë shpullë. Nuk donte të hapte plagë të tjera. Thjesht vriste mendjen pse iu soll kështu “mamaja” e saj. Ishte inatosur me të. Ishte zemëruar tmerrësisht shumë. Për herë të dytë në jetë ishte përballur me refuzimin. Dhimbja që ndiente ishte e etur për hakmarrje. Me gjithë ngjarjet që përjetonte, kishte filluar të rritej para kohe.

Në shtator u përshtat me lehtësi në shkollën e saj të re. Nuk e vështirësoi aspak klasa e pestë fillore. Përpiqej të mos mërzhitej me sjelljen e papranueshme të zonjës Vaso. Mësimet, baleti, shoqëria e Theodhorit, por edhe butësia e babait të saj i jepnin kurajë. Jeta e saj rridhte qetësisht, madje u bë edhe anëtare e ekipit të futbollit të vajzave të shkollës së saj. Por sado që e dëshironte, nuk e harronte dot Orfean.

- Kur do ta shoh babanë tim... Orfean në burg? - pyeti policin.

- Nuk të do pranë, vogëlushja ime. Nuk do të të ngatërrojë më në jetën e vet. Por mos u shqetëso!

E kam vizituar disa herë. Mirë është. Më kërkoi të të them që ta harrosh, - i shpjegoi dhe e përqafoi për ta ngushëlluar.

Por nuk ia zbuti dhimbjen dhe zemërimin.

Pas një viti u shpall vendimi i gjykatës, që pranonte birësimin e saj nga familja Vagjena.

Zonja Vaso i shtrembëroi turinjte edhe njëherë. Filipo fluturonte mbi re nga gëzimi. Atë ditë i dhuroi këpucët e para të baletit. Që të ngrihej në majë të gishtave, pa përdredhur apo thyer gishtat. Ishin rozë, të veshura me një copë mëndafshi. E çmendën!

Tetëmbëdhjetë muaj më vonë, fjalët e Filipos u vërtetuan. Orfea Argjiraki u dënua me burgim të përjetshëm në gjykatën e shkallës së parë.

Olivia mësoi se do ta burgosnin në burgun e Koridhalosë dhe ndjeu sikur t'i mbyllej një derë edhe jetës së saj. E luti Theodhorin të mos i thërriste më me emrin e vjetër dhe bëri të pamundurën që ta harronte Orfean përgjithmonë, ashtu si dëshironte ai.

Sa do të donte të bëhej edhe ajo police si babai i saj i ri. Vdiste të ndiqte të këqijte, ta respektonin të gjithë siç e respektonin atë. Vallë reagonte kundrejt gjithçkaje që kishte bërë njeriu që e solli në jetë? Kundrejt gjithë gjërave të paligjshme, kriminale që e larguan prej saj?

Dëshira e saj për Orfean, dashuria që ndiente u shndërrua në inat. Ishte egoist. Mendonte vetëm veten, shkatërroi marrëdhënien me fëmijën e tij, i mori jetën një njeriu. Nuk e meritonte ta kujtonte, nuk e meritonte ta mendonte.

A nuk do të ishte e mrekullueshme të fitonte dhe ajo një qëllim në jetën e saj? Si njeriu që adhuronte, si Filipo? Të ofronte, të ndihmonte njerëzit, të mbyllte në burg të këqijtë? T'i ndëshkonte, jo vetëm për krimin që kryenin, por edhe, sepse bënë mijëra copa zemrën e fëmijëve të tyre. Vallë çfarë faji kishin fëmijët e tyre? Çfarë faji kishte ajo për ndarjen e dhunshme nga babai i saj që dikur e adhuronte? Si mund ta përballonte, apo më keq akoma, të harronte njëherë e përgjithmonë frikën, inatin, zhgënjimin, fajin, refuzimin, turpin...

Jo, jo! Nuk duhej të mendonte kështu. Ishte me fat. I kishte ndryshuar jeta.

Nuk ishte Olimbia Argjiraki, vajza e vrasësit.

Ishte Olivia Vagjena, vajza e oficerit më të rëndësishëm që ekzistonte në botë.

Atë natë, kur Filipo iu afrua si çdo natë pranë shtratit për ta puthur, Olivia ia rrethoi duart përreth qafës.

- Të dua, baba! - i tha.

Fytyra e tij shkëlqeu.

- Edhe unë, vogëlushja ime. Deri në qiell dhe akoma më tej, - i pëshpëriti.

Dhe ishte dashuria e saj për të që e bëri të mos i tregonte gjithë të këqijat që panë sytë e saj kohë më vonë. Ishte një drekë kur u kthye pak më herët nga shkolla në shtëpi me këmbë. Tanimë shkonte në gjimnaz dhe babai i saj i tregonte besim.

Hapi derën e jashtme me çelësin e vet.

Papritur, dëgjoi disa zhurma të prera si gulçim. Kuptoi se po gulçonte zonja Vaso. Çfarë kishte pësuar? Ishte e sëmurë?

Vazhdoi drejt hollit, drejt dhomës së gjumit të prindërve të saj birësues. Gulçimet vazhdonin. Dhe dera ishte gjysmë e hapur. Bëri një-dy hapa dhe ndaloi. Sepse ajo që pa pas asaj dere e bëri të rrëqetëj e gjitha.

Një burrë, një burrë i panjohur ishte shtrirë mbi gruan e oficerit. Ishte lakuriq. Dhe lëvizte me vrull mbi krevat. Mbi krevatin që zonja Vaso e ndante me oficerin. Mos donte t'i bënte keq? Nuk e kuptoi. Në momentin që po bëhej gati të vraponte ta ndihmonte, ajo filloi të qeshte.

- Ah, Sava! Je i mrekullueshëm, i dashur, i mrekullueshëm! - i bërtiti të panjohurit.

Olivia ngriu. Pra, zonja Vaso nuk po vuante, pra, ai burrë bënte me të... dashuri?

E dinte ç'do të thoshte kontakt erotik, si funksiononte trupi, ia kishte shpjeguar Orfea kur ishte ende e vogël. Kishte parë çifte të bënin dashuri edhe në televizor.

Megjithatë, i erdhi aq shumë për të vjellë kur pa trupin lakuriq të burrit në krahët e zonjës Vaso.

Iku larg dhomës së gjumit sa më shpejt mundi. Ishte trembëdhjetë vjeçe, dhe ishte ndërgjegjësuar tashmë se njerëzit që do të tradhtojnë.

➤ Olivia ➤

2

Dëgjoja ulërima hysterike. Nga treni i frikës. Fillova të vrapoja. U fsheha në një labirint me pasqyra shpërfytyruese. U pendova. Shumë shpejt kuptova se isha bllokuar. Fillova të çirresha.

- Baba! Babai im!

Dridheshja e gjitha, por si përfundim arrita ta gjeja daljen. Papritur u gjenda lart te balerina. Nuk e di sesi. Gjithçka më vërtitej si e çmendur.

- Dua të zbres. Të lutem! - bërtisja, por nuk më dëgjonte askush.

Nuk ishte askush. Dhe unë papritur u gjenda e ulur brenda një makine dhe duke kthyer timonin makina përplaslet me të gjitha makinat e tjera në pistë. Zhurma e përplasjes më shqetësonte. I mbylla sytë fort, lashë timonin dhe kërcëva. Në trampolinë. Sipërfaqja e saj më fluturonte lart në ajër. Luftoja të arrija akoma më lart, aty ku ndalonin ëndrrat e mia.

- Baba! Babai im! - bërtisja me gjithë fuqinë time.

Por askush nuk më përgjigjej. As babai im.

Fillova të rrotullohesha si karusel, e hipur mbi një kalë druri të bardhë e të mrekullueshëm. Veshët m'i

ëmbëlsonte një ninullë. Një ninullë shumë e bukur. Ajo që më këndonte babai im çdo natë pak para se të mbyllja sytë:

Do të qëndis mbi shalën e kalit tënd

Me një sërë gurësh prej diamanti

Vajtje-ardhjen e hënës

Në ujin pellazgjik...

- Baba! Babai im! - vazhdoja të bërtisja me të gjithë fuqinë.

Por nuk ishte askund.

Vija vërdallë e dëshpëruar, e humbur në parkun e lojërave të shkretuar, e kërkoja, me një karamele pambuku në ngjyrë rozë në krah dhe tullumbace. Shumë tullumbace. Blu, të kuqe dhe të verdha, që t'i liroja për të fluturuar lart, që i shikoja me sytë me lot të largoheshin drejt qiellit.

Të dhemb shumë kur kërkon babanë tënd dhe nuk e gjen dot...

Një e shtënë. Vrapova përreth. U ktheva nga ana e zhurmës. Dhe atëherë e pashë. Në dorë mbante një pushkë. Kishte qenë për qitje. Vrapova pranë tij.

- Ah, babai im, sa e lumtur jam që të gjeta më në fund! - bërtita e gëzuar.

Nuk më dëgjoi. As që u kthye të më shikonte. Ishte sërish gati për të qëlluar. Kërceva nga lumturia. Babai im dinte të qëllonte në shenjë, gjithmonë krenohej për shënjestrën që kishte. Shumë shpejt do ma mbushte gjoksin me lodra prej pelushi.

Ngriti pushkën. Shënjoi. Qëlloi edhe njëherë! U ngrita në majë të gishtave. Vdisja të shikoja në

rafte arusha, lepurusha, dhjetëra lodra, të zgjidhja. U shastisa.

Përballë meje në këmbë, në rresht, pa lëvizur, burra, gra dhe fëmijë e shikonin me një tmerr në sy. Nuk qëllonte shënjestra. Qëllonte njerëz.

Bërtita! Ishte vrasës, vrasës!

U ngrita ndenjtur në krevatin tim.

Isha qull në djersë. Zemra më rrihte si e çmendur. Merrja frymë thellë. E dija. Një tjetër makth. Një tjetër natë larg kriminelit që mbyllën pas hekurave të burgut.

Nuk isha e vogël, por makthet vazhdonin të më bënë shoqëri. Tashmë kisha mësuar të dalloja realitetin nga ëndrrat e mia të frikshme. Por nuk ishte e mundur t'i ndaloja, edhe pse e dija se reagoja ndaj një fakti traumatizues që përgjaku fëmijërinë time.

U mbylla në vetvete. Dhe fillova të vëreja përreth. Njerëzit. Përpiqesha të kuptoja çfarë mendonin. Çfarë ndjenjash fshiheshin pas çdo fjale të tyre? Sepse të tjera thonë e të tjera bëjnë. Sepse, në të vërtetë, askush nuk është ashtu si duket. E kisha kuptuar mirë. Nga Orfea. Dhe ndihesha e prekshme dhe luftoja të mbroja veten duke u përpjekur të kuptoja çfarë mendon, si reagon. Vija re lëvizjet, shprehjet, vështrimin e tij. Luftoja të futesha në mendjen e shokëve të mi të klasës, t'i "lexoja", t'i kuptoja. Karakteret e tyre ndryshonin aq shumë dhe unë kërkoja të gjeja të pavlerët dhe t'i ruaja që të mos arrinin të më lëndonin.

- Klasa jonë ka vetëm thesare. Dhe këto thesare jeni ju. Vetëm se doni fërkim që të shkëlqeni. Dhe para së gjithash duhet të ndërgjegjësoheni se nuk ekziston

përsosmëria. As në karakter, e as në pamjen e jashtme. Dallimi mes nesh është ai që i bën marrëdhëniet tona thelbësore dhe të vërteta, - e theksonte shpesh një mësuesja jonë.

E besova. Dhe vura gjithë forcat e mia për të ndryshuar mënyrën e të menduarit, të mos i gjykoja të tjerët kaq ashpër. Që e vogël kërkoja të zbuloja kush jam, luftoja për ta mësuar më shumë për veten time. Ndoshta, sepse e dija që isha e birësuar, se familja me të cilën jetoja nuk ishte e imja, se nuk kisha asnjë lidhje biologjike me të.

Filipo, babai im, ishte i butë, simpatik. Më quante vajzën e zemrës. Më donte. Më ndihmonte të mbysja inatin, dhimbjen time. Isha borxhlie ndaj tij.

Përkundrazi, zonja Vaso, gruaja e tij s'më duroi dot kurrë. Ishte e vështirë, shumë e vështirë të interpretoja mendimet dhe ndjenjat e saj. Ashpërsinë e saj nuk mund ta ndryshoja, sido që të sillësja. Por mund ta kontrolloja sjelljen e saj që nga ajo ditë kur e pashë në krahët e dashnorit të saj. Nuk durova. Që atëherë i flisja ftohtë, i hidhja kunja dhe atëherë ajo bëhej bishë. Grindej, ankohej dhe e detyronte babanë tim të më ndëshkonte.

- Ti që je kaq e ëmbël, pse flet keq? Çfarë të ka bërë? Duhet ta respektosh, Olivia. Përndryshe...

- Përndryshe, çfarë? - e pyeta.

Uli kokën.

- Mos më detyro të të ndëshkoj! Unë nuk i rris fëmijët me ndëshkime. Nuk është e drejtë të humbasë ky besim i çmuar mes nesh, - më shpjegoi.

U largova me sytë e mbushur me lot prej tij. Isha gati t'i shpallja luftë zonjës Vaso.

Mbrëmjen tjetër, kur mbetëm vetëm në kuzhinë, mora frymë thellë.

- Nëse vazhdoni të flisni kundër meje, do ta hap edhe unë gojën, - e paralajmërova.

E humbi me fjalët e mia. U kthye dhe më pa. Shikimi i saj kullonte helm.

- Çfarë do të thuash? Çfarë di ti për mua? Pa dalë ende nga veza, ke guximin të më kërcënosh? - pyeti me të bërtitur.

- Të kërcënoj do të thotë të detyroj dikë të bëjë diçka pa dëshirë. Pra, nëse ajo që doni është që të flisni keq për mua, atëherë po do t'ju kërcënoj, - iu përgjigja me arrogancë.

- Nuk të vjen turp që i flet kështu mamasë sate? - më bërtiti dhe lëvizi egërsisht drejt meje.

Bëra një hap mbrapa. Nuk do ta lejoja të më godiste sërish.

- Bukur, mama! Shembuj të mirë u jepni fëmijëve tuaj, - iu përgjigja gjithë ironi.

- Moj, vajzë e keqe, moj...! - filloi.

- Nuk ju vjen turp që tradhtoni burrin tuaj? - e ndërpreva.

Ngriu. Ndaloi së foluri. U zbardh e gjitha.

Papritur në kuzhinë hyri Theodhori. U tremba. Por më shumë u tremb zonja Vaso. Ishte kthyer në shtëpi pa e kuptuar. Shkonte në vit të tretë të shkollës së mesme dhe mungonte me orë të tëra në kursin e tij.

- Ç'janë këto që thotë? Tradhton babanë tim? - pyeti Theodhori.

Nëna e tij uli kokën.

Theodhori u kthye nga ana ime.

- Olivia?! - pyeti.

- Jo, mos! Të lutem! - pëshpëriti gruaja që më kishte inat. Dhe më pa me një vështrim ndryshe këtë herë. Vështrim lutës.

- Domethënë, unë... - thashë.

Nuk doja ta lëndoja Theodhorin.

- Nuk tradhtoj askënd. Është gënjeshtare, është budallaqe. Jepini, ikni tani, kam punë!

Më hipi gjaku në tru. Nuk durova më.

- Nuk tradhtoni askënd? Mirë. Çfarë ka për të thënë zoti Sava për këtë? Burri që ju pashë bashkë me të në krevat?

Theodhori nxori një të çjerrë.

Zonja Vaso erdhi në drejtimin tim me qëllime të egra. Djali i saj iu hodh sipër dhe e ndaloi.

- Nuk je fëmijë ti, je djalli vetë! - më bërtiti mamaja e tij sipër supit të tij.

Theodhori e shtyu.

- Djalli je ti, mama! - i tha dhe bëri sikur donte ta pështynte.

Më pas më kapi nga dora, më çoi në dhomën e tij dhe e mbylli derën me forcë.

- Më fal! - i pëshpërita. - Nuk duhej ta kisha zbuluar sekretin e saj. Por u inatoso aq shumë me ato që thotë vazhdimisht kundër meje.

Më erdhi pranë.

- Ti më kërkon falje?! Meriton përbuzjen tënde!
Nuk e di me ç'njeri ke të bësh.

Nuk e kuptova ku e kishte fjalën, por duhej të justifikoja gjithçka që kisha guxuar të nxirrja nga goja për mamanë e tij.

- Për shumë muaj e pashë me atë zotërinë. Po bëhet një vit. Nuk e di kush është. Nuk i thashë askujt asgjë. E mbaja të fshehtë kaq kohë. Nuk doja të mërzisja babanë dhe... Ah, nuk duroj dot ta shikoj ta përkëdhelë dhe ta puthë ndërkohë që shkon me një burrë tjetër. Dhe të largohet gjithnjë nga shtëpia duke nxjerrë lloj-lloj justifikimesh. Jam e sigurt se vrapon të takojë atë. E quajnë Sava. Kështu e thërriste. Filipo është kaq njeri i mirë dhe...

- Të gjitha këto i konsideron të parëndësishme. Më vjen keq që e them, por është me dy fytyra, - bërtiti.

- Çfarë ka bërë mamaja jote, Theodhori? Pse flet kaq keq për të? - e pyeta e habitur.

Nuk foli. Sytë e tij kafe u mbushën me lot. Ishte hera e parë që e shikojta me sytë me lot dhe për momentin e humba.

U ul në krevatin e tij, u ula dhe unë pranë tij. Fillova të përkëdhelja flokët e shëndetshëm biondë. Më buzëqeshi me dhimbje.

- Filipon e dua shumë dhe unë. Por është koha ta mësossh. As unë nuk jam fëmija i tij, Olivia. Dua të them se nuk është babai im biologjik, - më pëshpëriti pastaj.

Mezi e dëgjova. Dukej sikur nuk donte të dëgjoheshin fjalët e tij. E pashë e tronditur. U ngrita në këmbë, bëra një-dy hapa dhe pastaj u ula sërish në krah të tij. Nuk më mbanin këmbët.

- Nuk e besoj! Vërtet e ke?

- Vasoja, mamaja ime punonte në një rrjet të pistë. Në një zyrë shoqëruesesh luksi. Domethënë, ishte prostitutë.

- Ah, nuk mund të dëgjoj të flasësh kështu për të. Fundja, është...

- Njeriu që më solli në jetë? Edhe? Nëse nuk do të ishte oficeri, tani nuk do të kisha lindur. U kujdes për të kur kishte nevojë, pagoi avokatë, e ndihmoi t'i shpëtonte burgut. Edhe kur kuptoi se priste fëmijë nga një burrë i panjohur, nga një klient i saj, i qëndroi pranë, i bëri presion që ta mbante, i kërkoi që të martohej me të. Isha i vogël kur Filipo ma tregoi të gjithë të vërtetën. Ishte i sinqertë me mua. Nuk donte ta mësoja nga dikush tjetër dhe të lëndohesha. Madje më kërkoi ta falja për gabimet e saj. Është kaq i mirë. E adhuroj dhe më adhuron.

Tunda kokën.

- E di. Është njeri-engjell.

- E gënjeu dhe me sa zbulove vetë, vazhdon ta gënjejë. Siç e sheh, bëri sikur e donte. Që të vinte kurorë, që të fitonte siguri. Por është pa vlerë, kaq pa vlerë. Egoiste, e pasjellshme, manipuluese...

- Pse nuk i flet sinqerisht? Nëse nuk e dashuron, mund të largohet dhe të mos vazhdojë më ta gënjejë.

Të kërkojë divorc.

Theodhori buzëqeshi me ironi.

- Duket se burri me të cilin është ngatërruar nuk mundet ta mbajë. E vetmja që i intereson është luksi, akoma nuk e ke kuptuar? Më vjen turp për të! Brenda vetes sime fsheh kaq shumë inat. Ndihem... Ndihem i tradhtuar. Sikur të më tradhtojë edhe mua bashkë me të.

I shtrëngova dorën dhe nuk fola. Shprehej kaq ashpër për nënën e tij, saqë nuk mund të thosha asgjë tjetër.

- Ajo që nuk kuptova kurrë është që pse kënaqet kur sillet me ashpërsi. Është xheloze për dashurinë që tregon babai ndaj teje, edhe pse nuk do t'ia dijë për të, - vazhdoi dhe më shtrëngoi nga supet.

- Me të vërtetë nuk di çfarë të them, - i pëshpërita.

- Ti të paktën e di kush është babai yt biologjik. Ndërsa unë... U katandisa aq keq sa kur eci nëpër rrugë, shikoj burrat për të parë se me kë ngjaj. Të besohet?

- Babai im, ai biologjiku është vrasës, Theodhori. Vrau një njeri.

- Edhe imi mund të jetë kushdo nga ata që qarkullon mes nesh.

- Kaq keq, hë? - i thashë me shaka.

Tundi kokën në shenjë pohimi. Dhe ia plasëm të dy së qeshurës.

Atë natë u zhyta në kujtimet e mia. Më në fund hapa valixhen që më kishte dhënë oficeri rreth katër

vite më parë. Atëherë kur vizitoi për herë të fundit shtëpinë që kishte marrë me qira Orfea, dhe mori disa gjëra me vete.

- Këto janë për ty, vogëlushja ime. Shtëpia iu dha dikujt tjetër me qira dhe... Të solla disa nga lodrat, disa fotografi, - më tha.

E pashë. E ktheva fytyrën në anën tjetër.

Nuk duroja dot të lëndohesha më.

- Do ta ngjis valixhen lart në dollap. E kuptoj si ndihesh. Nëse do, e hap, nëse nuk do shpërfille, - më propozoi.

Dhe ashtu bëra. E shpërfilla. Për shumë vite. E dija arsyen. Nuk doja të lëndohesha më shumë. Por tani dhimbja ishte pakësuar disi.

Atë natë që dolën gjithë ato të vërteta në sipërfaqe, e zbrita nga dollapi, e hapa. Isha tronditur me të gjitha ato që më rrëfeu Theodhori, ndërsa unë e dija kush ishte babai im biologjik. Dhe doja të zhytesha pak në kujtimet e mia me të. Doja të kujtoja sigurinë e harruar, atë siguri që e ndieja pranë tij. Ato pak gjëra që jetuam së bashku.

E mbaja mend shumë mirë këtë valixhe me ngjyrë kafe. Na shoqëronte në gjithë udhëtimet tona. E hapa. U ndjeva çuditshëm. Sikur të komunikoja me njeriun që më tradhtoi. Brenda kishte kukulla, lojëra tavoline dhe dy albume, të mbushura me fotografi nga vitet e mia të fëmijërisë. Mora frymë thellë dhe fillova të shikoja njërin prej tyre.

“Gusht 1993” shkruante nën një prej fotografive të faqes së parë. Kisha veshur një fustan të bardhë

pambuku, isha e nxirë nga dielli dhe dukësja kaq, por kaq e brishtë. Faqet i kisha të përlyera me çokollatë. Dhe trupin e kisha të hollë. Sytë e mi të kaltër dukeshin edhe më të mëdhenj në fytyrën time të dobët dhe dukësja më e vogël sesa mosha që kisha. Buzëqesha. Siç buzëqeshja edhe atëherë para aparatit. Rënkova dhe udhëtova në vite përrallore.

Ishte hera e parë që vizitova fshatin e Orfeas. Një ishull mikroskopik, Shën Akilin, pranë Follorinës dhe Kosturit, në zemër të Prespës së Vogël, që mua të paktën nuk m'u duk aspak e vogël.

Nga njëra anë shikoja pyjet e paana të mbushura me lisa dhe cedra, dhe nga ana tjetër liqenin magjepsës, dhe më vinte të ulërija nga gëzimi. E adhurova menjëherë këtë ishull të vogël pas plogështisë së kryeqytetit. Ishte edhe hera e parë që rashë në kontakt me qetësinë, me mrekullitë e natyrës. Lamë në tokë makinën dhe hipëm në një varkë të drunjtë. Ujërat e liqenit ishin të qeta e të palëvizshme. Dhe aroma, aroma e lagështisë u bë njësh me gëzimin tim.

- Këto varka i quajnë mbiujëse. Janë të lyera me katran, - më shpjegoi babai.

Por unë mezi e dëgjoja. Në ato moment që bëhesha njësh me ëndrrën, njësh me qetësinë, luftoja të thithja gjithçka, duke përshkuar ujërat e bruzta.

Varkëtari e lidhi varkën në një mol të vogël, bashkë me disa të tjera. Ecëm në shtigje të vogla me baltë pranë brigjeve me llucë, për të mbërritur pranë motrës së nënës sime. Mes perdeve të trasha, që krijonin kallamat, pashë disa pata të egra shumë të bukura.

Tek ishulli i vogël, shtëpitë ishin të pakta, të paktë ishin edhe banorët. Mes tyre edhe teto Rinjoja. Një grua e kërrusur, gati si skelet, me një buzëqeshje të ndritshme dhe rroba të zeza. Ndenjëm një muaj pranë saj. Sa shumë më pëlqente të vrapoja te fusha e vogël ku mbillte fasule, por edhe të shkoja te kopshti bashkë me të që të mblidhnim domate. Dhe çfarë shijeje kishin ato domate! Haja, haja dhe nuk ngopesha. Nuk më pëlqente shumë ushqimi. Por çmendesha për specat e mbushur me oriz të tetos. Edhe për shalqinj. Ndërsa babi adhuronte rakinë dhe fasulet e Prespës, ashtu siç ia gatuante ajo. Fasule me lëng dhe fasule të mëdha në tavë.

- Je e dobët, je e dobët, ha! - më thoshte tetoja me zërin e saj karakteristik hundor dhe skuqte petulla të shijshme vetëm për hatrin tim.

I hanim tek oborri i vogël, të ulura në një tryezë prej hekuri me sipërfaqe të mermertë, poshtë disa qiparisave të egër e të mëdhenj.

E adhuroja të ecja së bashku me babanë në ligatinë, në kënetat e mbushura me kallama. Të shikoja si fluturonin zogj të rrallë mbi kokat tona, të shikoja lopë-xhuxhe të endeshin të lira dhe aq të lumtura në lëndinat e lagura. Të çirresha e gëzuar kur shikoja pelikanë të egër, çafka, karabullakë, rosa të egra që inatoseshin, por edhe pelikanë që kërcenin.

- Vërtet kërcëjnë? - e pyeta babin.

- Duken sikur kërcëjnë, po. Ndjekin rrymat e ngrohta të ajrit dhe bëjnë rrathë njëri pas tjetrit.

Shëtisin edhe në liqene të tjera, si në Kerkini. Dhe kur mërzhiten, kthehen sërish te ne, - më shpjegoi.

- Pse duhet të kthehemi në shtëpi edhe ne? Këtu dua të rrimë, babi. Këtu, këtu! - i kërkova.

Dhe ai më buzëqeshi.

- Ka të drejtë zogëza ime. Këtu të rrini, me mua, - ra dakord tetoja.

Dhe përpiquej të më magjepste akoma më shumë duke më folur për peshkatarët me varkat e zeza, me krapat e mëdhenj që kapnin në ujërat e Prespës së Vogël. Por edhe për princat, kukudhët dhe zanat e saj.

Nuk ishte nevoja të më bindte. E shikoja edhe vetë magjinë në dhjetëra zambakët e çelur të ujit, që ngjanin me piktura të mrekullueshme, në çafkat që më çmendnin me sqepin e tyre me majë dhe këmbët e gjata. Një ditë pashë edhe flamingo qafëgjatë në ngjyrë rozë. E humba. Ishin zogjtë më të bukur që kisha parë ndonjëherë. Nga të bërtiturat e mia ata u habitën dhe fluturuan në qiell, larg meje.

Isha e vogël, por e kisha kuptuar se jeta dukej përrallore në atë ishull të vogël, në atë parajsë ujore. E ndiente edhe dielli që aty ngrohte ndryshe, e këndonte zukatja e insekteve. E dija mirë kur netëve shtrihesha në shtratin e varur dhe shikoja qiellin, duke luftuar për të numëruar yjet që binin, që për pak sa nuk më ranë në grushtin tim, derisa më zinte gjumi. E ndieja edhe kur shikoja hënën e plotë që zhytej në ujërat e ëmbla dhe luante me to si fëmijë i vogël dhe i bënte të shkëlqenin.

Sa do të doja të rrija pranë teto Rinjosë. Në atë shtëpi të ujitur me shtyllat prej guri. Ta ndihmoja të thante peshqit, por edhe specat e kuq për të bërë piper të kuq, të kujdesesha së bashku me të për pulat dhe fasulet e saj.

Isha e vogël, sa një gogël. Si mund të mendoja që gjërat në jetë ndryshojnë nga një çast në tjetrin?

Ah, sikur të më kishte dëgjuar babai, sikur ta kishte realizuar ëndrrën time, nuk do të ishte ngatërruar. Nuk do të kishte vjedhur, nuk do të kishte vvarë.

Në bazilikën e Shën Akilit, që i kishte dhuruar emrin ishullit të vogël, shkoja bashkë me teton dhe qenin e saj, një pastor gjerman sterrë të zi që ishte engjëlli i saj mbrojtës. Tetoja fliste bukur, më magjepste me ato që thoshte.

- Sa do të doja të vije edhe ti në Athinë, teto. Të rrish me ne, - i thashë një ditë.

- Do të ishte bukur të rrija pranë teje, por nuk do të duroja shumë. Këtu, në këtë vend, mësojmë të jetojmë në harmoni në shoqëri me natyrën. Njerëz, kafshë, peshq, bimë, bëhemi një. Uji i liqenit pasqyron qetësinë tonë, lumturinë tonë. Ata që jetojnë nëpër qytete, Olimbia ime, heqin dorë nga të gjitha këto. Bëhen të dëshpëruar, agresivë, të trembur. Gjatë gjithë jetës së tyre kërkojnë të zbulojnë shkakun e dëshpërimit të tyre. Hahen me njëri-tjetrin, luftojnë për të mirat që janë të tepërta. Këtu është parajsë.

- Po, teto, - i thosha, edhe pse nuk i kuptoja të gjitha ato që më thoshte.

Sepse nuk doja të pushonte së foluri, edhe kur më tregonte legjendat dhe heronjtë e vendit të saj. Më tregonte për një car bullgar që thirri pranë vetes mjeshtër nga Larisa dhe ndërtoi jo vetëm kishën, por edhe pallatin e tij në Prespë. E dëgjoja e magjepsur. Pastaj kalonim jashtë kishëzave të vjetra dhe unë e lusja vazhdimisht të ngjiteshim në pikën më të lartë të ishullit, edhe pse e dija se s'do të ma plotësonte dëshirën, sepse nuk e mbanin këmbët. Sa shumë habitesha edhe me traditat që besonte. Si, për shembull, ajo që thoshte se njëmbëdhjetë shtëpitë e Shën Akilit nuk mund të bëheshin dymbëdhjetë. Se askush nuk guxonte të ndërtonte shtëpi të re, sepse nuk do të qëndronte kurrë në këmbë.

Sa nevojë kisha për përqafimet dhe miqësinë e një gruaje. Edhe për shoqërinë e saj. Më lejonte ta ndihmoja në gatim, gatuanim bashkë gjellën time të preferuar, krap në furrë, me shumë qepë, me specatë të kuq, domate të freskëta dhe dafinë. E linim shumë orë në furrë, sepse teto Rinjoja thoshte se peshqit e liqenit duhet të piqen mirë.

Udhëtimi në ndjenjat e mia më të thella bëri që të më mbusheshin sytë me lot, a thua se ndjeva atë shije të fortë pikante të peshkut që kisha kaq vite pa e provuar.

Thitha hundët dhe ndërrova faqe.

Vështrimi m'u ngul në një fotografi. Nëse lumturia do të kishte ngjyrë rozë, atëherë ai imazh i tregonte të gjitha. Isha në moshën gjashtëvjeçare. Babai më

kishte veshur me një fustan rozë, më kishte lidhur një kordele rozë në flokë dhe më çoi te studioja fotografike e lagjes. Atje fotografi ndezi një prozhektor të madh, e ktheu mbi mua, më dha shumë tullumbace rozë në formë zemre dhe m'u lut të luaja me to. Ende më kujtohen të qeshurat e mia, ende më kujtohet shkrepja e lumturisë sime rozë.

Pafajësi, shkujdesje, buzëqeshje zemre, besim te vetë jeta.

Gjithçka u bë hi. Vetëm nga një veprim i Orfeas.

E mbylla albumin, e vura te vendi i vet, mbylla valixhen, e ngjita sërish mbi dollap.

Edhe sa do të vazhdoja të ndieja dhimbje? Isha pesëmbëdhjetë vjeçe tanimë.

Hapa derën e dollapit tim. Pashë veten në pasqyrë. Isha zgjatur shumë, vazhdoja të isha elegante. Flokët e zinj të gjatë e të drejtë më arrinin deri në shpinë. Një ankesë më dridhej në sy. Mbylla derën me forcë dhe ia futa së qarës.

Dy javë më pas e hapa sërish valixhen. Kukullat dhe lodrat i fala te kopshti i fëmijëve të lagjes. Albumet i futa thellë në dollap. Doja t'i hidhja në plehra, doja të shpëtoja prej tyre.

Por nuk durova dot.

E nxora valixhen e Orfeas jashtë në trotuar. E mbështeta te koshi i mbeturinave. Por nuk ishte e shkruar të ndahesha prej saj. Po atë mbrëmje dikush i ra ngadalë derës së dhomës sime. Sapo isha shtrirë. Ndeza dritën e komodinës dhe hapa derën.

Ishte Theodhori. Në dorë mbante valixhen time. Ishte e hapur. Brenda kishte vënë një jastëk, sipër të cilit ishte shtrirë macja më e bukur që kisha parë në jetë. Borë e bardhë, me sy të kaltër, një pikturë e vërtetë.

Macja mjaulliu me zë të ulët. Dhe unë thirra nga gëzimi.

- Shët! Mos bërtit! Do të shqetësosh prindërit. Duket gati dymuajshe. Të pëlqen? Nuk rezistoj dot. I ka sytë si të tutë. E gjeta të braktisur këtu pranë, duke qarë. Gjeta dhe këtë valixhen jashtë shtëpisë dhe ja macja jote, së bashku me shtëpinë e vet, - më tha.

Hyri brenda në dhomë, e mbështeti valixhen e Orfeas në një qoshe.

Macen time e quajta Dashuri. Ishte e ëmbël dhe lozonjare, i donte shumë përkëdheljet dhe komunikonte përsosmërisht me mua. I flisja dhe murmuriste. E përkëdhelja dhe mblidhej kruspull në gjoksin tim, kur e lija pak pas dore lëvizte bishtin e egërsuar.

Shumë shpejt kuptova se ishte e shurdhër.

- Shkaku është gjenetik. Nëse një kafshë nuk ka ngjyrë në trup, nëse është e bardhë zakonisht i mungojnë gjenet që krijojnë qelizat e prodhimit të ngjyrës. Dëgjimi fitohet nga një shtresë qelizash të specializuara në pjesën e brendshme të veshit dhe qelizat e saj vijnë nga të njëjtat qeliza burimore me ato që prodhojnë ngjyrë. Macja jote është e bardhë dhe me sy të kaltër. Ka nevojë për mbrojtje dhe

për shmangien e ekspozimit në diell, - më shpjegoi veterineri që vizitova.

U betova ta mbroja Dashurinë gjatë gjithë jetës së saj. Nuk e lija të dilte vetëm në oborr dhe të lëndohej. Dhe kur dilnim shëtitje, e mbaja në krahë dhe luanim në mjedis të mbrojtur.

Zonja Vaso reagoi ashtu siç e prisja.

- Ta heqësh qafe shpejt këtë kafshë budallaqe, Olivia! - urdhëroi. - Nuk dua mace në shtëpinë time. Do të mbushemi me sëmundje.

Toni i zërit të saj ishte imponues. Iu afrova.

- Do ta bëj. Ju jap fjalën. Sapo të hiqni qafe edhe ju zotin Sava, - i thashë me sarkazëm.

- Si guxon? - tha me zë të çjerrë.

Por më la të qetë. Edhe mua, edhe macen time.

Filipo e adhuronte Dashurinë. Dhe ajo e ndjeu menjëherë. Çdo natë, kur shikonte televizor i ulur në divan, macja vraponte dhe mblidhej top në krahët e tij. Kërkonte me ngul përkëdheljet dhe duart e tij të forta.

Kafsha ime e parë u bë shkas që të afrohesha më shumë me një shok klase, Harin. Ishte i gjatë, ezmer dhe tmerrësisht i turpshëm, i mbyllur vazhdimisht në vetvete. E dija se familja e tij i adhuronte kafshët dhe në shtëpinë e tij kishte një tufë me qen e mace. Iu afrova në një pushim mes orëve dhe fillova ta pyesja që si të kujdesesha më mirë për Dashurinë.

Sytë e tij të ëmbël, ngjyrë mjalti më panë me ëmbëlsi. Filloi të më mësonte gjithë ato gjëra dhe shumë shpejt na u bë zakon t'i kalonim bashkë pushimet mes orëve.

Nuk vonoi shumë për të më dhënë letrën e parë të dashurisë.

- Të lutem, merre! Nuk kam mënyrë tjetër për të të shprehur ndjenjat e mia, - më tha një ditë dhe ia futi vrapit larg meje i skuqur i tëri.

Hapa e habitur letrën që më dha. Brenda shkruante “Të dua”.

Tani ishte radha ime të skuqesha.

Shumë shpejt edhe fletorja ime provizore filloi të mbushej me zemra. Nuk e dija nëse e doja edhe unë, por më pëlqente mënyra si më shikonte, vjershat e improvizuara që shkruante për mua, fjalët e ëmbla mjaltë që më thoshte. Hari ishte çamarrokësia ime e parë dashurore. Më bënte të ndihesha e veçantë.

- Edhe babai im e njohu nënën time në shkollë. U martuan. Dhe kanë tre fëmijë, - më thoshte me krenari në një pushim.

- Dhe shumë kafshë, - ia ktheva unë.

Nuk dija ç’të thosha tjetër.

Një vit të tërë më shkruante vazhdimisht. Kisha mbledhur gjithë ato letra. Flisnim me orë të tëra çdo natë në celular. Gjithë bakshishin tim e shpenzoja nëpër karta. Pastaj, pak para se të flija, pyesja veten si do të ishim bashkë si çift. A do të më pëlqente që të më prekte? A isha e dashuruar me të? A është kështu dashuria? E mbushur me ankth dhe pikëpyetje?

- Do të lidhemi bashkë? - më pyeti një natë me zë të ngjirur në telefon.

- Të lidhemi?

- Po, të jesh e dashura ime, - m'u përgjigj.

Nuk fola.

- Ta dish se unë do të të dua përgjithmonë, Olivia,
- vazhdoi.

Në atë moment Dashuria ra pëlltum poshtë krevatit tim.

- Më fal, duhet të të lë. Ishte macja ime. Ka nevojë për mua, - murmurita shpejt e shpejt dhe e ndërpreva telefonatën.

- Më shpëtove, - i thashë Dashurisë.

U përkula dhe e mora në krahë.

Hari nuk më foli më për dashurinë që ndiente për mua, ndoshta, sepse nuk i jepja kurajë. Por vazhdonim të ishim në shoqëri të ngushtë edhe në vitet e fundit të shkollës së mesme. Rrinim nëpër lokale, luanim bouling ose bilardo, shkonim bashkë nëpër festat që na ftonin. Më pëlqente shoqëria e tij, por e kisha të vështirë t'i përpunoja ndjenjat e mia, të sqaroja ato që ndieja për të.

A ishte vallë në vitet e adoleshencës dashuria ime e parë? Më prekte dhe më rrëmbente kujdesi i tij, sytë i shkëlqenin kur më shikonte. Kalonim bashkë sa më shumë kohë të mundeshim dhe lëndohej jashtëzakonisht shumë kur e lija pas dore. Më kujtonte macen time që donte kujdes të vazhdueshëm. Ah, sa do të doja të jetonte ime më, të kisha një marrëdhënie thelbësore me të, t'i hapja zemrën, të më dëgjonte, të më kuptonte, të më këshillonte.

- Edhe pse e mendoj se shumë shpejt do të ndjekim rrugë të ndryshme, më vjen të vras veten, - më rrëfeu një mbrëmje.

E dija se ëndërronte të bëhej mjek.

Ishte një pasdite pranverore. Po rrinim në një stol në sheshin “Varnava”, në cep të “Pagratit”, nën një rrap të madh. Më pëlqente ajo pjesë, më kujtonte paksa fshatin. E hodha vështrimin lart në qiellin e mbushur me ngjyra portokalli, të kuqe, blu dhe vjollcë.

Në buzët e mia u vizatua një buzëqeshje.

- Do të shihemi, mos u shqetëso! - e qetësova dhe e pashë.

Dhe atëherë u përkul dhe më puthi. Një puthje që kisha kohë që e prisja dhe më mbushi me ankth për reagimin tim. Një puthje që më ndihmoi të kuptoja menjëherë se nuk isha e dashuruar me atë djalë.

Kohët e fundit lexoja shumë Odhisea Elitin. Besoja, shpresoja, ëndërroja që me puthjen e parë të Harit të ndieja çdo fjalë të poetit që dashuroja:

Para syve të mi ishe dritë

Para Dashurisë dashuri

Dhe kur të mori puthja

Grua.

Dhe ashtu si me pikën e parë të shiut vritet vera, sipas fjalëve të Elitit, kështu u shkatërrua e gjithë magjia me puthjen tonë të parë. Nga ana ime të paktën.

- Të pëlqeu? - më pyeti pasi më puthi.

- Mmm... Kam uri. Si thua të hamë ndonjë suflaqe? - e pyeta edhe unë.

Kjo ishte. Nuk dolëm më bashkë. Në shkollë më shikonte me një shprehje fytyre prej të lënduari. Por nuk më shqetësoi më.

- Si e kupton nëse je i dashuruar? - pyeta një ditë Theodhorin.

I kishte harruar ëndrrat për t'u bërë psikolog, tashmë studionte në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në Politeknikumin Kombëtar të Mecovios. Dhe isha e sigurt se do të dinte të më fliste për këtë temë. Buzëqeshi çuditshëm.

- Pse nuk më përgjigjesh? Ende nuk je dashuruar?

- Eja me mua! - më nxiti dhe më drejtoi në kopsht.

E ndoqa. U përkul dhe këputi një trëndafil. Ma ofroi!

- Dashuria, Olivia, është... - ndaloi së foluri dhe më pa.

Sytë e tij në ngjyrë gështenjë të mjaltë rridhnin. Më mori në krahët e tij. E lashë veten të lirë. Më puthi.

Edhe pse nuk e prisja, edhe pse në atë moment e dija se po bënim diçka të ndaluar, të pakonceptueshme, zemra më rrahu forta, këmbët filluan të më dridheshin.

Ndieja sikur do të më binte të fikët, ndieja sikur nuk doja të merrte fund ajo puthje.

- Ta dish se sot që të putha linda. Ta dish se do të ndiej urrejtje sapo të të humbas, - pëshpëriti dhe më lëshoi nga krahët e tij.

- Theodhori... çfarë bëmë? Unë...

Sytë e tij ishin të përlotur.

- Të dashurova sapo të pashë. Isha ende i vogël. Jam lidhur me gjithë ato vajza, por asnjëra nuk ngjan me ty. Je idealja për mua, Olivia.

- Por jam motra jote! - bërtita.

- Je motra ime? Je? Nuk kemi të njëjtën nënë, nuk kemi të njëjtin baba, e marrtë djalli! Vetëm të njëjtin mbiemër, vetëm në letra jemi të afërm. Por mos ki frikë, e di se ne të dy kurrë nuk do...

Ndaloj së foluri. Më pa ankues. Nuk fola, nuk protestova, nuk thashë asnjë fjalë. Vetëm u zhyta në krahët e tij dhe fillova të qaja. Më shtrëngoi pas vetes. Një vetëtimë brenda meje.

Ndenja pak minuta pranë tij. Fillova të përkëdhelja balluket e tij bionde, me sy të mbushur me lot. Pastaj u ktheva në dhomën time me hapa të rëndë e të ngadaltë, së bashku me trëndafilin e dashurisë së tij.

Ajo puthje e Theodhorit më ndihmoi të kuptoja çfarë ishte dashuria. Në momentin që më puthi, u shndërrova. U shkruva. Mund të më bënte çfarë të donte. E doja. Më donte. Gjithçka që ndienim për njëri-tjetrin papritur doli në sipërfaqe. Shpërthim vullkanik ishte ajo puthje. Dhe ndjenjat tona të ndrydhura, llava e tij.

Të dy e dinim se duhej të mbaronte aty. Se ishte diçka e ndaluar. E detyrova veten të mos e mendonte më puthjen e tij. Të mos mendonte më asgjë për të. Edhe pse e dija se thellë-thellë kishte të drejtë, se nuk ishim vëlla e motër, në të vërtetë, por veçse në letra, rrëqethesha e tëra kur mendoja përzierjen e gjakut.

Vitet kalonin. Theodhori nuk më shqetësoi më. Vetëm se vazhdonte të më shikonte me dëshirim në sy.

Pak kohë më vonë, zonja Vaso futi aq gjëra sa nxinte një valixhe dhe u largua nga shtëpia. Përgjithmonë!

- Mamaja juaj më kërkoi divorcin. Do t'ia jap, - na informoi babai.

Vetëm kaq. Dhe pastaj uli kokën.

- Të shkojë në djall dhe të mos na shqetësojë më kurrë! - bërtiti Theodhori dhe përplasi fort dorën te tryeza e sallonit.

- Theodhori! - e ndëshkoi babai.

Iu afrova.

- Mos u mërzit, baba! Ndoshta është më mirë kështu, - e qetësova.

Nuk e gjykoja zonjën Vaso. Si përfundim kishte zgjedhur rrugën e duhur. Lidhja e saj ishte e dënuar, nuk kishte marrëdhënie të vërtetë mes tyre. Gënjeshtrat dhe, që duhej të bëheshin dhe nuk bëheshin, na lëndonin të gjithë në këtë familje. I kishte dhënë fund vetë lojërave të saj. Babai im ndihej i tradhtuar, tmerrësisht i lënduar. Kishte mbështetur gjithë jetën e vet tek ajo grua.

E kuptoja.

- Mos guxo të rrish pa ëndrra, baba, pa shpresë, pa pritshmëri, - vazhdova unë.

Buzëqeshi.

- Ti, vogëlushe, duhet të studiosh për psikologji.

- Do të bëhem police, si ti. Je shembulli im, - iu përgjigja.

Ishte hera e parë që shprehja ëndrrën time. Dhe atëherë bëri diçka të pabesueshme. Më ngriti në krahët e tij dhe filloi të më sillte vërdallë dhe vërdallë... Thirri pranë Theodhorin dhe na përqafoi të dy.

- Ju jeni gëzimi i jetës sime, - deklaroi më pas.
- Pra, police, he? Sa të lumtur më bëre, bija ime! Nuk do të arrij të dal në pension dhe ti do të më zësh vendin në Trupë.

- Si përfundim, Olivian e do më shumë se mua, a nuk është kështu? - e pyeti me shaka Theodhori dhe më shkeli syrin.

- Kjo krijesë, biri im, është e adhurueshme. Dhe sado që të më fshihesh, e di mirë se edhe ti e adhuron, - iu përgjigj babai.

Vështrimi që më hodhi Theodhori më copëtoi zemrën.

Nuk e pyeta kurrë babanë për zonzjën Vaso. Nuk më interesonte. Por u përpoqa të zija vendin e saj. Bëja pazaret, gatuaja, bëja punë në shtëpi. Me shkollën dhe kursin që ndiqja nuk ishte e lehtë. Por ia dola. Babai më shikonte me një krenari në vështrim dhe nuk ndalonte së më këshilluari.

- Duhet të kuptosh se nuk do të jetë aspak e lehtë të mbrosh jetën, të drejtat dhe pasurinë e qytetarëve, të përballësh me rreziqe të panumërta, - më tha një mbrëmje.

- E di, baba. Shpresoj t'ia dal mbanë! - iu përgjigja.

Më përqafoi.

Të njëjtën mbrëmje rashë në shtrat e lumtur. Kisha zbuluar qëllimin e jetës sime, po bëhesha gati të vija gjithë forcat që të realizoja ëndrrat e mia.

Atë natë u rikthye makthi im. Pashë Orfean. Ëndrra ime dukej si e vërtetë, si e gjallë. Kisha veshur një uniformë policore dhe po ndiqja një kriminel në një ngushticë. Me armën në dorë. Një moment më befasoi. M'u afrua nga pas pa e kuptuar. Ma mbylli gojën me njëren dorë dhe me tjetrën më shënjestroi në ballë me pistoletën e vet.

- Hidhe armën! - më urdhëroi.

Nisa të dridhesha e gjitha. Diku e kisha dëgjuar atë zë, diku... Bëra si më urdhëroi. Pastaj u ktheva ta shikoja. Ishte Orfea. Më hodhi një vështrim të egër, të çuditshëm, dhe pa hezituat shkeli këmbëzën... U zgjova duke ulëritur. U ula ndenjtur në shtrat. Zot i madh, isha tetëmbëdhjetë vjeçe dhe më përndiqte akoma.

Theodhori vranoi i pari pranë meje, u ul ngjitur dhe filloi të më përkëdhelte flokët.

- Ç'po ndodh? - më pyeti i tmerruar.

Shumë shpejt erdhi edhe babai dhe më pyeti:

- Zemra ime, çfarë ndodhi? Pe ndonjë makth?

Pohova duke tundur kokën.

- Orfean...

- Qetësohu, çdo gjë është mirë, - u përpoq të më qetësonte. - Do të të sjell diçka për të pirë? Ose më mirë ejani në kuzhinë! Do të bëj nga një çaj kamomili. Të gjithë e kemi të nevojshëm, - vazhdoi.

- Kur del nga burgu? - e pyeta në momentin që pija çajin e ngrohtë, i cili po më qetësonte.

- A nuk është dënuar me burgim të përjetshëm? - pyeti i çuditur Theodhori.

Babai uli filxhanin.

- Sipas së drejtës penale greke, burgimi i përjetshëm është dënimi më i madh që të jepet. Por koncepti është fiktiv. Dua të them se vërtet janë dënuar me burgim të përjetshëm, por mund të lirohen edhe pasi të kenë bërë të paktën 20 vite të dënimit të tyre, - më shpjegoi.

Nuk fola. Thjesht shikoja kamomilin tim me një vështrim bosh.

- Duhet të dish se... - vazhdoi.

- Nuk dua të di asgjë për të! - e ndërpreva duke thirrur.

- Megjithatë duhet, zemra ime. Edhe unë kam vite pa e parë. Tashmë e kam të vështirë, sepse dënimin po e kryen në burgun rural të Tirinthas, pranë Nafplios. Kështu do t'i ulet më shumë koha e burgosjes, - vazhdoi.

E humba.

- Dhe kur do ta lënë të lirë?

- Kur të ketë kryer trembëdhjetë vjet pothuaj.

- Vërtet? Domethënë... Domethënë, për pesë vite nga tani? - e pyeta e trembur dhe brofa në këmbë.

Por pse reagoja kështu? E kisha frikë Orfean?

- Olivia, çfarë po të ndodh? - më pyeti babai.

- Pse nuk deshi kurrë të më shikonte? Supozohet që më donte, se isha njeriu i vetëm në botë për të dhe...

U ula sërish në karrigen time.

- E thamë. A nuk e thamë kaq herë? Nuk do që ti ta shohësh në burg, nuk do të të tmerrojë.

- Nuk jam më fëmijë. Duhet, kam nevojë ta shoh, që të arrij ta kapërcej, baba. Të mos shikoj më makthe, ta detyroj të më shpjegojë të pashpjegueshmet. Kanë kaluar tetë vite tashmë dhe nuk do të më shikojë...

“Vajzën e tij”, desha të thosha, por ndalova së foluri. Sytë m’u mbushën me lot. Babai im më qëndronte pranë. U ngrita nga karrigia, iu afrova, e kapa nga supet dhe e përqafova.

- Më fal! - i pëshpërita.

- Ç’janë këto që thua, bija ime? - më pyeti.

Edhe sytë e tij ishin të përlotur. Nuk folëm më për këtë çështje. Me punët dhe studimet, koha kishte kaluar shpejt. Dhashë provimet për të hyrë në universitet dhe të gjitha provimet e nevojshme që duheshin për t’u bërë police.

Ia dola me sukses.

Babai fluturonte mbi re nga gëzimi. U ndjeva aq e lumtur që e bëra krenar.

Vallë do të gëzohej kaq shumë edhe Orfea?

Apo do të më urrente për zgjedhjen time?

3

Studimet e mia në Fakultetin e Oficerëve të Policisë zgjatën katër vjet.

Rrija në ndërtesat në Aharnes dhe si rreshtere në provë mbaja veshur një uniformë të veçantë me emblemën e shkollës, e cila ishte e barasvlershme me fakultetet e institucioneve universitare.

E adhurova jetën time të re, nuk më pengonte aspak disiplina e rreptë, në sytë e mi dukej si universitet dhe kamp ushtarak bashkë. Profesorët e mi ishin gjyqtarë e prokurorë, juristë, psikologë dhe intelektualë të tjerë të specializuar, por edhe oficerë të Policisë Greke. Mësimet bëheshin si në salla mësimore dhe informatike, ashtu edhe në mjedise të jashtme, në poligone, në fusha qitjeje, në palestra. Përdorja armë, lexoja libra mbi mjekësinë ligjore, mbi kriminalistikën dhe psikologjinë, të drejtën publike, penale dhe ndërkombëtare, menaxhimin, letërsinë greke dhe një sërë të tjerësh. Edukohesha në vetëruajtje, në vetëmbrojtje, në mësimin e drejtimit të motoçikletave shumëkubikëshe, në njohjen, hetimin dhe njësimin e të dyshuarve.

Mësohesha si të veproja brenda një kuadri tepër të ashpër, pa përjashtime, dhe kjo gjë më ofroi siguri. Në fakultet funksiononte edhe një rajon policor standard. Mësoja të respektoja ligjet, parimet e Kushtetutës, qytetarët, kolegët e mi, veten, por edhe se çfarë do të thotë punë zyre në një rajon policor. Mësohesha si të zgjidhja problemet e qytetarëve. Lista me ato që duhej të mësoja dukej e pafund, e njëjta gjë edhe me ushtrimin tim të përditshëm.

Në daljet e mia vrapoja pranë babait tim të më forconte moralin, të ndihesha e sigurt me njohjet dhe këshillat e tij të çmuara. Kishte punësuar një zonjë simpatike për punët e shtëpisë, e cila vinte dy herë në javë. Nuk ndalonte së theksuari sa mbresëlënëse ishin vitet që po studioja në fakultet, se sa do të më merrte malli më vonë për to. Nuk ndalonte, natyrisht, edhe së më këshilluari.

- Kur të jesh jashtë në rrugë, duhet të dish se çdo patrullë “merret në pyetje” jo formalisht nga kriminelët në fuqi që të ndjekin. Duhet të kujdesesh për frymëmarrjen tënde, për tonalitetin e zërit, për qëndrimin e trupit dhe...

- Mirë, në rregull, baba. Tashmë i kam mësuar përmendsh këto. Po studioj edhe unë psikologji, - i ankohesha.

E pyesja shpesh për zonjën Vaso, por ai ndërronte temë. Ende i dhembte tradhtia e saj. Nga Theodhori mësova se kishin nisur procedurat e divorcit.

- A është mirë? E lumtur? - e pyeta një ditë.

- Sa herë që e vizitohet në Pire, në shtëpinë e saj të re, kthehem në shtëpi të sëmure.

- Kaq mirë, hë?

- Vazhdon gjatë të pamëshirshme të vetëkënaqësisë. Është njeriu më egoist që kam njohur. Një jetë të tërë shikonte vetëm interesin e saj dhe nuk interesohet për të tjerët. Tani do të ndryshojë? - m'u përgjigj, dhe menjëherë ndjeva se nuk e kishte falur, vazhdonte të ishte i inatosur me të.

- Por je njëzet e një vjeç. Kur do ta vendosësh më në fund? Harroje! - e nxita.

Më pa.

- Ti e harrove babanë që të lindi? - më pyeti.

Nuk fola. E dija sa të drejtë kishte.

Katër vite më vonë, bëra betimin dhe mora shpatën nga presidenti i Republikës në ceremoninë zyrtare të betimit. Ishin edhe Theodhori dhe babai im në ceremoni. Fluturonin të dy mbi re nga gëzimi dhe nga krenaria që ndienin për mua. Po aq krenare ndihesha dhe unë. Kisha fituar me meritën time gradën fillestare të oficerëve në hierarkinë e Trupës. Isha nënoficere e dytë. Ndërkohë, mendoja të vazhdoja edhe më edukimin tim, të ndiqja Sektorin e Trajnimit të Oficerëve.

Ishte vera e vitit 2010 kur njoha Andonin, burrin që tronditi nga themelet ekzistencën time, që u turr si uragan në jetën time.

Një mëngjes vizitova fakultetin për disa dokumente që më nevojiteshin. Në momentin që po dilja jashtë,

sytë më shkuan te një burrë. Ishte e çuditshme, por ndalova. Të njëjtën gjë bëri edhe ai. Pastaj m'u afrua.

- Mirëmëngjesi! Je në provë? - më pyeti dhe më buzëqeshi.

Po e studioja. Ishte i gjatë, me trup të palestruar dhe me një vështrim intensiv depërtues. Sytë e tij kishin një ngjyrë gri të qartë, flokët e zinj i shkëlqenin. Kishte veshur rroba sportive. Ajo që më tërhoqi tek ai ishte pamja, por edhe qetësia që rrezatonte.

- Mbarova shkollën. Nënoficere e dytë, - i thashë më krenari.

Dhe pastaj u pendova. Për ç'arsye duhet të kapardisesha para një të panjohuri?

- Më quajnë Andon, - më tha. - Po ty?

- Nuk jam e detyruar të të them emrin.

Buzëqeshi sërish.

- Nuk do të takohemi më?

- Paske oreks për ngacmim që pa gdhirë? - e pyeta.

- Bëjmë të njëjtën punë. Si thua të shkëmbejmë mendime?

- Edhe ti je nënoficer?

- Rojë speciale. Në shërbimin policor mbi dy rrota, të skuadrës DIAS. Me pak fjalë, kalorës i asfaltit.

- Mirë. Paske ide të madhe për veten.

Ia dha një të qeshure në një mënyrë të veçantë. Më rrëmbeu. Nisa të qeshja edhe unë. E qeshura ime i dha kurajë.

- Atëherë, shkojmë? - pyeti dhe më kapi nga dora.

- Je i çmendur? Ku do të shkojmë? A nuk ke ardhur këtu për punë?

- Puna mund të presë, ndërsa ti jo.

Nuk e di pse e lashë të më rrëmbente. Kaq vite në fakultet kisha njohur shumë shokë klase që më afroreshin me qëllime të ndryshme. Sado të më ngacmonin, nuk përkulesha. Edhe pse doja shumë të ndieja ç' do të thoshte dashuri, ç' do të thoshte seks. Në moshën njëzetedyvjeçare isha ende e virgjër. Nuk e kisha problem që s' e kisha nisur ende jetën seksuale; isha përjashtimi i rregullit mes bashkëmoshatareve të mia. Doja të lidhesha për herë të parë me ndjenjën, doja të prisja. Dhe ai burrë kishte diçka të veçantë. Diçka që më joshte. E shikoja dhe nuk mundesha të arsyetoja.

- T' i kesh gjithmonë hapur sytë e zemrës, - më këshillonte shpesh babai im, Filipino.

Për këtë e kishte fjalën?

Hipa e magjepsur te motori i tij. Më dha të vija kaskën e vet. Shumë shpejt ecnim në bulevardin "Thrakomaqedhones", nuk vonuam shumë të dilnim te rruga kombëtare. Pa më pyetur as për gjënë më të vogël, më çoi në një vilë të vjetër, me një oborr të madh piktoresk, të shtruar me pllaka, që ishte shndërruar në kafeteri. Ishte e fshehur në një ngushticë të Kifisias, një vend i qetë dhe romantik. Pemët dhe lulet përreth më bënë të ndihesha sikur u gjenda papritur në një fshat.

- Të pëlqen? - më pyeti kur u ulëm përballë njëri-tjetrit në ca kolltukë të rehatshëm në oborr.

Tunda kokën.

- Këtu ka ëmbëlsira fantastike. Të bëra vetë. Dhe limonadë të bërë vetë, kek, sallatë me fruta me kos, por edhe...

- S'më besohet kjo që bëra. Nuk të njoh, e megjithatë të ndoqa, - e ndërpreva dhe u ula më rehatshëm.

Muzika e ulët, që dëgjohej, po më relaksonte.

- Jam fati yt.

Zëri i tij më ngrohte, më rrëmbente. Ishte i thellë, mashkullor dhe në të njëjtën kohë i mëndafshhtë.

- Po tallesh me mua?

- Aspak. Por do të na ndihmojë më shumë nëse njihemi më mirë. Më quajnë Andoni, siç të thashë, Andoni Eksarhopulo. Jam njëzet e gjashtë vjeç, kam lindur në Amorgo, por tani jetoj në Athinë, në një apartament të vogël në Likavito. Prindërit e mi vazhdojnë të jetojnë në ishull dhe... Ah, po! Jam djalë i vetëm dhe në këtë periudhë nuk kam lidhje.

Ia plasa së qeshurës.

- Pse qesh?

- Je i paparë! Habitem që nuk më tregove edhe kartën e identitetit.

- Më e lehta, - tha, dhe filloi të kërkonte xhepat.

- E thashë me shaka.

- Atëherë, - vazhdoi, - ushtrohem në mënyrë sistematike, jam zhytës fanatik, i pasionuar me detin, si dhe me motorin tim. Do të vijë një moment që do t'i gjej paratë për të blerë një motor që ëndërroj. Mmm... Çfarë tjetër? Në ushtri kam qenë parashutist.

- Domethënë, i fortë dhe i disiplinuar, kështu?

- Kështu. E njëjta gjë edhe në zhytje. Jam shumë i kujdesshëm dhe skolastik me rregullat e sigurisë.

Ndaloj së foluri për pak.

- Besoj se dashuria është fuqia lëvizëse në jetë, - shtoi pas pak.

- Përveç jetës sate, je i vendosur të më shpjegosh edhe besimet e tua? - e pyeta dhe ia dhashë përsëri së qeshurës.

- Ke të drejtë. Tani është radha jote të më thuash emrin tënd, - më tha dhe ia bëri me shenjë kamerierit.

Porositëm kafënë dhe deri në çastin që na e shërbyen nuk folëm. Thjesht shikoheshim. Nuk e ula shikimin, sado që doja ta bëja. Përpiquesha të lexoja sytë e tij.

- Mmm... Tipare elegante, sy magjepsës, lëkurë e bardhë si dëbora, trup i dobët gjithë nerv. Dukesh e egër dhe e ëmbël njëkohësisht, - komentoi një moment.

- Më ngacmon, kështu? Pa pushim.

Nuk foli. Vazhdoi të më shikonte.

- Atëherë? Nuk do të ma thuash emrin tënd si përfundim? - më nxiti dhe piu një gllënjë nga kafeja e tij.

- Më quajnë Olivia Vagjena.

- Olivia? Emër magjepsës.

- Faleminderit!

- Dhe?

- Dhe çfarë? Do të të analizoj jetën time, ashtu si bërë ti? Nuk do ta bëj. Mua, more djalë, do të më njohësh pak nga pak, - i thashë.

Kafshova menjëherë gjuhën, sepse e humba me fjalët që guxova të nxirrja nga goja.

- Pajtohemi plotësisht. Pikërisht këtë dua dhe unë, - u përgjigj dhe e la kurrizin të mbështetej në kolltuk me një buzëqeshje kënaqësie në buzë.

- Sa kohë ke që punon në skuadrën DIAS? - e pyeta për të ndërruar temë.

- Vetëm pak muaj. Skuadra jonë u krijua marsin e vitit të kaluar.

- Të pëlqen puna jote?

- Është e vështirë dhe e rrezikshme. Por e adhuroj.

- Dhe... reagimet e njerëzve?

- Tani po më merr në pyetje? - kërkoi të mësonte.

Luftova të inatosesha me të, por nuk ia dola dot.

- Po përgatitem të shërbej në një rajon policor. Kështu që, po, mësoj nga ti që je më i vjetër dhe ushtrohem me marrjen në pyetje, - iu ktheva.

- E dija që me punën që zgjedha do më thërrasin “polic”, “derr”, “vrasës”. Lëndohem me fjalët e tyre, është diçka që herët a vonë do ta vuash edhe ti. Na përçmojnë ata për të cilët vëmë veten në rrezik. Por mos mendo se mendojnë të gjithë kështu. Ka njerëz që dalin në ballkone për të na parë, bëjnë kryqin për ne dhe luten të jemi të fortë.

- Domethënë, nuk ka diçka që ta vështirëson punën?

- Ka, Olivia. Asnjë punë nuk është si në parajsë. Ajo që ma vështirësoi më shumë nga të gjitha ishte se kurrë nuk e dija nëse do të kthehesha në shtëpi në fund të turnit. Por si përfundim u mësova dhe e dashurova shumë atë që bëj. Jam krenar që mbaj distinktiv.

- Gëzohem shumë për këtë. Njësoj ndihem edhe unë, - i thashë.

- Babai im nuk u entuziazua me vendimin tim për t'u bërë oficer policie. U përpoq të më bindte që ta mendoja më mirë. E di çfarë më këshilloi kur u bind? Të shkoja te skuadra MAT, tek EKAM4, në ndonjë makinë patrullimi, kudo tjetër. Por jo te skuadra DIAS. "Do të jesh i ekspozuar kudo, bir", më tha. "I druhem shkallës së madhe të rrezikshmërisë."

I buzëqesha. E vlerësoja shumë sinqeritetin e tij.

Koha ikte revan. Folëm me orë të tëra dhe as që e kisha kuptuar. Çdo minutë që kalonte më dukej gjithmonë e më tërheqës. Ndihesha kaq rehat me të, sa që dalëngadalë fillova t'i hapësja pak nga pak.

Kur më propozoi të takoheshim prapë, pranova. Si mund t'i kundërshtoja?

Dhe jeta ime ndryshoi nga njëra ditë në tjetrën. Fillova shërbimin në Komisarriatin Policor të Pefkit, i ndërmora detyrat e mia me entuziazëm të pamasë. Doja shumë të bëhesha një police e mirë.

Nuk isha më në shkollë, nuk ndihesha e mbrojtur. Isha gati të veproja bashkë me rreziqet, por edhe pushtetin e titullit tim. Nuk ishte punë kjo imja. Ishte funksionim. E dija, ashtu si Andoni, se nga njëri çast në tjetrin mund të përballesha me vdekjen. Më trembte ideja, por isha e sigurt se shumë shpejt do ta përballoja, do të mësohesha. Mes detyrave të mia ishte parandalimi i krimit, hetimi, zbulimi, ndjekja, arrestimi, marrja paraprake në pyetje e fajtorit apo

të dyshuarve, kontrolli i dispozitave tregtare, ruajtja e rendit nëpër grumbullime. Shpeshherë ndihmoja në lëshimin e dokumenteve të ndryshme publike, si karta identiteti dhe certifikata të çdo lloji. Punoja në komisarjat dhe në lëvizjet e mia përdorja makinë shërbimi. Mbaja veshur uniformën time, mbaja armë dhe pranga.

Takohesha me Andonin sa herë që ishte e mundur. Nuk kishte orar të qëndrueshëm. Herë zgjohej që pa gdhirë, që të fillonte punën dhe herë të tjera turnet e tij ishin në dreckë ose në darkë. Ishte vazhdimisht në lëvizje, gati për t'u turrur për shkeljen më të vogël. Por nuk ankohej, punën e vet e bënte me merak.

- Ku do të shkojë? Dalëngadalë do ta fitojmë dashurinë dhe besimin e qytetarit, - më thoshte.

E dija mirë se skuadra DIAS ishte ajo që thërrisnin të parën në aksidente automobilistike, në grabitje, përdhunime, përleshje. Andoni ishte në vijën e parë, bënte patrullime të shpeshta, vraponte në rrugica të errëta apo në rrugë qendrore për të shpëtuar këdo që rrezikonte, duke mbajtur bashkë me veshjen e rëndë edhe kolegun e vet. Atë që besonte, atë për të cilin ishte i sigurt se mund të hante plumb për të.

- Nuk u lodhe duke vrapuar? Pse nuk parapëlqen një punë zyre? - e pyeta.

- Më eksiton shërbimi luftarak. Zyra më mbyt, - m'u përgjigj.

Përpiqesha ta harroja sa shumë rrezikonte, të gëzoja shoqërinë e tij. Shkonim nëpër bare, restorante,

kinema. Flisnim, qeshnim shumë, gëzoheshim shumë me shoqërinë e njëri-tjetrit. Kishte një tërheqje të padukshme mes nesh, një tërheqje të shpirtit dhe trupit tonë. Ishte më se e dukshme se nuk mund të rezistonim. Na rrëmbente, na shtynte të zbulonim njëri-tjetrin, por edhe vetveten. Mos vallë më kishte trokitur në derë dashuria? Kështu? Pa paralajmëruar? Ndihesha sikur kisha kohë që e njihja Andonin, gjithë ndjenjat e mia festonin kur ishte pranë meje. Sa herë që më prekte rastësisht, elektrizohesha e gjitha. E adhuroja aromën, zërin, vështrimin e tij. Sytë e tij rrëfenin qartë se ishte i dashuruar me mua. Shikoheshim dhe dukej sikur flisnim pa fjalë.

Një natë më ftoi në shtëpinë e tij. Nuk hezitova të pranoja.

Apartamenti që kishte marrë me qira në Likavito ishte një ndërtim modern, gjendej në katin e parë dhe kishte pamje nga mali. E adhurova menjëherë. Kishte një sallon të gjerë me oxhak, kuzhinë, banjë dhe një dhomë gjumi. E kishte mobiluar thjesht, dukej si kukull. Qirinj të ndezur dridheshin mbi tavolinën e sallonit, qirinj me aromë vaniljeje. Pranë tyre, një vazo e vogël me ca lule të bukura delikate e të çuditshme në ngjyra rozë, vjollcë, të verdhë dhe të bardhë. Më kujtuan trëndafilat, më magjepsën. Iu afrova pranë, i preka lehtë petalet e tyre.

- Hera e parë që shoh lule të tilla, - vura në dukje.

- Të pëlqejnë? Sa gëzohem! E durojnë nxehtësinë e verës. Quhen lizianë dhe më kujtojnë ty. Janë fisnike,

të veçanta, të ndjeshme dhe të forta njëkohësisht, janë edhe...

Nuk e lashë t'i mbaronte fjalët. Nuk durova dot më. Iu afrova dhe e putha.

Si është e mundur të jetë kaq e shijshme një puthje? Si është e mundur të ndalojë koha? Ishte shkalla e parë e bashkimit tonë. Më rilindi, më magjepsi, më shpengoi.

Ndalova së puthuri dhe e pashë. Sytë e tij ndriçuan. Nuk tha asgjë, vetëm më ngriti në krahë dhe më çoi në dhomën e tij. Filloi të më zhvishte herë shpejt e herë ngadalë. Ndieja flakë në të gjithë trupin.

- Jam i dashuruar me ty, engjëlli im, - më tha. - Çmendurisht, shumë i dashuruar.

- Është... është hera ime e parë që... - pëshpërita e dorëzuar në krahët e tij.

- E di, e ndjeva, - pëshpëriti, kafshoi llapën e veshit tim dhe pastaj më dhuroi puthje të shpejta në qafë.

Fillova të dridhesha nga padurimi, nga puthjet e tij që u bënë më kërkuese, më të nxehta, pasi gjuha, buzët, duart e tij përkëdhelnin gjithë trupin tim. Kur trupat tanë u bënë një, nxora një ulërimë të vogël dhe u shtrëngova pas tij.

Në mënyrë të pandërgjegjshme nisën të më rridhnin lot nga sytë. Lot gëzimi. Këtë prisja kaq vite, këtë zhytje në përmbushje, në vërshimin e eksitimit dhe pasionit.

Nuk u ulëm në tryezë atë natë, nuk e shijova gatimin që kishte bërë Andoni për mua. Nuk duronim

të ngriheshim nga krevati. Trupat tanë rezistonin, ishin të fortë, duronin. Sepse hera e parë për mua u bë e dytë. Që u gdhend në mendjen dhe trupin tim. Ishte e ëmbël dhe e egër bashkë, sensuale, e ëmbël si mjalti. Trupat tanë u bashkuan prapë, u bashkuan edhe frymëmarrjet tona. Nuk ngopeshim me njëri-tjetrin.

Fjeta pak, shumë pak, e luajtur mendsh në përfaqimin e tij. Një moment hapa sytë dhe e pashë. Dhe ishte buzëqeshje lumturie ajo që u drodh në buzët e mia.

Më puthi lehtë në flokët e mi të gjatë e të ngatërruar, i preku me majat e gishtave.

- I adhuroj këta flokë... Ah, Olivia, që herën e parë që të pashë, e kuptova se je gruaja e jetës sime, - më pëshpëriti.

Filluam të flisnim. Ndërsa gdhihej dhe drita rrëshqiste mes grilave, u bashkuam për herë të tretë me rënkimet tona.

Që atëherë nuk u ndamë më. Dukej i mirë, i zgjuar, aktiv, romantik dhe ishte nga meshkujt më të bukur që kisha njohur. S'më besohej që e kisha takuar, sepse interesohej për mua. Mendoja se meshkuj si ai ekzistojnë vetëm nëpër romane.

Disi kështu duhet të jetë dashuria.

Çdo ditë interesohesha më shumë për të, çdo ditë e dashuroja gjithnjë e më shumë. Tashmë isha e sigurt. Ishte një ndjenjë që e kisha të pamundur ta përshkruaja me fjalë. E çuditshme, e pakontrollueshme, unike.

Nuk mund ta imagjinoja jetën time larg tij, ndihesha e droguar. Buzëqeshja vazhdimisht si budallaqe, gjithçka rreth meje fitoi ngjyrë dhe aromë. E ngrija muzikën deri në kupë të qiellit dhe këndoja. Këndoja fort. Besoja se gjithë këngët e botës, greke apo të huaja, ishin shkruar për mua. Edhe detajet e përditshme më të vogla më dukeshin të përkryera, të veçanta, shumë të dashura. E kisha humbur me reagimet e mia, por nuk më interesonte. E shikojta dhe gjithë ndjenjat e mia nisnin të vallëzonin si të çmendura, të ngjyeshin me të kuqe.

E kuqja e thellë është ngjyra e dashurisë.

Isha e dashuruar! Dhe doja ta thosha me zë të lartë, ta dëgjonte e gjithë bota. Doja të filloja të kërcëja nga gëzimi dhe të mos ndaloja kurrë.

Një natë, kur ishim sërish bashkë të përqafuar, në krevatin e tij i ngula sytë.

- Ka ndodhur gjë, engjëlli im? - më pyeti.

- Po, ka ndodhur. Jam e dashuruar me ty, Andoni. E dashuruar marrëzisht, - bërtita.

Sytë e tij gri u mbushën me lot.

- Jam njeriu më i lumtur në botë, - më tha dhe ma mbylli gojën me një puthje.

Fillova të prisja me padurim të isha me të vazhdimisht, por ai vazhdonte të punonte me orë të tëra, me shërbime njëra pas tjetrës. Disa ditë rastiste të punonte tetëmbëdhjetë orë pa pushim. Asnjëherë nuk u ankua. Doja ose jo, kuptova se e adhuronte atë që bënte, edhe pse nuk e dinte kurrë ç'mund t'i ndodhte

në misionin e radhës. Çdo ditë e priste një rast tjetër, që nuk ngjante me të mëparshmin, pasi nxitonte me shpejtësi të lartë mbi dy rrota për të ndërhyrë. Edhe puna ime ishte e paparashikueshme. Por ndieja se ai rrezikonte më shumë. Kur gjendesha në rrugë, kisha sigurinë e makinës, ndërsa ai i binte Athinës kryq e tërthor në mes të shiut dhe të të ftohtit me një motor që kishte bërë mbi dyqind mijë kilometra.

Gjatë orëve të lira vizitoja një shkollë boksi. Ëndrrat e mia për t'u bërë balerinë i kisha lënë pas me kohë. Mbaja doreza, godisja thesin e zi dhe ndihesha e lirë, e çliruar nga ankthi, nga frika për jetën e Andonit.

Nuk shqetësohesha pa arsye. Dy herë e çuan në Spitalin Ushtarak 401. Njëherë me plagë të lehta, herën tjetër me plagë më të rënda. Një grup njerëzish, pothuaj më shumë se tridhjetë, i kishin zënë pritë Andonit dhe kolegut të tij në një rrugë të kryeqytetit dhe i kishin sulmuar me gurë dhe drurë. Si është e mundur t'ia dilnin mbanë me ta?

Vrapova si e çmendur te spitali ku e shtruan. Zemra ishte gati të më bëhej copash derisa ta shikoja, derisa të kuptoja se ishte gjallë. Ndenji një javë aty dhe një muaj e gjysmë jashtë shërbimit, derisa t'i mbylleshin plagët në kokë dhe të shërohej nga thyerja e brinjëve.

Zot i madh, çfarë faji u kishte skuadra DIAS? Pse e shfrynë urrejtjen mbi ta?

- A nuk ndihesh si thes boksi? Të gjithë besojnë se ne policët e kemi fajin për gjithçka, - u ankova.

- Një rast i keq ishte. Vazhdoj normalisht punën time. Nuk janë të mbushur me urrejtje të gjithë ata që kanë nevojë për ne. Në sytë e tyre, engjëlli im, shikoj njerëzit e mi që kanë nevojë për ndihmë. Ty, prindërit e mi...

- Njerëzit e tu s' do të të prisnin me drurë dhe gurë, - e ndërpreva.

Filloi të më përkëdhelte flokët, siç e kishte për zakon të bënte.

- Nuk duhet të shqetësohesh kaq shumë për mua.

Rënkoi. Ndaloj së foluri. Kishte dhimbje të forta kur merrte frymë thellë.

- Mos e hap më gojën, të lutem! Përndryshe as nuk e di ç' do të të bëj, - e paralajmërova.

Buzëqeshi me dhimbje dhe m'u bind. Mbylli sytë dhe e la veten të lirë në përkëdheljet e mia.

Kur doli nga spitali, ndenja pranë tij, në shtëpinë e tij. Kishte nevojë për ndihmë. Njoftova babanë tim. I kisha folur për Andonin dhe ishte në dijeni të marrëdhënies sonë.

Një muaj përkëdhelja mavijoset në trupin e tij, duke pritur të mbylleshin vetë brinjët e thyera pa pajisje mbështetëse apo fasha. Ditët e para, që t'ia lehtësoja dhimbjen dhe ënjtjen, mbështillja një pako akulli me peshqir dhe ia vija te zona e lënduar, siç më këshilluan mjekët. Kafshonte buzët që të duronte, por e lehtësonte. E kishte të vështirë të ndërronte anë në krevat, vazhdonte të ndiente dhimbje në gjoks. Javën e parë e ndihmoja të flinte sa më drejt të mundej.

I gatuaja ushqime që i pëlqenin dhe e ushqeja me zor me ushqime të mbushura me kalcium.

- Jam me fat që u plagosa. Si do të të kisha ndryshe pranë vetes ditë e natë? Ku do ta gjeja këtë përkujdesje? - më tha një ditë.

- Më vjen keq për gjendjen tënde, pa do të ta hidhja këtë në kokë, - iu përgjigja.

- A nuk kam të drejtë që të quaj “engjëlli im”? - pyeti me mërmërimë dhe më detyroi ta puthja.

- Po kur të bëhem mirë? Do të më lësh në mëshirë të Zotit? Mendon se pas përkujdesjeve të tua, me të cilat u mësova tanimë, mund të jetoj vetëm? Pa ty? - më pyeti pak ditë para se të kthehej në shërbim.

Tashmë ishte bërë mirë dhe kishte pak dhimbje.

- Nuk e kuptova. Po më kërkon të bashkëjetojmë?

- Kaq e dukshme është?

Nuk hezitova, pranova menjëherë. Një natë shkuam në shtëpinë time. Kishte ardhur koha të njihte të mitë.

- Je e lumtur pranë tij, shkëlqen, bija ime, - komentoi i kënaqur babai im, një moment që ngelëm vetëm. - Duket në sytë e tu, në lëvizje, në vetë fjalët e tua. Dhe që ta zgjidhje ti Andonin, jam i sigurt se është djalë i shkëlqyer, - vazhdoi.

Kur i thashë se do të bashkëjetojmë, nuk kundërshtoi aspak.

- Me kusht që të më lësh Dashurinë, - u përgjigj. -Tani që do të ikësh ti, kë do të përkëdhel unë?

Rashë në krahët e tij dhe sigurisht që nuk hezitova asnjë çast t’ia plotësoja dëshirën. Macja ime e adhuronte.

- Sa zili e kam! Nuk ka asnjë pengesë mes jush. Është kaq fatlum, motër, - më pëshpëriti në vesh Theodhori, ndërsa e përshëndesnim. - Por nëse guxon të të lëndojë, do të ketë të bëjë me mua.

A kishte mundësi të vazhdonte të ishte i dashuruar me mua? Nuk fola. Sepse nuk dija çfarë të thosha. I buzëqesha dhe e puttha me ëmbëlsi në faqe.

Bashkëjetesa me burrin që dashuroja më ndihmoi të lulëzoja. Ndihesha kaq e lumtur. Netëve vonë, sapo kthehej pranë meje nga turni dhe unë flija, më mbulonte kur më gjente zbuluar, më puthte ëmbëlsisht në ballë dhe fshihte në ngrirje akulloren me vanilje, të blerë enkas për mua, akulloren që e dinte se e adhuroja. Gjatë orëve që rrinim bashkë nuk më largonte asnjë çast nga krahët e tij.

Pranë tij harrova ç' do të thoshte arsye, ndoqa rrugën e zemrës, e lashë veten të lirë. Lija minutat, orët të më rrëmbenin në festën e dashurisë. E prisja të kthehej, e mirëprisja me një puthje, me një mall të pamasë në sy. Shkonim shumë. Çmendeshim të dy të shikonim shiun duke ngjitur fytyrën në xham, të endeshim në tregje të shtunave dhe të mbushnim vazo me lule, të pinim uzo në ballkon të dielave në drekë, të piqnim biskotat tona të preferuara, vetëm e vetëm që apartamenti të mbante erë të mirë, t'i binim kryq e tërthor "Monastirakit" në kërkim të librave të vjetër, të vinim muzikë dhe të kërcenim të përqaftuar fort me orë të tëra.

Çastet tona të përditshme dukeshin si diell. Dhe ai dimër që jetova pranë tij ishte një verë e pafund.

Sepse kisha atë.

Një mbrëmje dimërore isha shtrirë e mbështjellë me një batanije në divan dhe po e prisja.

Hyri në shtëpi duke mbajtur një kuti prej letre. E mbështeti në gjunjët e mi dhe nuk arrita të habitesha kur dëgjova një lehje të dobët ankuese. Pashë brenda në kuti, nxora një ulërimë dhe mora në krahë qenin më të ëmbël, më të lezetshëm që kisha parë ndonjëherë. Ishte kaq i vogël, i bardhë borë, me sy ngjyrë gështenjë e tepër të ëmbël.

- Është shumë i bukur. Ku e gjete? - e pyeta Andonin.

- Dikush kishte mbyllur në një qese pesë këlyshë të sapolindur dhe për t'i hequr qafe i hodhi në një rrymë uji të Kifisias, nën një urë të vogël. Donte t'i mbyste. E lidhi fort qesen me spango që të mos arrinin të shpëtonin.

- Zot i madh! Si është e mundur të ekzistojnë njerëz të tillë, kriminelë të tillë, që torturojnë kafshë të pambrojtura? - bërtita dhe përkëdhela këlyshin.

- Një banor i zonës dëgjoi të qarat dhe njoftoi zjarrfikësen. Ndodhi të kalonim dhe ne andej në atë moment, ndaluan dhe me ndihmën e zjarrfikësve arritëm t'i shpëtonim. Por vetëm njëri ishte i gjallë. Ky që mban tani në krahë. Dhe meqë të morën macen, nuk mendon se është zëvendësues i shkëlqyer? Është mashkull, - më shpjegoi.

- Ti je i paparë! Sa shumë, sa shumë të dua! - mëmërita dhe e pushtova në krahët e mi.

- Për qenushin? Aman, a thua se është ndonjë gjë e madhe. Do të shkoja deri në yje nëse do të ma kërkoje,
- më tha dhe ma mbushi zemrën me dritë.

Si përfundim, lumturi do të thotë plotësi ndjenjash.

Qeni ynë ishte kaq lozonjar dhe i ëmbël. E quajtëm Laki. Ishte me fat, apo jo? Arriti të mbijetonte në kushte shumë të këqija. E ushqeja me biberon dhe prej veterinerit mësova se ishte racë malteze.

- Raca e tij e ka prejardhjen nga Malta. Kur të rritet, do të peshojë tre deri në katër kile. Parapëlqen të rrijë në vende të mbyllura dhe në oborre të vogla,
- më shpjegoi.

Laki më bëri për vete nga çasti i parë dhe vazhdonte të më bënte për vete. E shikoja dhe nuk e besoja dot. Më dukej sikur ishte ngjallur një qen prej pelushi. E dashuronte për qafimin tonë, e adhuronte shoqërinë tonë.

Muajt kalonin me shumë punë, dashuri, përkë-dhelje, puthje. Në gusht morëm të dy lejen. Andoni donte të më njihje me prindërit e tij. Nuk hezitova. Doja shumë t'i takoja edhe unë njerëzit që sollën në jetë të dashurin tim. Bëra gati valixhen time, duke fluturuar nga gëzimi. Arritëm te trageti në portin e dytë të Amorgos, në Ejali a Jali, siç e quajnë vendasit.

Dhe papritur u gjenda në ishullin e ëndrrave me burrin e ëndrrave të mia.

Arritëm në Ormo, në qendër të Ejalit. Një port me hotele, uzeri, kafe-bar, por edhe me varka peshkimi, pemë tamariske, ujëra të pastra si kristali,

rërë e pafundme. Prindërit e Andonit rrinin në një prej ngushticave vertikale të Ormos, në një shtëpi njëkatëshe me stil cikladik, pranë kishës së vjetër të Shën Marisë, që ishte ndërtuar mbi një vend të shenjtë antik.

Babai i tij, Andrea, ishte kopja e të birit. Një pesëdhjetëvjeçar i gjatë, simpatik, i djegur nga dielli, me sy gri dhe më flokë të zinj si të të birit. Në rininë e tij ishte peshkatar, por prej shumë kohësh kishte një kafeteri në buzë të detit. Nëna e tij, Athinaja, dukej pak vite më e vogël se i shoqi. Ishte e shkurtër dhe e shëndoshë, me sy kafe dhe flokë të shkurtër në ngjyrë mjalti me fije. I simpatizova sa i pashë. Ishin të sjellshëm dhe dashamirës.

- T'ju prezantoj me engjëllin tim të vogël, Olivian, - u tha Andoni dhe menjëherë më përqaftuan që të dy.

- Sa na gëzove, bija ime. Hera e parë që e shikojmë kaq të lumtur. Zoti ju bekoftë, - më tha e prekur mamaja e tij dhe fshiu sytë.

Nuk vonoi të kuptoja sa të dashuruar ishin edhe pas tridhjetë vjetësh martesë, se burri që doja ishte fryti i një dashurie të fortë.

- A nuk është e çuditshme? Të gjithë emrat tuaj fillojnë me A, - i thashë Andonit kur po zbrisnim të katërt në plazh për të shkuar te kafeteria.

- Me A, a nuk filloi edhe dashuria në gjuhën greke? Jam me fat. U rrita me ëmbëlsi, përkujdesje, siguri. Nuk kam ankesa. I adhuroj të dy dhe më adhurojnë edhe ata. Ata më mësuuan të pasionohem me vetë

jetën, ata më bënë të besoj se është e lehtë të zbuloj engjëllin tim. Ata më sollën te ti.

Ndalova së ecuri dhe e pashë.

- Zemra ime do të çahet nga lumturia me këto që më thua, - murmurita dhe e përqafova fort.

- Nëse çahet e jotja, atëherë edhe imja do të ketë të njëjtin fat. Jemi dy zemra në një trup, engjëlli im, - pëshpëriti.

Dhe aty, nën diellin e nxehtë të Amorgos, në një rrugë me baltë filluam të putheshim pa ndalim.

- Andoni! Olivia! Do të errësohet! - thirri me shaka babai i tij, ndërsa nëna e tij kishte një buzëqeshje të madhe në fytyrë.

I ndoqëm me vështirësi.

Kafeteria e prindërve të tij më befasoi. Ishte sikur t'i përkiste një epoke tjetër. E kishin rregulluar me merak. Nën pemët e mëdha të tamariskave kishin vënë shtretër të varur. Tavolinat ishin të lyera në ngjyrë të kaltër dhe prisnin me padurim klientët e tyre që të luanin tavllë. Frynte një flad i lehtë, i mbushur me kripë dhe unë thithja bukurinë përreth meje duke dëgjuar gjinkallat që po kryenin koncerte të improvizuara me këngën e tyre të pafundme në pishat fqinje.

Notuam dhe më vonë nëna e Andonit na shërbeu "patatato", mish keci me patate në tenxhere, gjizë pikante dhe sallatë. U çmenda. I kërkova recetën.

- Kecin e gatuj në zjarr të ngadaltë me salcë domatesh, domate, erëza, hudhër, qepë, karafil,

kanellë dhe patate të freskëta të prera, - më tha zonja Athina me një krenari në zë.

Pasдите morëm motorin e Andonit dhe shkuaam në qendër, kryeqytetin madhështor të ishullit, më të bukurin siç theksoi Andoni, qendër të Cikladeve. Është e ndërtuar nën kështjellën veneciane, e mbushur me kisha e kishëza të bardha, shtëpi cikladike të mbushura me vazo me borzilok dhe karafila, bukenvile të lulëzuara që të dalin papritur përpara. Ngjyra e shkëlqyer rozë e ndezur, krahas së bardhës e së kaltrës së Egjeut, të lë pa frymë. Nuk arrita ta adhuroja atë peizazh. Vrapuam deri te kështjella dhe mullinjtë e mrekullueshëm të erës, u endëm nëpër sokakët, me kalimet e mbuluara që të magjepsin, së bashku me aromat dehëse të dorëzonjës dhe jaseminit. Andoni takoi një shok klase të vjetër, Spiron, që zotëronte një hotel në ishull, një burrë i shëndoshë dashamirës që buzëqeshte vazhdimisht. Vonë atë pasdite hipëm në makinën e shokut të tij dhe ndaluaam te rruga e vjetër që lidh Ejalin me qendrën. Ecëm me këmbë për të admiruar Asfodilitin, një ndërtesë e rrënuar fshatarake me gurë të thatë, që është ruajtur e paprekur. Ecëm nëpër rrugët pa krye dhe rrënojat e saj, mes livadheve të mbushura me fiq deti.

- Ndërtesa e mori emrin nga ngjyrat e narciseve të verdha që krijojnë qilima të tërë këtu gjatë pranverës, - më shpjegoi Spiroja, duke më treguar pikturat shkëmbore të Asfodilitit, me protagonistë violinistë, muzikantë dhe valltarë, vepër e një banori të paralizuar të Amorgos, i cili e kishte për zakon të

gërvishte në shkëmbinj, në gurë dhe mure të shtëpive piktura unike nga jeta e përditshme në fshat.

Të stërmunduar dhe të entuziazmuar u ulëm në një kafene të vogël pa drita, pak metra larg kishës së Asfodilitit. Hëngrëm, nën yjet që ndriçonin në qiell, qiqra me patëllxhanë të pjekur në furrë druri dhe qofte me bizele, nga bizelet e Amorgos, gatuar me kopër dhe qepë.

- Si thua të rrimë këtu përgjithmonë, në këtë ishull përrallor? Të kërkojmë transferim për në komisariat policor të Amorgos. Të jetojmë të përqaftuar me ëndrrën. Nuk e shikon Spiron? Është kaq dashamirës, kaq i buzëqeshur. Të jep veçse bukuri dhe paqe, ndërsa...

Ndalova së foluri. Zemra më shtrëngoi kur mendova se për pak ditë do të detyroheshja sërish ta ndaja Andonin me xhunglën e Athinës.

- Komplimenti më i bukur që kam dëgjuar ndonjëherë, Olivia, - tha Spiroja duke qeshur edhe njëherë.

- Ftesa më e bukur që kam dëgjuar ndonjëherë, - bërtiti Andoni dhe më përqafoi.

Ditët që pasuan ishin njëra më magjike se tjetra. Njoha plazhin e Muros me ujërat e mrekullueshme, Maltezin, plazhin e Levrosos, gjirin e Kalotaritisës. U mahnita me përmytjen e Anës së Poshtme. Provova petulla të palosura hollë, por edhe pastelin e Amorgos me mjaltë, njoha edhe Katapolat me limanin e tyre të qetë.

Sharmi dorik, bukuria e thjeshtësisë, lëndina të gjelbra, por edhe natyra e egër. Ujëra magjepsëse, kalldrëme grafike, perëndime dehëse.

Amorgon e adhurova.

Një natë Andoni filloi të kërkonte si i çmendur te depoja e shtëpisë së tij. Shumë shpejt erdhi me një kitarë në dorë.

- Di të luash? - e pyeta.

Nuk foli. Më kapi nga dora dhe më çoi në plazh. U ula pranë tij. Sipër nesh varej një hënë e plotë erotike gushti. Drita e saj përfshinte edhe detin, gjë që e bënte të shkëlqente. Nata dukej si ditë dhe njëkohësisht e brishtë, e mbytur me pëshpërimat e dashurisë.

- Telat janë pak të çakorduar, por ne nuk na prishin punë. Dhe këtë këngë ta dedikoj ty, engjëlli im. Është e poetit tim më të dashur, - tha dhe filloi të këndonte.

Sa shumë të desha vetëm unë e di.

Unë që dikur të preka me sytë e teminit.

Dhe me krifën e hënës të përqafova

Dhe kërcyem mes lëndinave verore...

Det i madh i zi me kaq guriçka rreth qafës,

Kaq gurë shumëngjyrësh në flokët e tu...

U magjepsa me zërin e tij, me fjalët e këngës. Nga sytë nisën të më rridhnin lot.

- Të dua! - arrita të pëshpëritja.

Ai më buzëqeshi dhe në vështrimin e tij buzëqeshja u bë një me shkëlqimin e hënës.

Vallë e meritoja gjithë këtë lumturi?

Atë natë, me grilat e hapura, bëmë dashuri në krevatin e tij, rreth nesh vallëzonin rrezet e hënës, që thithnin dashurinë tonë dhe shkëlqenin akoma më shumë.

Nuk u besoja syve kur ditën tjetër, ditën tonë të fundit në ishull, arritëm me motor në plazhin e Shën Anës me ujërat e bruzta, një plazh me rërë dhe guriçka. Vërtet e humba nga gjithë ajo bukuri. U shtrimë në ca shkëmbinj dhe e lamë vështrimin të humbiste në blunë e thellë të detit.

- Ky plazh u bë i famshëm nga filmi “The big blue”, - më informoi Andoni.

Edhe pse nuk e kisha parë filmin, nuk më habitën fjalët e tij. Plazhi ishte vërtet i mrekullueshëm.

- Je për diçka shumë të guximshme? - më pyeti më pas.

- Të guximshme? Këtu? Në plazhin e qetë? - pyeta me habi.

- Do të notojmë që të shikojmë nga deti manastirin e Hozoviotisë. Është pamje fantastike. Do t’ia dalësh dot? Si thua?

Nuk hezitova ta ndiqja. U zhytëm në det. Ujërat ishin të thella dhe të ftohta, por me ngjyra magjepsëse.

- Këtu, në këto ujëra, vija të bëja zhytjet e mia, - më informoi Andoni.

Mbeta pa frymë kur pashë manastirin të varej në një shkëmb të mprehtë dhe të shikonte blunë e pafundme. E bardha e manastirit shkëlqente në dritë dhe ndriçonte shkëmbinjtë gri që e rrethonin. Si ishte

e mundur të fiksohej në një shkëmb të mprehtë kjo ndërtesë gjigante dhe imponuese?

Dolëm të rraskapitur në breg dhe filluam të ngjismim shkallët për në manastir.

- Janë treqind. Do të durosh? - më pyeti Andoni.

E pashë e zhgënjyer.

- Sapo të arrijmë aty, pasi të mbështillemi me çarçafë, meqë nuk jemi të veshur si duhet, murgjit do të na qerasin me ujë të ftohtë, raki të pjekur, pijen tradicionale të Amorgos, gliko trëndafilu dhe llokume.

U përpoqa të lagja me pështymë buzët e mia të thara. E vetmja që doja në ato momente ishte pak ujë dhe krevati im.

Vetëm unë e di si e durova ngjitjen, me Andonin që më puthte në çdo shkallë dhe që qeshte me shprehitë e mia, pasi luftoja nën diellin përvëlues dhe ndieja frikë, marramendje dhe lodhje të paimagjinueshme. Si përfundim, ia dola. Nuk u pendova. Gjithçka që pashë nga aty lart, nga ai manastir që përbën himn për besimin dhe dëshirën njerëzore, e shlyen mundimin tim. U bëra njësh me bukurinë mahnitëse, pafundësinë e detit, me shkëmbinjtë e rrëpirët.

U ndjeva më pranë Zotit.

Veshëm çarçafë, u çlodhëm, provuam të gjitha ato që përmendi Andoni, u lutëm para ikonës së Shën Marisë, shenjtores mbrojtëse të ishullit. Pastaj ngjitëm shkallë të tjera të ngushta prej guri, që të çonin në tetë katet e manastirit, nëpër qeli, te dhoma e ngrënies, te kuzhinat, te furrat, te qilarët, te shtypshkronjat, të gjitha të ngulura në shkëmb.

Ajo ditë gushti e larë me diell u gdhend në kujtesën time me germa të arta.

Ndërsa zbrisnim të çlodhur dhe të mbushur nga mrekullitë që pamë, Andoni ndaloi papritur në një shkallë.

- Ndalo! - m'u lut.

E humba. Ndalova pranë tij.

Mori një tel të butë të hedhur poshtë, filloi ta përdridhte përreth gishtit të tij derisa bëri një unazë të improvizuar. U ul në gjuhë para meje.

- Engjëlli im, do të bëhesh gruaja ime? - më pyeti.

4

Ehumba. Ndieja të më merreshin mendtë. M'u morën këmbët. U ngrit menjëherë në këmbë, shtriu duart dhe më mbajti fort.

- Engjëlli im, do të doje të bëheshe gruaja ime? - më pyeti edhe njëherë.

Sytë e tij gri ishin të mbushur me ankth.

- Po, - i thashë me ndrojtje. - Po, po, po! - bërtita më pas dhe shtriva dorën time për të më vënë unazën.

Më shtrëngoi me dëshirë pranë vetes.

- Të premtoj se do ta bëj çdo ditë të jetës sate më të dielltë se e sotmja. Kam lindur për të ardhur pranë teje, e dashura ime.

- Të... të adhuroj, - pëshpërita.

Nuk më mbanin më këmbët nga lumturia. E kuptoi dhe më ngriti në krahë, më zbriti deri në plazh.

- Të martoheni këtu, në Amorgo. Verën e vitit që vjen. Do ta organizojmë festën në lokalin tonë dhe do të ftojme të gjithë ishullin, - filloi të bërtiste e gëzuar nëna e tij sapo i treguam të rejat.

Andoni e pa dhe buzëqeshi.

- Mos u nxito, moj nënë! Ende nuk e kemi caktuar datën, as nuk e kemi vendosur ku do të martohemi.

E tërhoqa pranë vetes.

- Mirë të thotë. A ka vend më të bukur? Pajtohem me të. Pse të mos bëhet dasma jonë këtu, në Ejali? - i thashë.

- A mund t'ia prish qejfin engjëllit tim? - pyeti duke pohuar.

Të njëjtën pasdite vizituam edhe njëherë qendrën. Donte të ma blinte unazën e fejesës në ishullin e tij. Mezi priste të vendoste yllin e dashurisë së tij në gishtin tim dhe donte që ta zgjidhnim bashkë. Nuk e patëm aspak të vështirë të vendosnim për atë që na pëlqeu që të dyve.

Duke dalë nga dyqani i bardhë, i mrekullueshëm, me veçori të arkitekturës cikladike, më kapi fort dorën dhe më çoi në supermarket.

- Pse erdhëm këtu? Do të bëjmë pazar? - e pyeta.

Nuk m'u përgjigj. Shumë shpejt u gjendëm sërish nëpër sokakët e ngushtë të qendrës duke mbajtur një shishe shampanjë.

- Nuk e kuptova. Çfarë do ta bëjmë shampanjën?

- Do ta shohësh, - më tha, dhe, pasi hipa në motorin e tij, u nisëm.

Sapo mbërritëm edhe njëherë në plazhin e Shën Anës dhe në peizazhin e saj madhështor, e ndaloi motorin në një prej gjireve dhe filloi të ecte para. E ndoqa. Mbërritëm në një kishëzë të bardhë me të njëjtin emër me plazhin. Hymë brenda në oborrin e saj të vogël të rrethuar nga një hajat.

- Këtu do të fejojemi, engjëlli im, - bërtiti.

U habita.

Hapi kutinë e mëndafshtë të argjendarisë, kapi me butësi dorën time dhe më kaloi unazën prej floriri rozë katërmbëdhjetë karatësh me gurin prej zirkoni të bardhë. Më përqafoi dhe më puthi me pasion. E bota rreth meje shndriti si zirkoni në dorën time.

Andoni filloi të rrihte fort kambanën e vogël të kishës. Tingulli i saj kumboi, u bë njësh me rrahjet e zemrës sime, përmbyti gjithë botën, malet, bregun dhe detin.

Pastaj më kapi nga duart dhe filloi të më rrotullonte aty, në mes të kurrkundit, jashtë një kishëze të vogël. Pastaj hapi shampanjën, provoji pak dhe më lau me të.

- Je i çmendur, i çmendur! - i bërtita.

- Jam i dashuruar, - ma ktheu.

Ia rrëmbeva shishen, laga buzët dhe e lava edhe unë.

Putheshim, qeshnim, rrotulloheshim, thithnim lumturinë tonë.

Shumë shpejt u gjendëm në plazh, u hodhëm në det me gjithë rroba. Bëra disa zhytje e lumtur në ujin e kristaltë, duke mbajtur për dore burrin që adhuroja, e sigurt se fejesa jonë ishte më e bukura në botë.

Sado që më çmendte unaza ime e re, nuk më bëhej të ndahesha nga unaza prej teli. Atë që më dhuroi te manastiri i Hozoviotisë. E fsheha në portofolin tim që të më kujtojë gjithmonë shkëlqimin e artë

të dashurisë sonë, kripën e pasionit tonë, ato ditë të bekuara që laheshim në dritën e Egjeut.

Me gjysmë zemre përshëndetëm ishullin si një copë parajse dhe u kthyem në përditshmërinë tonë. Dhe nga e bardha dhe bluja, nga vijat e lëmuara e të lehta të Cikladeve u gjendëm në grinë melankolike të kryeqytetit. Por nuk na interesonte, kishim njëri-tjetrin.

Pak ditë më pas vizituam babanë tim që t'i tregonim të rejtat e mrekullueshme. U entuziazmuam. Përqafoi dhe puthi me dashuri Andonin.

- Kujdesu për të, dhëndër! - i tha.

- Si sytë e mi, - i premtoi dhe ai i prekur.

Pak më vonë, Andoni na përshëndeti, sepse së shpejti do të merrte turnin.

- Nuk duhet të harrosh se së afërmi do të dalë Orfea nga burgu. Në fund të tetorit do të marrë në dorë letrën e daljes. Do të bëje mirë ta takoje, - më tha babai kur shkuam në kuzhinë për të bërë një kafe.

U trondita. Ndjeva një therje në zemër. Ibriku më ra nga duart dhe banaku i kuzhinës u mbush me kafe. Rrëmbeva një pecetë dhe fillova ta pastroja. Me tërbim. Ah, sikur të mund të "hiqja qafe" në këtë mënyrë edhe Orfean. Me jetën time të re, me gjithë ato që po jetoja pranë të dashurit tim, e kisha nxjerrë plotësisht nga mendja ime atë njeri. U vrenjta.

- Edhe? Nuk më intereson fare se po del nga burgu! Pse duhet të shkoj ta takoj? Nuk dua. Kanë kaluar plot trembëdhjetë vite. A thua se papritur do të interesohet për fëmijën që solli në jetë, - iu përgjigja.

- Je e sigurt për këtë që thua, Olivia? - më pyeti babai. - Sepse më parë, me sa më kujtohet, doje ta takoje.

Nuk iu përgjigja, vrapova drejt sallanit.

Më ndoqi.

- E vizitova gjatë ditëve që ti ishe në Amorgo.

U ktheva nga ana e tij.

- Shkove në burgun rural në Tirintha? Nuk qenkemi mirë! Ç'punë ke ti me një vrasës, baba? Pse i tregon kaq dashamirësi? Pse vazhdon ta mbështesësh?

- Ishte thjesht një moment i keq, që ia shkatërroi gjithë jetën.

- Çast të keq e quan ti? Vetëm për jetën e tij interesohesh? Vrau një njeri dhe nuk duhej të kishte dalë kurrë jashtë hekurave, nuk duhej! Është e padrejtë, - fola e inatosur.

- Nuk i di të gjitha. Nuk më pyete kurrë dhe unë nuk doja të të lëndoja më shumë. E ngatërruan, bijë. U detyrua të merrte pjesë në grabitje. Mbante një karabinë, por nuk e përdori, deri kur viktimia u përpoq t'ia rrëmbente nga duart, dhe atëherë u shkrep dhe...

I mbylla veshët me duar.

- Të lutem, mjaft! - i bërtita.

M'u afrua. Ula duart, më puthi kyçet.

- Bija ime, ai më fali ty, thesarin tim. Të vuri në gjoksin tim. Fitova një vajzë falë tij. Si është e mundur të mos e mendoj, të mos shqetësohem për të?

- komentoi me qetësi.

M'u mbushën sytë me lot.

- Është... është i sëmurë. Të hënën në mëngjes do ta transferojnë në Athinë, te spitali “Evangjelismos”, të shoqëruar nga një polic, - shtoi.

Nuk fola për pak. Përpiqesha të kuptoja çfarë më kishte thënë.

- Me sa shoh i ditke gjithë të rejat e tij, - i thashë me një ton sarkastik.

Nuk m’u përgjigj.

- Është shumë i sëmurë? Do të vdesë? - e pyeta.

- Pse je kaq e ashpër? Jo, nuk mendoj se do të vdesë. Do ta operojnë dhe...

I hodha një vështrim. Ishte hera e parë që më fliste duke u shmangur për babanë tim. Fliste gjithmonë qartë, me ndershmëri dhe sinqeritet.

- Të lutem, më thuaj të vërtetën! Po më fsheh diçka, a nuk është kështu? Të njoh mirë, baba, - vura në dukje.

Tundi kokën.

- E vërteta është se nuk kërkoi të të takonte. Nuk dëshiron të ndërhyjë në jetën tënde. Përkundrazi më tha, m’u përgjërua që mos të të thosha asgjë. Nuk do të të shqetësojë, por...

- Por?

- Është dëshira ime. Ta kërkoj si nder. Shko pranë tij, Olivia! Qoftë edhe për një herë. Përndryshe... Nëse pëson diçka, refuzimi yt për ta parë do të të ndjekë gjithë jetën, fëmija im i dashur, - më këshilloi.

Nuk iu përgjigja. Vetëm e pashë. Dhe ika nga shtëpia duke e mbyllur me forcë derën pas meje.

Andoni u kthye vonë pranë meje. Më gjeti të mbledhur kruspull në kolltuk, me sy të fryrë nga të qarat. Isha zhytur tashmë në kujtimet e mia fëmijërore, me apo pa dashje, dhe ndihesha shumë keq. Pse vallë ndodhitë tona fëmijërore na ndjekin edhe në jetën madhore? Pse nuk mbyllen plagët dhe lëndimet me kalimin e kohës? Sapo fillova të kuptoja mjedisin përreth meje, jetova dashurinë, të qeshurat, kujdesin, inkurajimin. Dhe pastaj më priste humnera...

Pse refuzoja ta takoja Orfean? Çfarë ishte ajo që më bllokonte, që më trembte?

Mendoja se isha shëruar nga kujtimi traumatik i pranisë së tij në jetën time. Gabohesha. Të gjitha ato që përjetova atë natë kur i vunë prangat, dëshpërimi im, frika ime, braktisja, ishin rrënjësor thellë brenda meje. Braktisja... U rrëqetha vetëm me fjalën. Ishte kaq e dhimbshme për Olimbinë dhjetëvjeçare. U tremba jashtëzakonisht shumë, besova se do të mbetesha e vetme në një mjedis të pambrojtur, të panjohur. Por isha me fat. Zoti dërgoi në rrugën time një njeri të mirë që më adhuroi, u bë baba për mua, që ishte babai im i vërtetë. Ai që më rriti. Pse kisha frikë tani? Trembesha se mos riktheheshin të gjitha ato që më lënduan dikur? Në moshën time 23-vjeçare? A ishte e mundur?

Rrëqethesha vetëm kur mendoja se Orfea do të më braktiste sërish? Do t' më refuzonte edhe njëherë, me apo pa dëshirë, si atëherë?

Kisha pranë Andonin, babanë tim, Theodhorin... Pse më zinte paniku vetëm me mendimin se do të shikoja sërish burrin që më lindi, burrin që përgënjeshtroi gjithë shpresat e mia? Tashmë qëndroja në këmbët e mia, kisha pranë njerëz që më donin dhe i mbanin premtimet e tyre.

- Të jap fjalën se do të qëndroj gjithmonë pranë teje, micka ime, - dëgjova të thoshte Orfea.

Dhe pastaj më tradhtoi.

Papritur kujtova me sa dëshirë i kërkoja lodra të ndryshme. Arusha, kukulla dhe lojëra tryeze. Si ato që kishin shoqet e klasës. “Një kukull Barbi balerinë dua, babi. Me trupore rozë, fund tutu dhe një kurorë rozë në kokë.” Isha fëmijë, bëhesha xheloze për shoqet e mia të klasës, doja shumë atlete të reja, këpucë baleti dhe geta rozë. Ato që vishja ishin tretur. Ai ulte kokën, nuk guxonte të më shikonte në sy.

Dalëngadalë fitova gjithçka që ëndërroja dhe nuk ankohesha më. Por kishin filluar të zhdukeshin disa mobilie, disa objekte nga shtëpia jonë. Ora e varur prej druri trëndafili, që varej te muri i sallonit, e cila binte çdo gjysmë ore dhe çdo orë aq herë sa ishte ora. Orfea e adhuronte, e kishte trashëguar nga i ati. U zhdukën dhe argjendurinat tona. Gjithçka që zbukuronte bufenë dhe tavolinën e madhe prej druri në dhomën e ngrënies.

Jezu Krisht! Mos vallë i shiste që të blinte ato që kërkoja unë? Unë e kisha fajin që u bë hajdut, që përfundoi në burg?

- Shpejt, shumë shpejt, micka ime, do të arrij të të çoj në një qendër tregtare. Të blesh çfarë të të dojë zemra, - më premtoi një ditë.

Dhe pastaj e arrestuan. Mos vallë e kishin fajin kërkesat e një fëmije të vogël për veprimet e tij? A ishte e mundur kjo gjë?

Shpirti im fëmijëror ishte gdhendur në mënyrë të pashlyeshme me gjithçka që bëri. Ishin grumbulluar plagët brenda meje. Duhej t'i përballoja. Nuk mund të fshihesha më pas gishtit. Ishte e nevojshme që e vetme të shikoja në sy Orfean.

Spitali punonte pa ndërprerje, bëhej nami. Bartësit e barelave shkarkonin tek Urgjenca, njerëz shkonin e vinin, disa më dhanë me pahir kartëvizitat me numrat e telefonave të infermiereve të posaçme. Numërova katër para se t'i hidhja në kosh. Mbërrita te zyra e informacionit, pyeta për numrin e dhomës ku ishte shtruar zoti Argjiraki. Kur u ngjita në katin e shtatë, nuk e pata të vështirë ta gjeja. Në korridor ishin tri-katër barela me të sëmurë dhe jashtë një dere qëndronte një polic i armatosur. Ishte dhoma e tij. Iu afrova policit, i tregova kartën dhe distinktivin tim, dhe ai më la të kaloja. Preka dorezën e derës me duart që më dridheshin, mora frymë thellë dhe hyra brenda.

Dhoma kishte dy krevate. Tek i pari ishte shtruar një zonjë e moshuar që po flinte. Te krevati pranë dritares së madhe ishte shtrirë Orfea. Hodhi vështrimin drejt meje. U ngrit në të ndenjura.

- Olimbia, ti je? - më pyeti.

Sapo dëgjova emrit tim të vjetër në zërin e tij, u rrëqetha e gjitha. Nuk fola. Ndalova. Dhe atëherë ai u ngrit me mundim nga krevati i tij dhe m'u afrua.

- Bija ime! - pëshpëriti.

E pashë dhe e ndjeva frymëmarrjen të më ndalonte.

Herën e fundit që e kisha parë isha dhjetë vjeçe. Kishin kaluar plotë trembëdhjetë vjet. Nuk e kisha harruar trupin e tij të gjatë, të dobët dhe të shkathët, flokët kaçurrelë dhe sytë e tij në ngjyrë të errët.

Tani e shikoja përpara meje dhe nuk mund të besoja sa shumë e kishte ndryshuar koha. Nuk ishte i madh, kishte mbushur të gjashtëdhjetat, por ishte shëndoshur shumë dhe do të thosha se ishte kërrusur. Lëkura e tij ishte e zbehtë, aq e zbehtë saqë dukej si e tejdukshme. Ecja e tij ishte e kërrusur, nuk tregonte më atë vetëbesimin e njohur që pasqyronte dikur. Flokët e dendur kaçurrelë tashmë ishin e shkuara. I kishte dalë tulla. Vetëm sytë e tij ma kujtuan. Dhe vështrimi i tij shprehës. Lëshonte një dritë të çuditshme, që u duk sikur u ngul menjëherë në shpirtin tim.

- Çfarë... Ç'surprizë qenka kjo! Nuk të prisja. Nuk... nuk do t'më përqafosh? - më pyeti.

I hodha një vështrim të moshuarës që vazhdonte të flinte.

- Dua të flasim, - ishte gjëja e vetme që i thashë.

E kapërceva dhe u ula te karrigia ngjitur me krevatin e tij. Zemra kërcente si e çmendur brenda gjoksit tim. Edhe pse nuk bënte vapë, kisha filluar të djersija.

- Si të duash, - ra dakord.

U ul në krevatin e tij dhe më vëzhgoi për disa sekonda.

Buzëqesha me sarkazëm. E dija se babai im i dërgonte çdo vit fotografi të miat. Por nuk thashë asgjë. Nuk ishte e nevojshme.

Atë moment u zgjua e moshuara në krevatin ngjitur. U ul në të ndenjura dhe më nguli sytë.

- Sa vajzë e bukur që je! Mund të ma gjesh pak krehrin? - tha me një zë depërtues.

U ngrita. Te komodina pranë ishte mbështetur ajo që kërkonte. I dhashë krehrin dhe filloi menjëherë të krihej. Llogarita se duhej të ishte pak më shumë se tetëdhjetë vjeçe.

Kur pashë gruan e moshuar të rregullonte flokët, m'u kujtua diçka. Diçka që më dhembti. Duhej të isha tetë a nëntë vjeçe dhe ngjitesha sipër krevatit të Orfeas çdo mëngjes para se të bëhesha gati për shkollë. Ai rrinte pranë meje, ndërkohë që unë krihja me kujdes kaçurrelat e tij të pabindura. Ia plaste së qeshurës dhe pastaj më kapte, më hidhte te krevati i tij dhe fillonte të më guduliste e të më guduliste...

- Si të quajnë? - më pyeti zonja dhe më nxori nga mendimet.

- E quajnë Olimbi Argjiraki. Është vajza ime, - ndërhyri Orfea.

- Quhem Olivia Vagjena, - thashë me një ton krenar në zë.

Orfea u kollit thatë.

Zonja e moshuar u shushat. Nuk besoj se e kuptoi tensionin mes nesh.

- Mund të ma shtrosh pak jastëkun, bijë? Zoti të bekoftë! - vazhdoi.

Ia bëra këtë nder.

- Ç'do të bësh, zonja Marina? Do të më lësh, më në fund, të flas me fëmijën tim? - bërtiti i acaruar Orfea.

Ajo e pa me një vështrim të frikësuar.

Isha e sigurt se nuk e kishte nervozuar gruaja e moshuar, por emri që dëgjoj nga buzët e mia.

- Është kriminel. Më vunë në një dhomë me një kriminel. Perëndi, na ndihmo! Bëj kujdes prej tij! Shshs... - pëshpëriti zonja Marina, duke vënë gishtin rozë në buzë.

Tunda kokën dhe u ula sërish në karrigen pranë Orfeas. E pashë ftohtë.

- Nuk gëzohesh që më sheh. E kam gabim? - pyeti. Nuk u përgjigja.

Hapi sirtarin e komodinës dhe më dha një zarf.

- Është për ty. E shkrova para disa vitesh, por nuk guxova kurrë t'ia jepja Filipos, sado që doja, - komentoi.

Zrëmbeva zarfin nga duart e tij, si rrëmben i urituri bukën. Mezi prisja të zbuloja, më në fund, përgjigjet që kërkoja me gjithë qenien time.

E hapa zarfin, nxora letrën e rrudhosur. Dukej e fshirë dhe e rishkruar, kishte shumë njolla.

Fillova të lexoja nën vështrimin e tij të lënduar.

Micka ime,

Të desha që në çastin e parë që të pashë.

Mbështillje dorën tënde mikroskopike rreth gishtit tim dhe unë fluturoja mbi re. Dhe kur më buzëqeshje, ndihesha njeriu më i lumtur në botë.

Unë isha ai që të mësova të bëje hapat e parë, që të mësova të flisje.

Të thosha çdo ditë sa e bukur, sa e fortë, sa e zgjuar je, të ndihmoja të shprehje gjithmonë ndjenjat e tua. Nuk mundesha as ta çoja ndër mend se do të të ndaja ndonjëherë nga vetja. Doja të të ndihmoja të ndiheshe gjithmonë e sigurt, të bëheshe gruaja më e lumtur në botë. Të dhuroja çdo rezervë energjie, çdo rezervë dashurie. Pyesja veten se mos ndoshta një moment do të arrija ta administroja faktin që nuk do të isha përgjithmonë burri i vetëm në jetën tënde. Të adhuroja.

Derisa shkatërrova marrëdhënien tonë. Derisa të braktisa, pa dëshirën time.

Vallë do të mundeshe të më falje ndonjëherë? Të kuptosh se gjithçka që bëra e bëra për të dy. U ngatërrova keq me një bandë. Gabimi im. Gabim tragjik. Nuk e vrava unë atë njeri. Më beso! Nuk jam kriminel, Olimbia ime. Gabimi im i vetëm ishte se besova njerëz që nuk duhej. Kur më kërkuan t'i ndihmoja, kur më premtuan shumë para, më morën mendtë erë. Mendova sa shumë do të të dhuroja me ato para dhe nuk hezitova t'i ndiqja.

Ai vendim i gabuar përcaktoi gjithë jetën time. E ngriu, e shkatërroi lumturinë time, e hodhi në

erë marrëdhënien tonë. Një zgjedhje e gabuar që e pagova dhe po e paguaj shumë shtrenjtë.

Unë e kam fajin. Asnjë tjetër. Unë që lejova të më gënjenin ata njerëz të ndyrë. Nuk iu desh shumë të ma mbushnin mendjen se puna ishte e thjeshtë. Do të grabisnim një karburant të shkretë, do të nxirrnim paratë pa na kuptuar askush. Dhe unë nuk do të merrja pjesë. Thjesht do të drejtoja makinën e tyre. Do t'i transportoja aty dhe do t'i prisja me motorin e makinës ndezur, që të iknim sa më shpejt të ishte e mundur nga vendi i grabitjes.

Si mund ta imagjinoja se do të rrija në bankën e të akuzuarit, se do të akuzohesha për vrasjen e një njeriu?

Prisja brenda në makinë jashtë karburantit, si më kishin urdhëruar. Kur dëgjova të shtënat, e humba. Pashë punonjësin të shtrirë përtokë dhe fillova të dridhesha. Jo, jo, nuk e dija se do të përdornin karabinën e gjahut që kishin me vete. U përpoqa të largohesha, por arritën të futeshin në makinë. Njëri prej tyre u ul pranë meje te ndenjësja e pasagjerit. Më dha karabinën. Dhe unë budallai, i pushtuar nga frika, e mbajta. Pastaj e hodha te ndenjësja e pasme.

- Zot, Perëndi! Çfarë bëtë? Pse e qëlluat?

- Për pyetje jemi tani, more të marrtë djalli?

- bërtiti i dyti që u ul pas meje dhe më urdhëroi të ndizja makinën.

I dëgjova. Nuk mund të bëja ndryshe. I lashë në vendin që më treguan, e braktisa makinën e grabitjes

pak më poshtë, u largova shpejt që aty me një taksì dhe u ktheva në shtëpi.

Më vonë mësova se burri i pafat, që ra i vdekur nga zjarri, ishte vetëm tridhjetë e dy vjeç dhe baba i dy fëmijëve.

Mbrëmjen tjetër hyri policia në shtëpinë tonë. Të kujtohet? Nuk kishte dëshmitarë që të vërtetonin pafajësinë time. Arrestuan dy të njohurit e mi, ata që më ngatërruan. Dhe të dy dëshmuuan kundër meje. Thanë se e vrava unë.

Karabina e gjahut kishte shenjat e mia të gishtave. Vetëm atëherë u kujtova se të dymbanin veshur doreza. Kishin projektuar gjithçka përsosmërisht. Nuk mund të më shpëtonte asnjë, bija ime, dhe për fat të keq nuk kisha mundësi ekonomike të punësoja ndonjë avokat të njohur. Më caktoi shteti një. Ai më bindi që ta pranoja fajin tim. Të betohesha se karabina u shkreh në duart e mia, se punonjësi i karburantit u përpoq të më çarmatoste. Besonte se vetëm në këtë mënyrë mund të dilja ndonjëherë nga burgu. Bëra si më tha. Nuk kisha zgjedhje tjetër.

Kur dëgjova vendimin gjyqësor për burgim të përjetshëm, m'u shemb toka nën këmbë. Parapëlqëja dënimin me vdekje sesa këtë. Kisha merakun tënd, vetëm tëndin. Dhe kur më mbyllën në burg, doja si i çmendur të të shikoja, të të përqafoja, të të shpjegoja. Por ç'mund të të thosha? Si të ta shpjegoja që shkatërrova jetën tënde? Shikoja drejt vendit të vizitave, një dhomë e vogël me mozaikë në

dysHEME dhe me kangjella në dritare. Mbyllja sytë dhe të imagjinoja pranë meje. E dija se do të të sillte pranë meje një punonjës i burgjeve dhe i veshur me uniformë. Kisha mësuar se mund të të bënin edhe kontroll trupor. Dhe ai punonjësi do të rrinte pranë nesh dhe do të na ndiqte.

Të mendoja të ulur tek ajo tavolinë e drunjtë në një karrige përballë meje, duke më parë të vuaja. Nuk duhej të kishe kontakt me mua, s'duhej të të përqafoja, të të shikoja më. S'do t'ia lejoja vetes të të lëndoja më shumë.

E kisha humbur të drejtën të quhesha babai yt.

Mezi prisja të të merrja në telefon. Të të flisja. Të mos i humbitnim kontaktet. Të paktën të dëgjoje zërin tim, të ndieje se ekzistojë akoma në jetën time.

Por isha i sigurt se nëse unë do të dëgjoja zërin tënd, do të filloja të përplasja kokën pas muri, derisa ta bëja copash, derisa ta mbushja gjithë vendin me gjak.

Kur erdhi të më shikonte burri, që më kishte arrestuar, kur më foli për idenë e tij që të të birësonte m'u duk si shenjë e Zotit. Më nxori nga mendimet e mia të errëta. E dëgjoja të fliste dhe papritur pashë dritë në fund të tunelit të ndjenjave të mia të fajit. Nuk hezitova t'i thosha "po". Nuk kishe ç'të prisje prej meje. Do të të mbyllnin në ndonjë jetimore dhe jo, jo, nuk do ta duroja dot këtë. Ai oficeri m'u duk njeri i mirë, mora vesh se kishte familje, më premtoi se do të kujdesej për ty si sytë e vet. Pranova. Pranova të refuzoja fëmijën tim.

Në momentin që hodha firmën në dokumentet e birësimit, doja t'i jepja sërish fund jetës sime.

Duhej të vdisja që të shpëtoja. Por nuk bëra asnjë tentativë vetëvrasjeje. Nuk e di pse. Thjesht rrija në qelinë time, shtrihesha në krevat dhe të mendoja. Çdo ditë. Dhe të prisja.

Prisja të fikeshin dritat.

Që të qaja...

Ndalova së lexuari dhe e pashë. Mijëra ndjenja vallëzonin si të çmendura brenda meje. Zemërim, zhgënjim, mërzitje, nostalgji dhe dashuri. Dashuri? A ishte e mundur ta doja akoma atë njeri? Që nuk u mendua mirë para se të bënte disa veprime të paligjshme, që më braktisi të mbytur me boshllëqe emocionale? Sigurisht që njeri ishte edhe ai, sigurisht që të gjithë ne bëjmë gabime, gabime të pafundme. Vallë do të arrija ta falja? Gjurma e mungesës sime ishte ende e gdhendur në shpirtin tim.

- Nuk duroja dot të të dëgjoja të më kërkoje lodra dhe unë të mos të t'i ofroja dot. Vendosa të vidhja që të shikoja gëzimin në sytë e tu, - tha papritur.

- Gjithë prindërit bëjnë ç'munden për fëmijët e tyre. Por nuk vjedhin, as vrasin, - iu kundërpërgjigja.

- Ta shpjegova. Nuk e vrava unë!

- Po. Saktë. Asnjë vrasës nuk e pranon fajësinë.

- Përpiqu të më ndiesh, të lutem! U rrite pa nënë dhe ndieja faj. Përpiquesha mos të të mungonte asgjë dhe... Vetëm kur të bëhesh edhe ti me fëmijë, do të arrish ta kuptosh.

- E di që nuk më ke thënë as gjënë më të vogël për nënën time? Gjithnjë ndërroje temë kur të pyesja. Gjithmonë gjeje justifikime të ndryshme që të mos e përmendje. Dhe unë ndalova së pyeturi që mos të të mërzisja. Por nuk mendon se ka ardhur koha të më flasësh për të? - e pyeta papritur.

Fjalët më dolën spontanisht nga goja. E humba dhe unë, jo vetëm ai. Nuk kishte asnjë fotografi të sajën në shtëpinë ku jetoja më Orfean. Nuk më kishte thënë kurrë asnjë fjalë për të. A thua se nuk kishte ekzistuar kurrë.

- I jam betuar vetes mos të të përmend kurrë asgjë për atë njeri.

- Atë njeri? Ç'janë këto që thua? Ishte gruaja që doje!

Nuk foli. Nuk tha asnjë fjalë. Vetëm më shikonte. Me një përvuajtje të papërshkrueshme.

Papritur më erdhi një impuls për të ikur me vrap që aty. Larg, shumë larg prej tij. Kisha nevojë të vija në një rend ndjenjat e mia. Nuk mund të mendoja kur shikoja dhimbjen në sytë e tij.

U ngrita në këmbë. I ktheva letrën.

- Është e jotja, micka ime, - protestoi.

E zhyta me nxitim në xhepin e xhakëtës që kisha veshur.

- Po ikën? - më pyeti me ankim.

Tunda kokën.

- Nuk ke asgjë për të thënë? - më pyeti.

- Ke nevojë të të sjell diçka? Ke nevojë për para?
- e pyeta.

U ngrit dhe ai në këmbë. U përpoq të më përqafonte. Bëra një hap mbrapa. Nuk do ta duroja diçka të tillë.

- Nuk kam nevojë për asgjë. As për gjënë më të vogël, - pëshpëriti i lënduar dhe u ul i ngrysur në krevatin e vet.

- Lamtumirë! - i thashë. - Lamtumirë, zonjë! - i thashë edhe zonjës që ishte shtrirë.

Ajo më buzëqeshi dhe më tundi dorën.

Dola jashtë. Ndalova një minutë, mora frymë thellë. Roja më buzëqeshi. Ia ktheva me mundim buzëqeshjen. Në atë moment u shfaqën para meje dy mjekë. I pari dukej rreth pesëdhjetë vjeç, i dyti shumë herë më i vogël.

- Jeni mjekët e zotit Argjiraki? - pyeta më të madhin.

- Po. Unë quhen Dhimostheni Argjiriu. Po ju?

- Jam... Jam vajza e tij.

- Atëherë, gëzohem që ju takova. Na tha që nuk kishte të afërm... Mund t'ju flas privatisht? - vazhdoi.

E humba. Por e ndoqa deri te zyra e tij.

- Nuk do t'ju vonoj. Veshkat e babait tuaj nuk e kryejnë më nivelin e nevojshëm të funksioneve bazike. Ka nevojë urgjente për transplant. Vuan nga sëmundje kronike të veshkave në fazën finale. Ju ka informuar se i është nënshtruar dializës?

Ngriva me fjalët e tij. Kërceva në këmbë.

- E kuptova. Nuk ju ka thënë asgjë. A nuk është kështu?

U ula sërish në karrigen time.

- Mund të jetojë me dializë të vazhdueshme, por gjendja e tij shumë shpejt do të rëndohet. Nga ana mjekësore konsiderohet i përshtatshëm për transplant dhe...

- Çfarë doni prej meje? - e ndërpreva, - t'i fal veshkën time?

Tundi kokën duke pohuar.

Duhej të mbaroja shpejt me këtë bisedë, isha gati të bërtisja nga paniku. Brenda pak orësh kisha parë sërish, pas kaq vitesh, njeriun që më lindi, isha zhytur në ndjenjat e mia më të dhimbshme, kisha lexuar justifikimet e tij, kisha dëgjuar mjekun e tij të thoshte se rrezikonte të vdiste, se unë duhej ta shpëtoja.

- Po, aty e kam fjalën. Jeni vajza e tij, si pasojë ndoshta edhe donatore e përshtatshme. Sigurisht që do të bëni disa analiza të specializuara për t'u siguruar. Dhe mos u shqetësoni aspak, rreziku i ndërlikimeve serioze është i paktë, - më shpjegoi dhe u ngrit në këmbë.

U ngrita edhe unë.

- Dëshironi të më pyesni për diçka?

- Jo, jo, - murmurita dhe më pas me hapa të dridhur dola jashtë në trafik, në smog, në jetë.

Merrja frymë thellë që të vijja në vete, ndërsa nga sytë më rridhnin lot. Një moment fillova të vrapoja. Gjërat përreth më dukeshin të turbullta. Fillova të ngjitesha drejt shtëpisë së Andonit. Makinat i binin borive, semaforët më ndalonin, gjithçka përreth më buçiste.

“U rrite pa nënë dhe ndihesha në faj. Përpiquesha që mos të të mungonte asgjë... Nuk duroja dot të të dëgjoja të më kërkoje lodra dhe unë mos të t’i ofroja dot.”

Mendime të errëta, mendime që më dhembnin, luftonin të gjenin një zgjidhje brenda meje.

“Më beso! Nuk jam kriminel, Olimbia ime.”

Një moment humba rrugën, u ngatërrova, u gjenda në rrugën “Plutarcho” në Kolonaki. Nuk e mendova fare. Fillova të ngjisja shkallët që të çojnë në Likavito.

“Pranova. Pranova të mohojta fëmijën tim.”

Për pak rrëshqita në një shkallë, por u kapa nga parmaku. Vështrimi më ndaloi në një kishë diku larg.

“Vallë a do të më falje ndonjëherë?”

O Zot, o Zot!

Një moment mbërrita duke gulçuar në majë të kodrës, në një kishëz të vogël të lyster me gëlqere të Shën Gjergjit, që më kujtoi peizazhin cikladik. U ula te sheshi i shtruar me pllaka dhe sytë endeshin përreth te pamja panoramike, te pylli me pisha, te teatri i Likavitosë, tek Akropoli, tek Athina që shtrihej nën këmbët e mia. Frynte shumë atë ditë, flamuri grek sipër meje shpalosej në ajër, valëzonte me zhurmë. U ngrita në këmbë dhe u kapa nga kangjellat.

Frymëmarrja më ishte qetësuar, peizazhi po më mernte mendjen.

Dalloja akoma disa anije në Saroniko dhe më tej të Egjinës.

Ndjeva një mall të madh për Amorgon, për ditët ëndërrimtare që kalova atje bashkë me Andonin.

Ah, sikur të mund të ktheja kohën pas... Plagët e viteve të fëmijërisë sime linin ende plagë të hapura në shpirtin tim, thelloheshin gjithnjë e më shumë. Pse refuzoja t'i shëroja? Ndihesha si vajza dhjetëvjeçare që u tradhtua nga babai i saj, mbaja ende brenda vetes frikën, inatin, refuzimin, zhgënjimin. Përjetësoja dhimbjen.

Orfea nuk mund të më lëndonte më.

Pse të mos e falja vërtet, të mos i dhuroja dhembshurinë time? Pse të mos përpiqesha të shëroja plagët e mia? Ta hapja, më në fund, portën e kalasë që ndërtova me gjithë këto ndjenja të dhimbshme. Të çlirohesh, të ecja përpara, të qetësohesha, t'i bëja vetes një dhuratë të çmuar.

Ndalova së menduari. Pashë përreth, dielli përgatitej të futej pas maleve, duke përmbytur qiellin me ngjyrë të kuqe dhe portokalli.

Mbylla sytë dhe shijova rrezet e përgjumura që më përkëdhelnin fytyrën.

Po, do ta falja, kisha nevojë ta falja, të mos ndieja më ligësi. Do ta bëja për veten, jo për atë. Isha lodhur duke u torturuar për diçka që nuk ekzistonte më. Mora frymë thellë dhe u ndjeva e lirë.

- Është e mrekullueshme që e mendove, engjëlli im. Është operacion i rëndësishëm, je e sigurt? Nuk do të ketë pasoja në organizmin tënd nëse i dhuron njëren veshkë atij njeriu? - më pyeti me ankth Andoni.

- Mjeku theksoi se rreziku për komplikacione në shëndetin tim është i paktë, - iu përgjigja.

Nuk hiqesha si heroinë para të dashurit tim. Thellë-thellë kisha frikë, dridhesha. Por duhej ta ndihmoja Orfean. Ishte detyrimi im.

Nuk ia përmenda babait tim, nuk guxova. E dija se vetëm mendimi do ta tmerronte. Nuk doja të ziheshim.

Një javë më vonë mora një telefonatë nga spitali, fola me doktorin e Orfeas. M'u lut të kaloja të nesërmen për disa analiza të posaçme.

Ishte e premtë, herët në mëngjes, kur shkova sërish te spitali "Evagjelismo", bëra analizat dhe pastaj shkova me vrap te dhoma e Orfeas.

Ishte edhe më i zbehtë dhe tepër i shqetësuar. Krevati ngjitur ishte bosh.

- Mirëmëngjesi! Ç'pësoi zonja pranë teje? Doli nga spitali?

Nuk u dha rëndësi fjalëve të mia.

- Falë Zotit erdhe! Nuk e kisha numrin tënd të telefonit, nuk... - filloi dhe u ngrit nga krevati.

- Ç'po ndodh?

- Ulu! - m'u lut.

E dëgjova. U ula te krevati i tij.

- I mora vesh të gjitha nga doktori. Pse u ngatërrove, Olimbi? Pse? Nuk duhej të mësoje për problemin tim. Bëri gabim që të foli, gabim të madh, të pafalshëm. Me ç'të drejtë e bëri këtë? U thashë të gjithëve se nuk kam familje, se nuk kam askënd, - bërtiti.

Nuk fola.

- Micka ime, nuk do të doja të bëhesh dhuruese, - vazhdoi më i qetë më pas. - Të lutem, të lutem shumë! Mund të ma plotësosh këtë dëshirë për hatrin tim?

- A është e mundur që mos të të ndihmoj? Jam e vendosur. Sot bëra analizat e nevojshme, me siguri jam dhuruese e përshtatshme, shumë shpejt do të bëhet operacioni, - iu përgjigja.

Rënkoj. Shkëputi vështrimin prej meje dhe e hodhi vështrimin në tavan.

- Nuk doja të ta thosha. Doja shumë që ta merrja në varr këtë sekret. Por më detyrove dhe më vjen keq, më vjen kaq keq...

- Nuk po të kuptoj... - i thashë e habitur.

- Nuk mund ta marrin veshkën tënde. Nuk munden!

- Munden. Kështu më thanë të paktën. I njëjti mjek u gëzua kur dëgjoji se jam vajza jote.

- Jo! Jo. E ke gabim.

- Gabim? Çfarë do të thuash?

- Nuk je fëmija im. Nuk jam unë babai yt biologjik, - vazhdoi.

5

Nuk e besova. Nuk ishte e mundur. Me siguri më gënjente. Përpiqej të gjente një justifikim, nxirrte nga goja çfarë t'i vinte në mendje, që të mos bëhesha dhuruese, që të mos e vija veten në rrezik gjatë operacionit.

- Ç' janë këto që thua? Eja në vete! Pse nuk më lejon të të ndihmoj? Nuk do të pësoj gjë dhe ti...

- Po të them të vërtetën! Nuk jam unë njeriu që të lindi. Është më mirë ta mësosh prej meje. Herët a vonë, me analizat që bëre, do të ta thoshin mjekët. Nuk jemi të afërm.

Mbeta pa fjalë. Mendoja se nuk kisha dëgjuar mirë.

- Nuk të kuptoj. Çfarë do të thuash? - mërmërita dhe e humba kur e pashë të përlotur. U ul në krevat pranë meje. Më kapi dorën. Filloi ta përkëdhelte. E tërhoqa në mënyrë të pandërgjegjshme.

- Dashurova shumë një grua, Litonë, një krijesë të ëmbël, të adhurueshme. Ishte fryma ime. Po bëhesha gati t'i kërkoja të bëhej gruaja ime kur mora vesh se e kisha lënë shtatzënë. Sa u gëzuam që të dy, sa

gëzim! Sidomos unë, që e kuptova shumë herët sa shumë i dua fëmijët, energjinë e tyre, dashurinë që të dhurojnë pa kusht. Vendosëm ta shtynim dasmën, të martoheshim sapo të vinte në jetë fëmija ynë. Mezi prisja të bëhesha baba, mezi prisja të përqafoja fëmijën e dashurisë sonë. Nëse do të ishte djalë, do ta quanim Jani, dhe nëse do të ishte vajzë do ta quanim Olimbia. Bëmë kaq plane, por...

Ndaloj së foluri dhe fshiu sytë.

- Ç'ndodhi? - e pyeta gjithë ankth.

- U shfaqën probleme. Litoja vdiq në lindje nga hemorragjia e shumtë. Dhe vajza jonë jetoj vetëm pak orë. Shfaqti një problem në zemër, nuk dua ta kujtoj... Dridhesha i gjithi nga mërzitja, megjithatë durova ta mbaja në duar. Ndenja pranë saj në frymëmarrjet e saj të fundit. Kur dha shpirt në krahët e mi, nuk doja të ndahesha prej saj, nuk doja. Ç'nuk hoqën mjekët për të ma marrë fëmijën. Isha bërë leckë. Nuk haja, nuk flija, ecja si i çmendur ditë e natë nëpër rrugë.

Bëri një pushim tjetër. Mori frymë thellë.

- Vazhdo! - bërtita ftohtë, sepse doja të mësoja.

Në atë moment kisha filluar të kuptoja se gjithçka që po më tregonte, të gjitha ato gjëra të padëgjjuara po përgatiteshin të më shtypnin, të më gjakosnin. Isha ngatërruar. Lutesha të ishte gjithçka gënjeshtër, edhe pse e adhuroj të vërtetën. Por nuk ishte.

- Një drekë, në muajin qershor, isha në një park pranë shtëpisë sonë. Rashë në një stol, sepse s'po më mbanin më këmbët, ecja me orë të tëra në kurrkund.

Për pak erdhi dhe m'u ul pranë një vajzë e re që mbante një karrocë me një foshnjë që flinte e qetë. E pashë. Nuk duhej të ishte më shumë se njëmuajshe. Nuk mund ta llogarisja. Dhe ishte shumë e bukur. Sytë m'u mbushën me lot. Kujtova vajzën time, kujtova ngrohtësinë e trupit të saj.

“T’ju rrojë fëmija, është i mrekullueshëm”, arrita t’i thosha vajzës. Flisja shumë pak ato kohë. Edhe fjalët madje më lëndonin.

“Nuk është imi. Unë jam dadoja”, u përgjigj ajo.

- Sa kohë ndenji pranë meje nuk pushoja së shikuari foshnjën. Vdisja për ta marrë në duar. Për pak, vetëm për pak. Ta përkundja, ta puthja, të më dhuronte pak gëzim. Por më vinte turp t’i lutesha dados. Çfarë do të mendonte për mua? Isha një i huaj.

Papritur një i huaj erdhi në park, iu afrua vajzës. Por ajo u ngrit menjëherë nga stoli dhe u hodh në krahët e tij. “Nuk duhet të vish këtu. Do të na shikojë ndonjë dhe do të humbas punën i dashur. Nëse mësojnë që breddh nëpër parqe nuk do hezitojnë të më pushojnë nga puna”, e qortoi ajo e shqetësuar. “Vetëm një puthje dhe do të zhdukem, ta premtoj”, i tha djaloshi dhe e tërhoqi pranë vetes.

U kthyen dhe më panë. Duket se i vinte turp të putheshin pranë meje, ndaj shkuan pak metra më tej. Dadoja u mbështet në një trung dhe djaloshi u ngjit sipër saj, filloi ta puthte me pasion. Brenda pak sekondash një mendim i çmendur më përshkoi mendjen. Një mendim që do të më ndryshonte gjithë

jetën. U ngrita nga stoli, u përkula mbi karrocë, rrëmbeva fort në krahë foshnjën dhe fillova të vrapoja si nuk kisha vrapuar kurrë në jetë. Derisa të ndalonin ata së puthuri, unë isha zhdukur. Kthehesha herë pas here dhe shikoja i trembur mbrapa, por askush s'po vinte mbrapa, askush s'po më ndiqte. E çova fëmijën në shtëpi, në shtëpinë time. E vura sipër krevatit tim. Ishte vajzë. Ishte Olimbia ime... Ishe ti!

Brofa në këmbë.

Mbylla gojën me të dyja duart që të mos ulërija. Nuk mund t'i besoja ato që kisha dëgjuar. Ishin të padëgjuara. Të frikshme, të tmerrshme. Doja shumë t'i bërtisja që të ndalonte së foluri, doja shumë të ulërija nga tmërri. Por u dorëzova nga reagimet që më digjnin përbrenda, u ula sërish pa lëvizur në krevatin e tij.

- Vazhdo! - arrita të thosha sërish, por ftohtë.

-Ndërrova rroba. Dadoja mund t'i jepte përshkrimin tim policisë, - u përgjigj ai menjëherë. - Duhej të sigurohesha se nuk do të më njihnin. Bleva me nxitim gjithë gjërat e nevojshme për ty, micka ime, nga një supermarket i madh aty pranë. Mora qumësht, shishe, pelena, biberon, disa rroba, bëra shpejt e shpejt një valixhe dhe ikëm nga Athina me autobus. Për te fshati im. Të kisha në krahë gjatë gjithë rrugës, të ushqeja, të përkundja. Ishe kaq e qetë, kaq fëmijë i qetë. Nuk u ankove asnjë moment, nuk qave asnjë çast. Të shtrëngoja pranë vetes dhe ndihesha i plotësuar. Ia kisha dalë. Kisha ringjallur time bijë.

Rruga ishte e gjatë. Zgjati shumë orë. Nga radioja që vuri shoferi dëgjova pak gjëra për rrëmbimin e një foshnje, por stacioni nuk kishte sinjal të mirë, nuk kuptova hollësi. Me siguri flisnin për ty, por nuk kisha më frikë. Si ka mundësi të më zbulonin? Në të gdhirë, më në fund, mbërritëm në Shën Akilio. Binte shi i imët. Re të zeza mbulonin qiellin dhe mjegulla e dendur dukej sikur donte të përpinte gjithë vendin.

Doja të filloja të kërceja nga gëzimi. Ishte dita më e lumtur e jetës sime. Kisha arritur të “ringjallja” vajzën time, të përqafoja diellin tim. Jo, nëse më pyet, nuk ndieja aspak faj që të mora nga nëna jote e vërtetë.

E binda veten se ajo mund të bënte fëmijë të tjerë, se shumë shpejt do të të harronte. Ndërsa unë kisha humbur gruan që doja. Nuk do të martohesha më kurrë, kurrë! Asnjë grua nuk mund të krahasohej me Litonë time. Kisha për ty më shumë nevojë se nëna jote.

Ishe e imja! Plotësisht e imja.

Olimbia, nëna ime, ende s’e kishte marrë vesh gjëmën time, i shpjegova se Litoja vdiq gjatë lindjes, se nuk mund ta rrisja i vetëm foshnjën tonë dhe i mbështeta në gjoks thesarin tim të vogël. Pranë nesh jetonte edhe te zja ime, Rinjoja, të kujtohet, apo jo? Për pak sa nuk pësuan të dyja atak në zemër nga lumturia. Filluan të bërtisnin si të çmendura. Hera e parë që i shikoja në atë gjendje. Jeta e tyre mori kuptim. Të adhuruan që nga momenti i parë, të përkëdhelnin ditë e natë. Të tilla përqaftime, të tilla puthje s’i kishte parë asnjë fëmijë. Atë natë ndenja zgjuar. Kërkoja mënyra

të të mbaja përgjithmonë pranë meje. Derisa mendova diçka që më qetësoi. Një mënyrë për të të regjistruar në gjendjen civile në pemën time familjare.

Ditën tjetër, herët në mëngjes mora urbanin dhe shkova në Lemo, një fshat i madh i Prespave, selia e bashkisë me të njëjtin emër, shumë pranë Shën Akilit. Aty jetonte një ish-shoku im i klasës dhe mik zemre, atë Llambi. Punonte në kishën e fshatit, te Shën Parashqevia. I rashë derës së shtëpisë së tij dhe ai më mirëpriti. I shpjegova se gruaja ime vdiq gjatë lindjes, rrëmbeva në krahë fëmijën dhe erdha në anët tona. Nuk duroja dot asnjë ditë më shumë në kryeqytet me atë mërzitje të madhe, kështu nuk arrita të deklaroja lindjen tënde, por harrova të merrja me vete edhe dokumentet e nevojshme. Iu luta të më ndihmonte.

“Më e pakta që mund të bëj për ty, miku im. Nuk mendoj se është mëkat të themi se vajza jote lindi në fshat”, më tha, dhe pa humbur kohë hyri mik për hatrin tim në bashki.

Nuk vonoi të merrja në dorë certifikatën tënde të lindjes, aktin që shkruante se isha babai yt. Qaja i mallëngjyer përpara bashkisë dhe atë Llambi i gjorë e kishte të vështirë të kuptonte arsyen e lumturisë sime.

“Pres ta sjellësh vogëlushen ta pagëztoj”, m’u lut.

Ia premtova. U ktheva i entuziazmuar. Nuk lexova as gazeta, nuk hapa as radio. Nuk kishim televizor në shtëpi. Isha i sigurt se do të më ndiqnin. Nëse policia do të më gjente, do të më çonin para prokurorit e do të më dënonin për rrëmbim. Nuk doja t’ia dija. Nuk u pendova asnjë minutë, micka ime.

Isha kapur pas çdo fjale të tij, në agoni për të vërtetën e jetës sime. Mijëra ndjenja të pakëndshme më pllakosnin. Dhe nuk duroja dot ta dëgjoja të më thërriste ashtu, s'e duroja.

- Nuk dua të më quash më "micka jote"! Dëgjove? Ta ndaloj! - i bërtita. - Je, je...

Përpiqesha të gjeja fjalën e duhur për ta karakterizuar, por nuk ia arrita qëllimit.

- Më quajnë Olivia Vagjena dhe nuk jam micka e askujt. As Olimbia jote! - vazhdova.

- Pse më sillesh kaq ashpër?

E pashë. Nuk ia kishte idenë ç'kishte bërë, sa jetë kishte shkatërruar. Nuk mendoj asnjë moment për dhimbjen e babait tim të vërtetë, për dëshpërimin e gruas që më solli në jetë. Ishte tmerrësisht egoist. Për më tepër të kërkonte edhe llogari. Sado i lënduar të ishte nga gjërat e trishtueshme që i ndodhën, nuk duhej të kishte vënë veten mbi këdo dhe mbi gjithçka. Nuk e pranonte gabimin dhe as nuk ishte penduar për veprimin e tij. Rrëmbeu një foshnjë nga nëna e vet dhe nuk donte t'ia dinte.

Sidoqoftë, këtë burrë e doja kur isha e vogël. Mendoja se ishte i përkryer, ishte heroi im, Zoti im. Me kalimin e kohës dhe nga ngjarjet që pasuan e çmitizova, ndjenjat e mia për të u bënë thërrime. Para se të fillonte të shqiptonte të vërtetat e tij, më vinte keq për të. Dhe tani ndjenja e vetme që më shkaktonte ishte neveri.

- Ke guxim të më kërkosh llogari? Gjithë jeta ime është gënjeshërë dhe ti e ke fajin për këtë! - i bërtita.

Uli kokën.

- Karta ime e identitetit thotë se kam lindur në maj. Festoj ditëlindjen këtë muaj. Edhe kjo është gënjeshtër, kështu?

- Nuk e dija ditën e lindjes sate. Kur të mora në krahë ishte qershor.

- Kur më more larg prindërve të mi, këtë do të thuash, - i bërtita.

Nuk foli. Uli kokën.

U kapërdiva thatë. U ngrita në këmbë, u ktheva dhe e pashë.

- Kur... Kur më rrëmbeve, isha e sapolindur?

- U luta që në dokumente të shkruanin se erdhe në jetë në muajin maj. Llogarita se ishe njëmuajshe, siç të thashë. Më bënë nder. Foshnjat regjistrohen në gjendjen civile sapo lindin.

Ndjeva të më merreshin mendtë. Për një moment mendova se po ëndërroja, se asgjë nga ato që dëgjova nuk ishte e vërtetë. A është e mundur të ekzistojë një njeri që nuk di ditën e saktë të lindjes?

Ishte.

- Vazhdo! - i bërtita e inatosur, me një ton urdhërues në zë.

Nuk kundërshtoi.

- Jetuam pranë nënës tri vite të tëra. Derisa e humba edhe atë, nga zemra. Sa e varrosa, vendosa të ktheheshim në Athinë, në shtëpinë time. Kishte kaq vite e mbyllur. Askush nuk më kërkonte më, isha i sigurt se çështja e rrëmbimit tënd ishte futur në

arkivat e policisë. Teze Rinjoja u mërzit, nuk duronte dot të ndahej prej teje. I shpjegova se në kryeqytet do të kishe më shumë mundësi për edukim. I dhashë fjalën se do ta vizitoja shpesh. Punoja lart e poshtë, si kamerier, si punëtor ndërtimi, bëja një sërë punësh rastësore. Gjeta një fqinjë që të të mbante. Por isha i vendosur të përballesha me gjithë botën që të ishe e lumtur, fëmija im i dashur. Ishe kuptimi dhe qëllimi i jetës sime. Derisa bëra atë gabim tragjik, derisa të humba.

Heshti. Më pa. Sytë e mi ishin të mbushur me frikë, isha gati të plandoshesha aty, në duart e tij. Mora frymë thellë.

- Ku ndodhi rrëmbimi im? Në Athinë? - arrita ta pyesja.

Tundi kokën.

- Në cilën zonë? - vazhdova.

- Në Pedion tu Areos (Fushën e Marsit).

- Nuk mësove kurrë kush ishin prindërit e mi të vërtetë?

Nuk foli.

- Kush më lindi? - i bërtita.

- Pse do ta mësosh?

Nuk durova dot më. Kishte derdhur çdo pikë të fundit të gotës së urrejtjes brenda meje.

- Nuk ke turp? Nuk ke cipë në faqe? - i bërtita.
- Je... je rrëmbyes, hajdut dhe vrasës! Dhe mos më thuaj më se nuk e shkrepe ti këmbëzën. Gënjeshtër do të jetë edhe kjo. Një justifikim i kotë! Sot të njoha mirë.

Më rrite me gënjeshtër. Një mijë e një gënjeshtër.
Duhet të të vijë turp për gjithçka që ke bërë në jetë!

- Jo, jo. Gabim! Unë bëra gjithçka për ty dhe...

- Bëre gjithçka? Më rrëmbeve me dhunë nga krahët e nënës sime, të babait tim. Nuk i njoha kurrë, nuk...

Këmbët m'u prenë. Rrëshqita nga krevati, u mblodha kruspull në tokë, fillova të qaja.

- Bija ime, Olimbia, micka ime, më fal! - tha dhe filloi të më fërkonte kurrizin.

Prekja e tij, prekja që nuk po e duroja dot, më dha fuqi për të reaguar. U kapa te krevati. U përpoqa të mbahesha në këmbët e mia. Ia dola!

- Mos më prek! Të urrej! Ndiej neveri për ty! Luftova! Ah, Zot, sa shumë luftova që të të falja se më braktise, që më dhe për birësim! Pse nuk ia the kurrë të vërtetën Filipos? Me ç'të drejtë e firmose ti birësimin tim? Ty nuk të kam asgjë, asgjë! Je një njeri pa moral, që vodhi një fëmijë! Që ia hoqi të drejtën të jetonte me prindërit e tij të vërtetë! - i ulërita.

Kisha dalë nga vetja. Nuk foli. Më shikonte i lënduar.

- Dhe e di çfarë është për të qeshur? Hë? Jo! Nuk e di! Kishe frikë se nuk do të kishim pajtueshmëri, apo jo? Por të informoj, se, sipas të dhënave të reja, do të vazhdojnë me kryerjen e transplantit, edhe sikur të mos ketë pajtueshmëri.

- Jo, jo! Nuk më besohet! Bën gabim dhe...

- Besoje! - e ndërpreva e inatosur. - Pyet të marrësh vesh! Më kot e hape gojën, më kot m'i the të gjitha

këto! Mendon se doja t'i mësoja? Pse? Që të më shkatërrohej jeta edhe njëherë?

E pashë e tërbuar. E dija se fjalët e tij do të më lëndonin. Dhe po e shijoja pa masë.

- Ama, qëllimin tënd e arrite. Nuk ka asnjë mundësi të futem në sallë për hatrin tënd, të rrezikoj. A nuk doje këtë? Uroj të ndihesh i kënaqur që më bërë fërtele edhe njëherë, Orfea Argjiraki! - i bërtita që t'i ofroja më shumë dhimbje.

Por çfarëdo që të bëja, sado fjalë të hidhura t'i thosha, nuk mund të krahasoheshin me dhimbjen që kishte pikuar sërish në zemrën time. E kisha të pamundur ta besoja, të kuptoja sekretin e tij të fshehtë. U ndjeva sërish e vetme, e frikësuar, e pambrojtur.

Kush isha si përfundim? Kush më lindi?

- Më vjen shumë keq... Të kërkoj falje! - pëshpëriti Orfea dhe më pa në sy.

- Mendon se shpëtove me një kërkesë për falje? Shkatërrove jetën time, kuptoje!

- Të dua, micka ime! - pëshpëriti.

Dhe unë doja t'i hidhesha dhe t'i mbyllja gojën. Kështu është dashuria? Nuk kishte turp të përdorte këtë fjalë?

- Cilët janë prindërit e mi të vërtetë? Më thuaj! Nga kush më vodhe?

- Të shpjegova se nuk kërkoja kurrë. Pse të më interesonte? Kur u ktheva në Athinë bashkë me ty, askush nuk e kuptoi që fëmija nuk ishte imi. Kështu që e hoqa nga mendja dhe...

Nuk durova dot më.

- Ndiej keqardhje për ty! Vetëm këtë mund të them. Të mëshiroj! Shkatërrove jetën time. T'u duk vetja si Zoti dhe zgjodhe fatin që doje ti për mua. Nuk duhej të të kishin nxjerrë nga burgu, nuk duhej! Sepse je djallëzor, i rrezikshëm! Je një krimb! - i bërtita.

- Olimbia! Ulu të flasim, të lutem!

E pashë. Me një vështrim të mbushur me akuza.

- Deri këtu! Nuk kemi më asgjë për të thënë, zotëri. Të uroj të shkuara! Dhe të jesh i sigurt se nuk do t'më shikosh më kurrë në jetë! - i premtova.

Gabova apo vërtet buzëqeshja, që u formua në buzët e tij, ishte buzëqeshje çlirimi?

Mos ndoshta gëzohej që si përfundim nuk do ta bëja operacionin që i duhej të shpëtonte? Që nuk rrezikova jetën time për hatër të tij? Apo mos ndoshta se nuk do t'më shikonte më kurrë?

Dola thujse me vrap nga dhoma e tij. Hasa sërish rastësisht mjekun e tij në korridor.

- Zonja Vagjena, rezultatet e analizave tuaja janë gati. Do të dëshironit të kalonit nga zyra ime të bisedonim? - më tha.

E pashë sikur të mos e shikoja.

- Jeni mirë? Ka ndodhur gjë? - më pyeti.

- Nuk do ta kryej operacionin. Ju falënderoj për gjithçka, - gjeta guximin t'i thosha dhe vrapova larg tij.

Dola nga spitali. Binte shi i rrëmbyer. Nuk kisha çadër me vete, shumë shpejt u bëra qull. Nuk më

interesonte. Pikat e shiut pasqyronin mërzitjen time, u bënë njësh me lotët e mi. Fillova të ecja shpejt, e humbur në mendimet e mia. Kalimtarët, makinat, semaforët, rrugët, trotualet, vitrinat e dyqaneve, të gjitha i shikoja turbullt. Kur arrita në “Pagrati”, në shtëpinë e vogël njëkatëshe të babait tim kulloja e gjitha.

Ndalova jashtë.

Vështrimi im përqafoi ullirin në trotuarin e shtëpisë, që pas kaq vitesh vazhdonte të ishte i gufuar. Vazhdova drejt oborrit tonë të vogël. Që kur babai doli në pension, iu fut me kokë hobia të tij të preferuar, luleve. Oborri ishte i mbushur me krizantema të verdha, portokalli dhe të bardha me gjethe të pasura, por edhe me oleandër, kumakë, hibiskë, që pranonin me mirënjohje dhuratat nga qielli. Më mbytën kujtimet, u preka. Këtu, në këtë shtëpi, kisha mësuar ç’do të thoshte siguri, këtu kisha filluar të doja dhe të respektoja veten. Në ato çaste m’u duk si strehë.

Nuk kisha guximin të nxirrja çelësat nga çanta. I rashë fort derës së shtëpisë së babait tim. Kisha tmerrësisht nevojë për Filipon.

Sapo e pashë, iu hodha në krahë.

- Jezu Krisht, ç’pate, bija ime? Je qull. Do të marrësh ndonjë pneumoni! - foli i shqetësuar dhe më solli një pecetë dhe ndërresa.

U futa në banjë dhe ndërrova rrobat mekanikisht. Më priste i shqetësuar jashtë dere.

- Ç’ndodhi? Gjithçka mirë? - më pyeti.

Dhe atëherë i tregova gjithçka për Orfean, duke anashkaluar faktin që isha gati të bëhesha dhuruese për të.

I ra tavani mbi kokë.

- Arriti t'i mashtronte të gjithë. Çfarë njeriu është ai? Kur të birësova, dokumentet e tua kaluan në kontroll gjithëpërfshirës. Ishin të sakta dhe... Ah, bija ime, ah, çfarë të bëri!

E shtrëngova në gjoksin tim. Sa shumë e doja! Isha e sigurt se kishte të drejtë. Por plagët nuk mbyllën kaq papritur. Duan kohën e tyre.

E përshëndeta. Nuk duroja dot të ecja, mora taksi, u ktheva në shtëpinë e Andonit. Shpirtërisht isha e rrënuar. Nuk kisha guxim as të gatuaja. U shtriva dhe shikoja pa shprehi tavanin e dhomës së gjumit.

Pse ma rrëfeu të vërtetën Orfea? Nuk doja ta mësoja. Pse nuk më la të qetë të jetoja në iluzionet e mia? Dëshironte të nxirrte nga vetja të gjitha ato që e mbysnin? Por ai kishte pranuar se nuk ndiente asnjë ndjenjë faji. Pse i transferoi tek unë? E urreja gënjeshtren. Por nuk më pyeti nëse isha gati të përballesha me ato që i mbante aq mirë fshehur brenda vetes. Nuk pyeti veten nëse do të mundesha t'i dëgjoja. E dinte se rrëmbimi im nuk do të dilte kurrë në dritë. Një krim tjetër i tij, të cilin e ekzekutoi me përpikëri. Megjithatë zgjodhi të më lëndonte sërish, të sillte sërish furtunë në jetën time.

Atë ditë kuptova se ka të vërteta që nuk duhet të thuhet. Të vërteta që të tmerrojnë. Shkruhet në zemër me germa që nuk fshihen dhe e gjakosin.

Sepse janë të pamëshirshme.

U linda duke besuar se Orfea ishte babai im. Pastaj më braktisi. Më pas u rrita pranë Filipos, babait që më birësoi. Dhe tanimë duhej të menaxhoja se ekzistonte edhe një baba tjetër. Një njeri i tretë që nuk e kisha njohur kurrë.

Një grua me tre baballarë. Zot i madh, a është e mundur diçka e tillë?

Po nëna ime, gruaja që më solli në jetë? Vallë, do t'i ngjaja? Do të jetë lënduar që i rrëmbyen fëmijën? A më kërkoi? A kishte fëmijë të tjerë? A më kishin harruar prindërit e mi të vërtetë? A e kishin kaluar mërzinë?

Sado që të luftoja të varrosja ndjenjat e mia, mendimet e trishta, gjithë ato pikëpyetje që më krijuan fjalët e Orfeas, nuk ia arrija dot qëllimit. Ishin rrënjosur brenda meje, më shqetësonin. Qeshnin me ironi me frikërat e mia.

Jezu Krisht, një njeri i thjeshtë isha dhe unë. Dëshiroja qëndrueshmërinë dhe qetësinë në jetën time, ashtu si të gjithë. Kur isha dhjetë vjeçe, nuk isha gati të përballesha me stuhinë që më tronditi. M'u desh shumë kohë që të fitoja qetësinë që meritoja pranë familjes sime të re, të ndihesha e sigurt. Dhe sërish u rrokullis gjithçka. Duhej të luftoja edhe njëherë për të bashkuar copëzat e mia. Nuk e dija nëse doja të kërkoja të gjeja prindërit e mi, nuk isha e sigurt. Nëse e bëja, a do të gjeja sërish qetësinë time shpirtërore?

- Olivia, vajzë, ku je? - bërtiti Andoni kur u kthye në shtëpi dhe më nxori nga mendimet.

Nuk e dija sa ishte ora. As që më interesonte.

- Këtu, - thirra e pafuqishme.

U shtri pranë meje në krevat. Nuk ishte nevoja të më pyeste se si ndihesha. E kuptoi menjëherë.

- Kush të lëndoi? Më thuaj!

Edhe njëherë i hapa zemrën. Ia thashë të gjitha.

- Ndyrësira! - bërtiti. - Por ti nuk duhet të mërzhitesh. Më ke mua, shpirti im, - vazhdoi.

U mblodha kruspull në përqaftimin e tij. Nisi të përkëdhelte flokët e mi të gjatë, gjë që i pëlqente shumë. Pastaj nisi të më zhvishte dalëngadalë. U dorëzova. Sepse ai kishte penelat dhe ngjyrat e shpirtit tim, ai ishte parajsja ime. Përqaftimi i tij i ngrohtë, i përzemërt dhe erotik i rrëzonin gjithë dyshimet e mia dhe më lehtësonin dhimbjet.

Pushuam së foluri. Heshtja fliste për ne, këndonte dashurinë tonë.

I mblodhi duart rreth meje dhe m'u duk sikur po mbështillte përreth të gjitha ato që më lëndonin. Më dha puthje të shpejta në qafë dhe unë buzëqesha për herë të parë atë ditë. Andoni më zbukuroi zemrën me kordelet e ndritshme të dashurisë së tij. Më shikonte dhe më thoshte, pa më thënë asnjë fjalë, të gjitha ato që doja të dëgjoja. Më rrëmbeu nga vështrimi dhimbjen, e bëri të vetën dhe pastaj më çliroi. Më drejtoi, herë ngadalë dhe me kujdes e herë me pasion në kënaqësinë time. E hapa veten edhe njëherë në duart e tij.

Pastaj, teksa e shikoja të flinte krah meje, i qetë, i paqtë, i harrova ato që më lënduan atë ditë. Nuk më

interesonte më për asnjë Orfea dhe të vërtetat e tij, për asnjë rrëmbim. Sepse rilinda pranë Andonit. Gjithçka që doja, gjithçka që uroja ishte pranë meje.

Nuk ishte nevoja të kujtoja të shkuarën, Filipinoja kishte kaq të drejtë. E dashuroja Andonin. Dashuroja sytë e tij, buzët, virilitetin e trupit të tij, përqaftimin e tij, oksigjenin që më dhuronte që të frymoja e lumtur. E dashuroja, sepse me të humbisja...

Nuk kisha nevojë të kërkoja për prindërit e mi, nuk më interesonte më se sa baballarë kisha. Mendova vetëm se sa me fat jam.

Buzëqesha dhe mbylla sytë e lumtur.

Kur u zgjova ishte mëngjes.

Hapa gojën, u tendosa dhe atëherë vura re se tashmë Andoni ishte ngritur dhe ishte veshur.

- Është e shtunë, apo gaboj? Nuk kemi shërbim sot, - i thashë.

- E di, Bukuroshja e Fjetur. Po të pres të zgjohesh. Sot kam plane për ne, - më tha. - Si thua? Do të më ndjekësh deri në Magjistri?

I dhurova një buzëqeshje shndritëse. Ishte e vërteta ime. Ishte fakt që do ta ndiqja, madje deri në fund të botës.

- Po! - bërtita.

Arritëm në Pire, hipëm në një traget dhe unë klithja si e çmendur ndërsa filluam të çanim detin e qetë si vaj. Ishte mesi i shtatorit, e megjithatë dita të kujtonte verën, ujërat shkëlqenin në përkëdheljet mëngjesore të diellit. Një fëmijë pranë nesh në kuvertë luftonte të

bënte hapat e tij të parë e të paduruar dhe një më dy binte e bërtiste nga gëzimi. Babai i tij, i përkulur sipër tij, njëherë i mbante duart, pastaj e linte vetëm të ecte duke i thirrur vazhdimisht “Të lumtë!”.

Andoni i shikonte të dy duke buzëqeshur ëmbël. Sa baba i mirë do të bëhej! Mbylla sytë për një çast dhe e imagjinova të mbante në krahë fëmijën tonë.

- Je xheloz? - e pyeta.

U habit.

- Hë? Çfarë? Do të të them të vërtetën? Po, jam xheloz, - u përgjigj.

- Nuk mendon se duhet të presim disa vite? Je vetëm njëzet e shtatë vjeç dhe unë njëzet e tre dhe...

Ma mbylli gojën me një puthje.

- Mirë, në rregull, dorëzohem. Do të të dhuroj aq shumë fëmijë, saqë do të vraposh e s’do të arrish dot, - i premtova.

Ia plasëm të dy së qeshurës.

Për një orë e gjysmë u gjendëm në Shkallë, në Agjistri, një parajsë e Saronikos me ujëra të bruzta, taverna dhe kafene piktoreske. Një ishull që më magjepsi me gjiret e veta, plazhet e mrekullueshme, fshatrat e lezetshme dhe pishat që arrinin deri në det. Morëm me qira nga një biçikletë dhe filluam eksplorimin e ishullit nga Shkalla. Shpejt arritëm në Skliri, ecëm në rrugicat e shtruara me kalldrëm, u çlodhëm në shkallët e lyera me gëlqere në rrugën e të “Dashuruarve”, bëmë fotografi të panumërta, pimë kafe në një bar të lezetshëm e të zhytur në gjelbërim me pamje nga Egjina.

- Këtu kam ardhur që i vogël bashkë me prindërit,
- tha Andoni. - Më kishte bërë përshtypje ishulli,
por më shumë përshtypje më kishin bërë byrekët e
shijshëm me djathë, - vazhdoi dhe më bëri t'ia plasja
së qeshurës.

Vazhduam drejt plazhit më të njohur të ishullit,
Halikiadës.

E patëm të vështirë të arrinim, por guralecët e
bardhë dhe shkëmbinjtë e pjerrët më magjepsën. U
zhytëm në ujërat e bruzta, të ftohta e ekzotike, pastaj
u shtrimë të lodhur në gurë.

- Të falënderoj shumë për këtë surprizë! - i thashë
të dashurit tim.

Më përqafoi dhe u rrokullisëm në rërë.

- A përpiqemi të arrijmë në një ishull tjetër të vogël,
në Aponiso? E merr guximin? - më pyeti.

Në vend që t'i përgjigjesha, u zhyta në det që të
më ikte rëra dhe hipa në biçikletën time. Kishte të
drejtë, rruga ishte e gjatë dhe e lodhshme, por nuk
u dorëzuam. Herë pas here, në malore, i merrnim
biçikletat në dorë dhe bënim rrugë shumë të bukura
mes shtigjeve të harlisura. Diku në rrugë, pas porteve,
hasëm një kishë të vogël bizantine, Shën Nikollën.
Hymë brenda, ndezëm qiri, u lutëm për lumturinë
tonë. Pastaj u ulëm të lodhur në ca shkallë në oborr që
të çlodheshim.

- Do të doja që fëmijën tonë të parë ta quajmë
Nikola. Sigurisht, nëse do dhe ti, engjëlli im! -
propozoi Andoni. - Është shenjtori mbrojtës i familjes
sime. E ka shpëtuar tri herë babanë tim në det.

- Mund të ta prish unë qejfin? - e pyeta e përlotur.
- Po nëse është vajzë?
- Atëherë do ta zgjedhësh ti emrin e vajzës sonë.
- Si thua për emrin Athina?
- Të adhuroj, - pëshpëriti, dhe më shtrëngoi aq fort në krahët e tij sa më mori frymën.

Vizituam edhe portet, ku gjetëm një tavernë dhe iu futëm ushqimit me kokë. Mishi i kecit, por edhe kërpudhat me vezë që provova, m'u dukën ushqimet më të shijshme në botë.

U nisëm sërish, dhe pasi ndeshëm ullishtat, një liqen të virgjër, shumë metra rrugë të vështirë, një pyll të dendur e të mbushur me papagaj, dhe përmes një ure të ngushtë mbërritëm pa frymë në Aponiso. Një ishull i vogël privat, me plazh në jugperëndim, që dukej si pjesë e Karaibeve me ujërat e tij magjepsëse, që ndryshonin vazhdimisht ngjyrë sipas tekave të diellit. Nga të bruzta bëheshin vjollcë e pastaj të kaltra.

- Herën tjetër, kur të vijmë këtu, do të të marr një karrocë me qira, princesha ime, - më tha duke qeshur Andoni kur më pa që po më merreshin këmbët nga lodhja.

Pasdite vonë u ngjitëm në kuvertën e tragetit për t'i dhënë lamtumirën kësaj parajse të vogël. Pulëbardha të mrekullueshme na ndoqën pas e ndërsa ktheheshim në Pire na bënin shoqëri duke klithur nga lart dhimbjet e tyre. U mbështeta në parmak dhe fillova të këndoja e shkujdesur:

*Një varkë qëndronte e vetme në detin e kaltër
dhe ishte një pulëbardhë me krahë të bardhë,
që gjithë po i afrohej duke i bërë naze
dhe krahët lagte në ujërat e kaltra.*

*Dhe kisha zili varkën e bardhë borë
që pulëbardha i puthte pëlhurën e bardhë.
Dhe ndihem si një varkë në gjerësitë e kaltra
që pret me padurim të shfaqet një pulëbardhë...*

- U shfaq pulëbardha, engjëlli im, - më ndërpreu duke qeshur Andoni dhe më tregoi një pulëbardhë që u lodh së fluturuari dhe u ul në kuvertën pranë nesh. E pashë. Ishte shumë e bukur. E bardhë, me pendë dhe kurriz gri, këmbë dhe sqep të verdhë. Bëra t'i afrohesha, por u tremb dhe fluturoi larg.

- Sa keq! - thirra.

- Doje t'ia bëje dhuratë Lakit tonë?

Nuk iu përgjigja, vetëm e putha. U ulëm në një stol të drunjtë dhe unë u shtriva dhe e mbështeta kokën mes këmbëve të të dashurit tim, ndihesha e rraskapitur. E shikoja me adhurim. Aura e kripur e detit luante me flokët e tij të zinj, e bënte të mbyllte sytë përgjysmë.

Zot i madh, sa shumë e doja! I përkisnim njëri-tjetrit. Sa e mrekullueshme, sa e çmuar është t'i përkasësh dikujt. Çdo ditë më dhuronte copëza të vogla të vetvetes, po ashtu dhe unë, çdo ditë kalonim bashkë çaste të vogla lumturie. Kishte ardhur në jetën

time që të më mësonte ç' do të thoshte dashuri, të hapte dyert e zemrës sime. Çdo gjë tek ai më magjepste dhe një buzëqeshje e tij mjaftonte që të ndriçonte ditët dhe netët e mia. Ishte kaq i bukur! Nuk ngjante me askënd. Burri më i bukur në botë për mua.

Papritur e zhyti vështrimin e tij tek imi. Ngrita dorën, i përkëdhela butësisht faqen. Vëzhgova fytyrën e tij të adhureshme dhe çdo detaj sipër tij.

Ndjeva se doja të ngrija kohën. Të isha përgjithmonë e shtrirë sipër tij, ta përkëdhelja përgjithmonë. Gjithë bota ime ndodhej në atë stol të tragetit. Gjithë bota ime ishte ai.

M'u mbushën sytë me lot. Nga mirënjohja.

- Çfarë ke, zemra ime? Njëherë këndon, pastaj qan... Je mirë? - më pyeti dhe u përkul për të më puthur ëmbëlsisht në buzë.

- Çfarë kam? Të dua, - i thashë. - Nga thellësia e shpirtit tim.